

RAPORT

BAROMETRI PËR MUNDËSI TË BARABARTA



osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup



Projekti është i financuar
nga Bashkimi Evropian



Q E N D R A
MAQEDONASE
PËR BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR

RAPORT

Barometri për mundësi të barabarta

Puna në terren: maj - qershor 2023

Publikimi: 2023



Botuesit: Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD),
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN)

Redaktor: Igor Jadrovski, kryetar i KPMD

Autore: Fani Kimova

Perkthimi në shqip: Vjosa Taipi

Lektura: Jasminka Porkojeviq – Milenkoviq

Dizajni grafik: Kontura

Shkup, nëntor 2023

CIP - Каталогizacija во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.647.82:316.654(497.7)"2023"(047)

KIMOVA, Fani

Raport Barometri për mundësi të barabarta [[Електонски извор]] / [autore Fani Kimova ; perkthimi në shqip Vjosa Taipi]. - Shkup :

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi : Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://mcms.mk/sq/per-punen-tone/hulumtime-dhe-publikime/hulumtime/2503-barometar-za-ednakvi-moznosti-2023.html>

- Превод на делото: Извештај Барометар за еднакви можности / Фани Кимова. - Текст во ПДФ формат, содржи 104 стр., илустр., табели. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.12.2023

ISBN 978-608-4848-53-0 ((MCMS))

ISBN 978-608-5040-02-5 ((KSZD))

a) Дискриминација -- Јавно мислење -- Македонија -- 2023 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 62625029

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në përgatitjen e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Ky hulumtim është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian për nevojat e projektit "Komisioni Kundër Diskriminimit kryen rolin e tij parandalues dhe mbrojtës". Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e autores Fani Kimova dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara, riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose perkthimi i cilës do pjesë të këtij hulumtimi mund të bëhet vetëm në kushtet e mëposhtme: me leje paraprake të botuesve, për qëllime të citimit në analizë të librit dhe sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.

Të drejtat e autorit në këtë hulumtim janë mbrojtur, por hulumtimi mund të riprodhohet në cilën do qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjim në kushte të tjera, për përdorim në hulumtime të tjera ose për perkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

Përmbajtja

◆	Hyrje	5
◆	Rezyme.....	7
◆	1. Vendosja e kontekstit	9
◆	2. Perceptimi i diskriminimit.....	18
◆	3. Përvojat me diskriminimin.....	39
◆	4. Përvojat dhe perceptimi me diskriminim të shumëfishtë	50
◆	5. Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta gjatë punësimit	55
◆	6. Lufta kundër diskriminimit.....	63
◆	7. Ndërgjegjësimi mbi të drejtat dhe kërkimi i mbrojtjes në rast të diskriminimit.....	64
◆	8. Matja e gatishmërisë për të pranuar përfshirjen e informacioneve për diversitetet në materialin shkollor	72
◆	9. Matja e gatishmërisë për të pranuar përcaktuesin e tretë në dokumentet personale përveç burrë ose grua	77
◆	10.Përfundime	79
◆	SHTOJCAT	84
◆	Shtojca 1 Metodologjia që u aplikua në hulumtim	85
◆	Shtojca 2 Pyetësi anketues.....	86
◆	Shtojca 3 Shpërndarja e karakteristikave përkatëse socio-demografike të të anketuarve.....	94

Hyrje

Diskriminimi si fenomen global ka efekt negativ në të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Rezultoni në përjashtim, marginalizim dhe dehumanizim. Për këtë arsye, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit janë baza e të drejtave themelore të parashikuara në të drejtën ndërkombëtare dhe reflektohen në sistemet juridike kombëtare. Kudri ligjor kombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi i udhëhequr nga *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi* i vitit 2020¹ rregullon gjithashtu mekanizmat mbrojtës kundër këtij fenomeni negativ. Institucionet përkatëse që kanë kompetenca të përcaktuara ligjërish në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe ushtrimit të së drejtës për barazi janë: Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese, gjykatat; Përfaqësuesi Ligjor për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat dhe inspektoratet.

Përvoja, jo vetëm në vend, por edhe në Bashkimin Evropian, tregon se thirrja për të drejta të barabarta dhe miratimi i ligjeve për promovimin dhe mbrojtjen e tyre nuk është e mjaftueshme për të siguruar që të gjithë në praktikë të gëzojnë mundësi të barabarta. Përvoja të tilla në vend kanë nxitur nisma për një luftë më gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit. Sipas qasjes së re, katër hulumtime të opinionit publik janë kryer në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2023. Qëllimi i këtyre hulumtimeve është ndër të tjera ofrimi i të dhënave empirike për perceptimet dhe përvojat e grave dhe burrave në fushën e diskriminimit dhe mbështetjen e masave anti-diskriminuese në përgjithësi. Ndjekja e këtyre tendencave në publik në të njëjtën kohë është një mjet i dobishëm që ndihmon për të fituar njohuri për to jo vetëm në mesin e publikut të gjerë,

por edhe në mesin e publikut ekspert që merret me këto sfida.

Hulumtimi i parë i këtij lloji u krye në prill 2009, para miratimit të *Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi* (në tekstin e mëtejme: *Ligji*) dhe për këtë arsye paraqet bazën për krahasimin e perceptimeve, qëndrimeve, njohurive dhe ndërgjegjësimit për diskriminimin dhe pabarazinë në publikun vendas, në lidhje me gjetjet e nxjerra nga tre hulumtimet e mëposhtme, të kryera në vitin 2013, 2018 dhe 2023. Rezultatet e tre hulumtimeve të fundit pasqyrojnë ndryshimet pas miratimit të *ligjit* dhe zbatimit të tij.

Duhet të theksohet se për shkak të qasjes së ndryshme metodologjike të hulumtimit, mundësitë për analizë krahasuese ishin të kufizuara. Në hulumtimin e vitit 2013, metoda e "intervistës telefonike" është përdorur si metodë e mbledhjes së të dhënave, ndryshe nga hulumtimi në terren në vitet 2009, 2018 dhe 2023, në të cilat metoda "sy më sy" është përdorur në shtëpinë e të anketuarit. Gjithashtu, në hulumtimin e vitit 2013, janë bërë ndryshime në rendin dhe tekstin e pyetësorit (për më shumë detaje shih Shtojcën 1 - Metodologjia e aplikuar në hulumtim). Për shkak të mungesës së bazës së të dhënave të hulumtimin në vitin 2013, vetëm krahasimet midis rezultateve të hulumtimeve në vitin 2009, 2018 dhe 2023 tregohen në disa vende në raport.

Ky raport analizon gjetjet e anketës "Barometri për mundësi të barabarta", i cili u krye për herë të katërt, në maj/qershor 2023.

Analiza krahasuese e rezultateve të katër hulumtimeve ofron pasqyrë mbi drejtimin dhe intensitetin e ndryshimeve në perceptimet, qëndrimet, njohuritë dhe ndërgjegjësimin për diskriminimin dhe pabarazinë në vend në periudhën nga viti

¹ Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 258/2020 nga 30.10.2020

2009 deri në vitin 2023. Raporti analizon përgjigjet e të anketuarve ndaj shtatë bazave të diskriminimit - gjinisë, përkatësisë etnike, fesë ose besimit, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe përkatësisë politike.

Raporti ilustron gjithashtu intensitetin e ndryshimit që ndodhi në periudhën e mbuluar nga hulumtimet vitit 2009-2023 dhe identifikon pikat ku rezistencat ndaj ndryshimit janë më të dukshme.

Raporti mbulon temat e mëposhtme:

- Konteksti social i të anketuarve/ave dhe vetë-identifikimi i tyre si anëtarë/e të një pakice/grupi të diskriminuar;
- Perceptimet për llojet e ndryshme të diskriminimit, diskriminimit të shumëfishtë dhe qëndrimet ndaj grupeve të ndryshme të ekspozuara ndaj diskriminimit;
- Perceptimet e përvojave personale diskriminuese të të anketuarve/ave dhe/ose si dëshmi e përvojave diskriminuese të të tjerëve;
- Vlerësimet e të anketuarve/ave për përpjekjet e shtetit në luftën kundër diskriminimit;
- Ndërgjegjësimi për të drejtat nga viktimat e mundshme të diskriminimit; dhe
- Opinione për barazinë e mundësive gjatë punësimit në vend;

- Gatishmëria për të pranuar përfshirjen e informacioneve për diversitetin në materialin shkollor; dhe
- Gatishmëria për të pranuar një përcaktues të tretë në dokumentet personale përveç burrë ose grua.

Gjatë prezantimit dhe analizimit të gjetjeve mbi temat e hulumtuara, u bënë krahasime midis nëngrupeve të ndryshme të të anketuarve, të përcaktuara sipas karakteristikave socio-demografike të mëposhtme: gjinia, mosha, niveli i arsimin, statusi i punësimit, përkatësia etnike, fetare dhe politike, vendbanimi (urban/rural) dhe përkatësia rajonale.

Për shkak të kontekstit specifik socio-politik në vend, në hulumtimin fillestar të vitit 2009, përveç gjashtë kategorive standarde² të bazave për diskriminim të përdorura në Eurobarometrën Special të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, u shtua edhe kategoria e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike³. Kur "lexohen" rezultatet e hulumtimit të vitit 2023, merret parasysh konteksti politik në të cilin u krye puna në terren, veçanërisht iniciativa për ndryshime Kushtetuese dhe për shënimin e komunitetin bullgar në mënyrë eksplicite në tekst.

Raporti tregon vetëm ato të dhëna që kanë një nivel të caktuar të rëndësisë statistikore.

² Gjashtë kategoritë e bazave të diskriminimit që analizohen gjithashtu në Eurobarometrën e Posaçëm janë: diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, fesë ose besimit, moshës dhe aftësisë së kufizuar.

³ Rezultatet e hulumtimit tregojnë se për shumicën dërrmuese të popullsisë, përkatësia politike është baza më e zakonshme për diskriminim, e cila perceptohet gjithashtu si një faktor kryesor në procesin e përzgjedhjes gjatë punësimit.

Rezyme

Hulumtimi i vitit 2023, identik me atë të vitit 2009, tregon se sipas perceptimit të publikut, diskriminimi është më i përhapur, për sa i përket perceptimit se diskriminimi mungon. Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe etnike konsiderohet të jetë më i përhapuri. Ky konstatim është i lidhur ngushtë me perceptimin e të anketuarve se faktori vendimtar që i vendos kandidatët me aftësi dhe kualifikime të barabarta në një pozitë të pabarabartë gjatë punësimit është pikërisht përkatësia e tyre politike dhe etnike.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual sipas publikut është në fund të renditjes. Një tregues i distancës së popullsisë së përgjithshme nga kjo kategori qytetarësh është edhe fakti se ky grup është më pak i pranuar për fqinjët/et ose miqtë/miket.

Përgjigjet në pyetjen nëse diskriminimi është më i shpeshtë ose më pak i shpeshtë në pesë vitet e fundit tregojnë se perceptohet si më i shpeshtë. Ndërsa studimi i fundit nga viti 2023 tregon se ka një përkeqësim në perceptimin e incidencës së diskriminimit. Në periudhën afatmesme, perceptimi i diskriminimit në lidhje me përkatësinë politike është më i pafavorshëm. Ka një rritje gjashtëfish të numrit të të anketuarve/ave që vlerësojnë se ky lloj diskriminimi është më i shpeshtë tani, krahasuar me pesë vjet më parë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se qytetarët/et shprehin një nivel të lartë të tolerancës në sferat publike dhe private të jetës. Në shkallën e tolerancës ndaj grupeve të ndryshme, të anketuarit/at tregojnë gatishmëri të madhe për të pranuar si fqinjë ashtu edhe si bartës të një funksioni të zgjedhur nga orientimi politik "tjetër" dhe anëtarë nga komunitetet "e tjera" etnike dhe fetare. Nga ana tjetër, rezervat ndaj personave

me orientime të ndryshme seksuale shprehin dukshëm.

Të dhënat për përvojat personale të diskriminimit tregojnë se, më shumë të anketuar deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit sesa kanë qenë viktimë e diskriminimit. Në të gjitha sondazhet nga viti 2009 deri në vitin 2023, përkatësia politike ishte lloji më i zakonshëm i diskriminimit, si në situatat kur janë diskriminuar personalisht ashtu edhe kur kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Për herë të parë në vitin 2023, vërehet barazim dhe rënie e lehtë e rezultateve për diskriminim në bazë të përkatësisë politike me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike.

Rezultatet tregojnë se të anketuarit që u diskriminuan në 12 muajt e fundit u diskriminuan më shpesh në hapësirën publike dhe gjatë kërkimit të një pune ose derisa ishin në punë.

Perceptimi publik dominohet nga tre faktorë që çojnë në trajtim të pabarabartë gjatë punësimit: përkatësia politike, mosha e kandidatëve dhe përkatësia e tyre etnike. Nga ana tjetër, gatishmëria për të mbështetur masat afirmative për të siguruar mundësi të barabarta gjatë punësimit u jep përparësi grupeve sipas: aftësisë së kufizuar, moshës së kandidatëve, përkatësisë etnike dhe fetare dhe përkatësisë politike të kandidatit/es (te e cila shihet rënie më e madhe).

Opinionet publik mbi përpjekjet në luftën kundër diskriminimit me kalimin e kohës tregojnë një prirje në rënie në vlerësimin se po bëhen përpjekje të mjaftueshme reale.

Shumica e të anketuarve/ave deklaruan se nuk i njohin të drejtat e tyre nëse janë viktimë e diskriminimit. Por vërehet një rritje e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre midis të anketuarve/ave që kanë qenë viktimë të diskriminimit mbi një bazë.

Të anketuarit/at që deklaruan se do të kërkonin mbrojtje nëse do të ishin viktimë të diskriminimit më së shpeshti do t'i drejtoheshin policisë, ndërsa në një masë më të vogël gjykatës, Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, avokatit dhe organizatave të shoqërisë civile. Vërehet një tendencë e rritjes së besimit të të anketuarve/ave për Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi.

Analiza e ndërveprimeve midis grupeve të ndryshme shoqërore tregon se një shumicë e madhe e qytetarëve i përjetojnë anëtarët e grupeve të ndryshme shoqërore si pjesë e rrethit të tyre shoqëror. Një shumicë e madhe e të anketuarve/ave deklarojnë se kanë miq/mike ose të njohur që janë të ndryshëm nga ata për sa i përket pikëpamjeve politike, etnisë dhe fesë. Tre në pesë të anketuar/a u përgjigjën se kanë mik/mike ose të njohur që janë nga komuniteti etnik rom. E njëjta gjë vlen edhe për personat me aftësi të kufizuara. Në të kundërt, vetëm një në dhjetë të anketuar deklaroi se ka persona me orientime të ndryshme seksuale në rrethin e tyre shoqëror.

Është rritur përqindja e të anketuarve/ave që e përjetojnë veten se i përkasin një pakice në ven-

din ku jetojnë në pesë vitet e fundit. Në të gjithë periudhën, më të shumtë janë ata që ndihen si pakicë etnike, pasuar nga një pakicë fetare dhe një pakicë për sa i përket përkatësisë politike.

Hulumtimi i vitit 2023 tregon se të anketuarit/at ka gatishmëri më të lartë për praninë në materialet shkollore të përfshihen edhe informacione për aftësitë e kufizuara dhe pak më pak në lidhje me përfshirjen e informacionit në lidhje me diversitetin në fe dhe origjinën etnike. Të anketuarit/at janë të ndarë në pyetjen nëse materialet shkollore duhet të përfshijnë informacion mbi kulturën dhe historinë romë. Mbështetja më e vogël është për përfshirjen e informacioneve në shkollë, rreth orientimit seksual dhe personave transgjinorë.

Rezistenca e të anketuarve ndaj idesë së futjes së një opsioni të tretë përveç një burri ose një gruaje në kolonën gjinore në dokumentet zyrtare të identifikimit është e dukshme, gjë që do t'i lejonte individët të identifikoheshin ndryshe nga zgjedhja aktuale binare. Të anketuarit/at në numër të madh kundërshtojnë idenë e prezantimit të një opsioni të tretë, ndërsa një në dhjetë të anketuar/a janë të gatshëm/e ta pranojnë këtë ndryshim.

1. Vendosja e kontekstit


1.1 Distanca sociale në sferën private

Hulumtimi edhe më tutje vazhdon të tregojë se një shumicë e madhe e të anketuarve/ave i konsiderojnë anëtarët e grupeve të ndryshme shoqërore si pjesë e rrethit të tyre shoqëror. Trendi i socializimit me grupet e pakicave tregon stanjacion në 5 vitet e fundit, ndërsa grupet e pakicave të analizuar nuk tregojnë dallime statistikore midis hulumtimit të vitit 2018 dhe vitit 2023.

Në vitin 2023, ashtu si në vitin 2018, katër nga pesë të anketuar/a deklaruan se kanë mik/mike ose të njohur që janë të ndryshëm nga ata për sa i përket përkatësisë politike (82%), përkatë-

sisë etnike (80%) dhe përkatësisë fetare (78%). Ndërsa tre nga pesë të anketuar/a u përgjigjën se kanë mik/mike ose të njohur që janë nga komuniteti etnik rom (59%) dhe mik/mike ose të njohur me aftësi të kufizuara (58%). Ndërsa vetëm një në dhjetë të anketuar/a deklaruan se në rrethin e tyre më të ngushtë ose më të gjerë shoqëror kishin hasur persona me orientime të ndryshme seksuale (11%). Ka një tendencë në rënie të numrit të të anketuarve që deklaruan se rrethi i tyre shoqëror përfshin edhe personat me aftësi të kufizuara (**2009** – 65%; **2013** - 63%; **2018** - 60%; **2023** – 58%) (shih Grafikon numër 1, të anketuarit që u përgjigjën me Po).

Grafiku numër 1 A pasurit mik/e ose të njohur/a që janë ...?



Të pasurit miq/mike dhe të njohur që janë anëtarë të një komuniteti tjetër etnik është më e shpeshtë te:

- Burrat sesa gratë;
- Të anketuarit/at e moshës 15 deri në 64 vjeç sesa ata të moshës 65 vjeç e lart;
- Ata me arsim të lartë të përfunduar;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Banorët e zonave urbane sesa rurale.

Në vitin 2023, ekziston një prirje statistikisht e rëndësishme e diversitetit etnik në rrethin shoqëror të shqiptarëve, i cili tenton të arrijë atë të maqedonasve etnikë. Ndërsa diversiteti etnik, në brezin e vjetër mbi 65 vjeç, ka një rënie prej 7 p.p.⁴ krahasuar me vitin 2018. Kjo grup moshë karakterizohet nga përqindja më e ulët e përfaqësimit multi-etnik të të gjitha grup moshave në të gjitha pjesët e hulumtimit. Numri i të anketuarve që raportuan se kishin miq/mike dhe të njohur nga një komunitet i ndryshëm etnik u rrit me nivelin e tyre të arsimit (shih Tabelën 1).

Tabela numër 1

Pasja e miqve dhe të njohur/ve që janë anëtarë të një komuniteti tjetër etnik

Gjinia:	Burrë				Grua		
2009	85%				71%		
2018	86%				77%		
2023	83%				77%		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	78%	81%	78%	81%	78%	74%	
2018	82%	83%	83%	83%	79%	77%	
2023	84%	82%	82%	84%	81%	70%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	70%		82%		86%		
2018	70%		84%		86%		
2023	73%		83%		87%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	79%				69%		
2018	84%				69%		
2023	80%				76%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	80%				75%		
2018	84%				75%		
2023	80%				79%		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	84%				71%		
2018	84%				78%		
2023	82%				77%		

Në përgjithësi, numri i të anketuarve/ave që raportuan se kishin miq/mike dhe të njohur romë ishte i pandryshuar kur krahasohen me vitin **2009** (60%), **2018** (59%) dhe **2023** (59%). Me-

gjithatë, analiza krahasuese tregon se ka një luhajtje në profilin socio-demografik të të anketuarve që kanë miq/mike romë, shpjeguar më poshtë.

⁴ Pikat e përqindjes (p.p.) janë diferenca midis dy përqind të fituara nga popullatat ose nën-popullata me madhësi të ndryshme.

Të pasurit mik/mike dhe të njohur romë është më e zakonshme për:

- Burrat sesa gratë;
- Të anketuarit e moshës 45-54 vjeç;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- Banorët e zonave urbane sesa rurale.

Në vitin 2023, për dallim nga viti 2018, pati një rënie të të anketuarve që deklaruan se kishin mik/mike dhe të njohur romë, dhe një rritje të të anketuarve. Përveç kësaj, ka pasur një rritje pozitive në përfshirjen e romëve etnikë në rrethin shoqëror të grup moshës më të re (15-24 vjeç), si dhe të moshës 45-54 vjeç (përkatësisht nga 8 dhe 10 p.p. në mënyrë përkatëse), ndër-

sa një rënie u regjistrua në grup moshat 35-44, 54-64 dhe 65+ (përkatësisht 7, 6 dhe 7 p.p. në mënyrë përkatëse). Hulumtimi i fundit tregon një rritje të madhe të përfshirjes sociale të romëve/eve në jetën shoqërore të shqiptarëve/eve etnikë (14 p.p.) dhe myslimanëve/eve (12 p.p.). Megjithëse ende të kesh një mik/mike dhe një të njohur rom është shumë më e zakonshme midis maqedonasve etnikë dhe anëtarëve të besimit të krishterë sesa midis shqiptarëve etnikë dhe anëtarëve të besimit mysliman, dallimi i tyre zvogëlohet ndjeshëm. Ekziston gjithashtu një ndryshim statistikisht i rëndësishëm sipas vendbanimit, hulumtimi në vitin 2023 tregon një rritje të të anketuarve/ave nga mjedise rurale me 6 p.p., dhe një rënie me 5 p.p. në zonat urbane (shih Tabelën numër 2).

Tabela numër 2

Pasja e miqve dhe të njohurve romë/e

Gjinia:	Burrë			Grua		
2009	66%			54%		
2018	60%			58%		
2023	65%			53%		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	55%	61%	57%	65%	66%	58%
2018	47%	52%	65%	62%	65%	63%
2023	55%	54%	58%	72%	59%	56%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	52%		64%		65%	
2018	52%		62%		60%	
2023	57%		61%		60%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	67%			33%		
2018	69%			29%		
2023	62%			43%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2009	67%			43%		
2018	69%			40%		
2023	62%			52%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	68%			48%		
2018	68%			47%		
2023	63%			53%		

Të pasurit mik/e dhe të njohur me orientime të ndryshme seksuale është më e zakonshme për:

- Të anketuari/at e moshës 25-44 vjeç;
- Personat me arsim të lartë të përfunduar, sesa personat me arsim fillor dhe të mesëm;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- Banorët e zonave urbane sesa rurale.

Frekuenca e të pasurit një mik/mike dhe të njohur me një orientim seksual të ndryshëm zvogëlohet me moshën e të anketuarve, dhe më pak e mundshme është te të anketuarit/at me 65+

vjeç. Një prirje pozitive vërehet në grup moshën midis 35 - 44 vjeç, ndërsa frekuenca e të pasurit një mik/mike dhe të njohur me orientim të ndryshëm seksuale është më pak e mundshme te brezi i ri (15-25 vjeç), te grup moshë midis 55-64 vjeç dhe te brezi më i vjetër (65+ vjeç). Megjithatë nuk ka lëvizje të mëdha statistikore, ende është dukshëm më e madhe mundësia të kesh një mik/mike dhe të njohur me orientim seksual të ndryshëm midis të anketuarve/ave me nivel më të lartë arsimimi, maqedonasit etnikë, të krishterët/et dhe banorët/et nga zonat urbane/et. (shih Tabelën 3).

Tabela numër 3

Pasja e miqve dhe të njohurve me orientim të ndryshëm seksual

Gjinia:	Burrë					Grua	
2009	7%					9%	
2018	10%					11%	
2023	11%					10%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	14%	10%	6%	6%	4%	3%	
2018	12%	15%	9%	12%	11%	3%	
2023	9%	15%	19%	11%	9%	5%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	5%		9%		13%		
2018	4%		11%		15%		
2023	6%		11%		18%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	9%				5%		
2018	13%				5%		
2023	13%				5%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	8%				5%		
2018	12%				6%		
2023	13%				6%		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	10%				5%		
2018	15%				5%		
2023	13%				7%		

Të pasurit mik/mike dhe të njohur me aftësi të kufizuara është më e zakonshme te:

- Të anketuarit/at e moshës 35 deri në 64 vjeç sesa te personat e moshës 15 deri në 24 vjeç;
- Personat me arsim të mesëm dhe të lartë sesa me arsim fillor;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- Banorët e zonave urbane sesa rurale.

Në vitin 2023, si 5 vjet më parë, është më e zakonshme të kesh një mik/mike dhe të njohur

me aftësi të kufizuara midis të anketuarve/ave të moshës 45 dhe 64 vjeç, dhe më pak e zakonshme në popullsinë më të re të moshës 15 dhe 24 vjeç, e cila shënon një rënie të madhe prej 15 p.p. (**2018** - 53%; **2023** - 38%). Dallimi midis dy komuniteteve më mëdha etnike dhe fetare në vend në vitin 2023 po rritet më tej, në llogari të trendit në rënie te shqiptarët/et etnikë/e (**2018** - 51%; **2023** - 44%). Megjithëse të kesh një mik/mike dhe të njohur me aftësi të kufizuara është më e përhapur tek personat me arsim të mesëm dhe të lartë të përfunduar, megjithatë, tek ata vërehet një prirje e konsiderueshme e rënies me kalimin e viteve (shih Tabelën numër 4).

Tabela numër 4

Pasja e miqve dhe të njohurve me aftësi të kufizuara

Gjinia:	Burrë				Grua		
2009	68%				61%		
2018	63%				57%		
2023	57%				58%		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	58%	68%	64%	72%	65%	63%	
2018	53%	58%	59%	66%	66%	58%	
2023	38%	56%	62%	66%	62%	58%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	58%		68%		71%		
2018	53%		61%		64%		
2023	54%		59%		61%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	68%				58%		
2018	63%				51%		
2023	61%				44%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	68%				56%		
2018	64%				52%		
2023	61%				50%		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	66%				63%		
2018	62%				57%		
2023	58%				57%		

Të pasurit mik/mike dhe të njohur nga një fe/besim tjetër është më e zakonshme te:

- Burrat sesa gratë;
- Të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç dhe 15 deri në 24 vjeç;
- Personat me arsim të lartë dhe të mesëm sesa me arsim fillor;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Frekuenca e të pasurit mik/mike dhe të njohur të një feje tjetër është akoma më e zakonshme tek burrat sesa gratë. Kjo valë hulumtimesh tregon një prirje të madhe pozitive në popullsinë më të re të moshës midis 15-24 vjeç (10 p.p.) dhe 45-54 vjeç (6 p.p.), dhe një prirje në rënie te të anketuarit/at e moshës midis 35-44 vjeç (4 p.p.) dhe popullsinë më të moshuar mbi 65 vjeç (7 p.p.). Megjithëse frekuenca e të pasurit mik/mike dhe të njohur nga një fe tjetër është ende në rritje me shkallën e arsimit të përfunduar, në vitin 2023 ekziston një prirje pozitive e rritjes

midis personave me arsim fillor të përfunduar (6 f.). Për herë të parë pas 14 vjet, që nga hulumtimi i vitit 2009, dallimi midis maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë është barazuar. Në fakt, për herë të parë vërehet fenomeni i kundërt, përkatësisht shpeshtësia e të pasurit të një mik/mike dhe të njohur që është i takon një religjioni tjetër, në 5 vitet e fundit është rritur në mesin e shqiptarëve/eve etnikë/e me një kërcim të madh prej 12 p.p., ndërsa në mesin e maqedonasve/eve etnikë/e ka pasur një rënie të vogël prej 4 p.p. Dallimi midis komuniteteve më të mëdha fetare mbetet i njëjtë në vitin 2023, dhe ende për të anketuarit/at e fesë së krishterë është më e zakonshme të kenë një mik/mike dhe të njohur që është anëtar i një feje ose besimi tjetër sesa te myslimanët/et. Dallimi në vendbanim bëhet i papërfillshëm, falë trendit në rritje të mjedisit rural dhe rënies së lehtë të mjedisit urban (shih Tabelën numër 5).

Tabela numër 5

Pasja e miqve dhe të njohurve nga një religjion/besim tjetër

Gjinia:	Burrë					Grua	
2009	81%					70%	
2018	81%					74%	
2023	82%					75%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	75%	76%	77%	79%	76%	71%	
2018	74%	79%	81%	79%	77%	76%	
2023	84%	80%	77%	85%	77%	69%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	66%		80%		86%		
2018	66%		79%		84%		
2023	73%		81%		83%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	76%				70%		
2018	81%				65%		
2023	77%				77%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	76%				74%		
2018	81%				71%		
2023	81%				72%		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	79%				72%		
2018	83%				71%		
2023	79%				77%		

Pasja e miqve dhe të njohurve që janë anëtarë të një partie politike me pikëpamjet e së cilës nuk pajtohen është më e shpeshtë në:

- Burrat sesa gratë;
- Rritet me moshën e të anketuarve;
- Ato/ato me arsim të lartë dhe të mesëm sesa ata/ato me arsim fillor;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Frekuenca e të pasurit miq dhe të njohur që janë anëtarë të një partie politike me pikëpamjet e të cilëve të anketuarit/at nuk pajtohen është akoma më e shpeshtë tek burrat sesa gratë. Moshë e të anketuarve gjithashtu rrit frekuencën e të pasurit miq me pikëpamje të ndryshme politike. Hulumtimi i fundit tregon se popullsia më e re midis moshës 15 dhe 24 vjeç dhe brezi midis moshës 45 dhe 54 vjeç janë më të hapur për të

pranuar kundërshtarët politikë në rrethin e tyre shoqëror privat sesa ishin 5 vjet më parë. Ende ka miq dhe të njohur që janë anëtarë të një partie politike me pikëpamjet e së cilës nuk pajtohen është më e shpeshtë në mesin e të anketuarve me arsim të lartë, megjithatë, në mesin e atyre me arsim fillor të përfunduar ka një rritje statistikisht të konsiderueshme prej 5 p.p. Dallimi më i rëndësishëm që shohim është midis shqiptarëve etnikë dhe myslimanëve, ku shoqërimi me kundërshtarët politikë është më i shpeshtë dhe ka një rritje prej 13 p.p. dhe 10 p.p., krahasuar me 5 vjet më parë. Ndërsa në mesin e maqedonasve dhe të krishterëve etnikë ka një rënie të lehtë prej 4 pp. Ekziston gjithashtu një prirje pozitive e rritjes së të anketuarve nga zonat rurale me 6 pp., e cila, së bashku me rënien e lehtë të të anketuarve nga zonat urbane me 3 pp., balancon dallimin midis tyre nga 5 vitet e fundit (shih Tabelën 6).

Tabela numër 6

Pasja e miqve dhe të njohurve që janë anëtarë të një partie politike me pikëpamjet e së cilës nuk pajtohen


Gjinia:	Burrë				Grua		
2009	91%				85%		
2018	84%				80%		
2023	85%				80%		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	85%	91%	87%	90%	87%	86%	
2018	70%	81%	86%	86%	84%	86%	
2023	76%	83%	85%	85%	88%	88%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	81%		90%		97%		
2018	72%		84%		87%		
2023	77%		84%		88%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	90%				85%		
2018	88%				65%		
2023	84%				78%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	90%				83%		
2018	88%				70%		
2023	84%				80%		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	88%				87%		
2018	86%				76%		
2023	83%				82%		

1.2 Përkatësia në një pakicë të caktuar në mjedisin lokal

Përqindja e të anketuarve që e përjetojnë veten se i përkasin një pakice në vendin ku jetojnë në pesë vitet e fundit është rritur me 5 pikë përqindje, duke iu afruar 42% që nga viti **2009** (35% në **2018**/ 40% në **2023**).⁵ Në të gjithë periudhën, më të shumtë janë ata/ato që ndjehen si pakicë etnike (**2009** – 16%; **2018** – 13%, **2023** – 18%), e cila në periudhën prej 5 vjetësh shënon një rritje

prej 5 p.p. dhe është më e larta në të gjithë periudhën e hulumtimit ndër vite. E dyta është pakica fetare (**2009** – 8%; **2018** – 9%, **2023** – 9%), e ndjekur nga pakica për sa i përket përkatësisë politike (**2009** – 12%; **2018** – 9%, **2023** – 7%), e cila ka rënë paksa me kalimin e viteve. Në të njëjtën kohë, një numër shumë i vogël i të anketuarve deklarojnë se i përkasin një pakice për sa i përket aftësisë së kufizuar (**2009** – 3%; **2018** – 3%, **2023** – 4%) dhe orientimit seksual (**2009** – 1%; **2018** – 1%, **2023** – 2%) (shih grafikun numër 2).

Grafiku numër 2 A mendoni se në vendbanimin tuaj përkisni në ...?



Ndryshe nga maqedonasit etnikë, shqiptarët etnikë në numër të madh ndjehen si një pakicë etnike në vendin ku jetojnë. Dhe numri i shqiptarëve/eve etnikë/e që deklaruan se ishin anëtarë të një pakice etnike është rritur në mënyrë dramatike me 10 pikë përqindje në pesë vitet e

fundit dhe është më i larti ndonjëherë në katërmëdhjetë vitet e fundit (**2009** – 21%; **2018** – 17%, **2023** – 27%). Numri i maqedonasve/eve etnikë/e që ndjehen si pakicë etnike në vendin ku jetojnë gjithashtu ka një rritje të lehtë prej 3 për qind (**2009** – 8%; **2018** – 5%, **2023** – 8%).

⁵ Pyetja ka mundësi për përgjigje të shumëfishta, kështu që përqindja është më e lartë se 100%.

Në bazë të përkatësisë politike, numri i maqedonasve etnikë është ulur me 3 pikë të përqindjes që nga viti 2018, ndërsa midis shqiptarëve etnikë ka mbetur i njëjtë. Numri i atyre që ndiheshin si anëtarë të një pakice fetare, sipas përkatësisë

fetare të deklaruar të të anketuarve/ave, nuk ndryshoi. Numri i myslimanëve është më i madh se ai i anëtarëve/eve të besimit të krishterë (shih Tabelën numër 7).

Tabela numër 7

A mendoni se në vendbanimin tuaj përkisni në ...

Pakicë etnike:	Përkatësia etnike:	
	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	8%	21%
2018	5%	17%
2023	8%	27%
Minoriteti për sa i përket përkatësisë politike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	9%	20%
2018	9%	9%
2023	6%	9%
Minoriteti për sa i përket përkatësisë fetare:	Përkatësia religjioze:	
	I/e krishterë/e	Mysliman/e
2009	4%	16%
2018	6%	16%
2023	6%	17%

2. Perceptimi i diskriminimit

2.1 Niveli i perceptuar i diskriminimit

Rezultatet e katër sondazheve të kryera në vitet 2009, 2013, 2018 dhe 2023 tregojnë se sipas perceptimit të publikut, diskriminimi është më i përhapur, për sa i përket perceptimit se mungon (shih grafikun numër 3). Gjatë katërmbëdhjetë viteve të fundit, sondazhet kanë regjistruar një rënie të numrit të qytetarëve që besojnë se diskriminimi nuk ekziston në vend, për të gjitha llojet e diskriminimit (**2009** - 14%; **2013** - 13%; **2018** - 9%; **2023** - 9%),⁶ por në pesë vitet e fundit ato kanë ngecur. Gama e perceptimeve se diskriminimi nuk ekziston ndryshon nga 2% për përkatësinë politike në 18% për religjionin dhe besimin dhe personat me aftësi të kufizuara.

Përgjigjet "Nuk e di" në pyetjen se sa i zakonshëm është diskriminimi, në lidhje me të gjitha bazat e diskriminimit, janë në nivelin e vlerave margjinale, duke ndryshuar nga 2% në 5%. Përgjashtimi i vetëm për këtë janë përgjigjet ndaj diskriminimit në bazë të orientimit seksual, i cili në tre sondazhet e mëparshme mbulonte 20%, dhe në vitin 2023 u ul në 14%.

Për të fituar njohuri të sakta për ndryshimet në perceptimet e subjekteve, diskriminimi mbi të gjitha bazat renditet nga më i përhapuri në më pak i përhapuri. A perceptohet diskriminimi si i shpeshtë, përcaktohet duke përdorur përgjigjet e grumbulluara nga "shumë e shpeshtë" dhe "mjaft e shpeshtë".

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike konsiderohet më i zakonshmi dhe më i përhapuri, në të gjitha hulumtimet. Thuhej se ishte i zakonshëm në **2009** - 78%, **2013** - 78%, **2018** - 77% dhe në **2023** - 77%.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike mbetet si i dyti më i përhapuri në të gjitha sondazhet (**2009** - 55%; **2013** - 51%; **2018** - 50%; **2023** - 53%).

Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar renditet një vend më lart si i treti në sondazhet e fundit, për shkak të rritjes me 8 pikë përqindje të përgjigjeve që është e shpeshtë, nga 45% - **2009**, 42% - **2013**, 41% - **2018** në 49% - **2023**. Në **diskriminimin e moshës, ekziston një ngecje në perceptimin e prevalencës së** saj në tre valët e fundit të sondazhit, por ka një rënie të konsiderueshme nga 49% në 2009 në 40% në 2013 (49% - **2009**, 40% - **2013**, 41% - **2018** në 42% - **2023**).


Diskriminimi në bazë të fesë dhe besimit tregon disa ndryshime në përgjigjet që janë të shpeshtë, nga 37% në vitin 2009 në 42% në sondazhin e fundit të vitit 2023 (37% - **2009**, 41% - **2013**, 39% - **2018** në 42% - **2023**).

Diskriminimi me bazë gjinore tregon disa ndryshime në përgjigjet se është e shpeshtë, nga 37% më e ulët në 2013 dhe 2018, në 40% në sondazhin e fundit të vitit 2023, si dhe në sondazhin e parë të vitit 2009 (40% - **2009**, 37% - **2013**, 37% - **2018** në 40% - **2023**).

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual u rendit më i larti në vitin 2013 me 46% të të anketuarve që deklaruan se është i zakonshëm, që atëherë ky numër ka rënë pak dhe në vitin 2023 është në nivelin më të ulët prej 38%, i ngjashëm me 40% të sondazhit të parë në vitin 2009 (40% - **2009**, 46% - **2013**, 44% - **2018** në 38% - **2023**).

⁶ Përqindja është fituar si një mesatare e përgjigjeve "nuk ekziston" për të gjitha kategoritë e pyetura të të anketuarve/ave.

Grafiku numër 3 Sa e zakonshme është secila prej këtyre formave të diskriminimit në vendin tonë?



■ Shumë shpesh ■ Mjaft shpesh ■ Mjaft rrallë ■ Shumë rrallë ■ Nuk ekziston

Duke iu referuar rezultateve sipas karakteristikeve socio-demografike, mund të vërehet se të anketuarit që konsiderojnë se diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është i zakonshëm janë:

- Burrat (**2009** - 80%; **2018** - 79%; **2023** - 79%) sesa gratë (**2009**, **2018** dhe **2023** - 76%); dhe
- Të anketuarit/arat me arsim më të lartë (**2009** - 79%; **2018** - 77%; **2023** - 79%) dhe arsim të mesëm (**2009** - 81%; **2018** - 82%; **2023** - 81%) sesa me arsim fillor (**2009** - 73%; **2018** - 67%; **2023** - 72%).

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike perceptohet si i zakonshëm, më shumë se:

- Të anketuarit/at me arsim më të lartë (**2009** - 54%; **2018** - 50%; **2023** - 59%) sesa të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar (**2009** - 53%; **2018** - 49%; **2023** - 50%);
- shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 75%; **2018** - 63%; **2023** - 52%) dhe maqedonasit/ et etnikë/e (**2009** - 48%; **2018** - 45%; **2023** - 51%) barazuan në 2023
- Myslimanët/et (**2009** - 69%; **2018** - 59%; **2023** - 56%) sesa të krishterët/et (**2009** - 48%; **2018** - 45%; **2023** - 51%).

Perceptimi i diskriminimit në bazë të etnisë si i zakonshëm, zvogëlohet ndjeshëm midis shqiptarëve/eve dhe myslimanëve/eve etnikë/e dhe rritet midis maqedonasve/eve dhe të krishterëve/eve etnikë/e. Në vitin 2023, nuk ka asnjë ndryshim në perceptimin e diskriminimit etnik midis dy grupeve më të mëdha etnike, përkatësisht çdo i/e dyti/a shqiptar/e etnik/e e perceptojnë si të shpeshtë. Ndërsa në dy fetë më të mëdha tenton të barazohet.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual perceptohet si i shpeshtë më shumë se:

- Të anketuarit/at e moshës 15 deri në 24 vjeç (**2009** dhe **2018** - 49%; **2023** - 48%) sesa të anketuarit/at e moshës mbi 65 vjeç (**2009** - 29%; **2018** - 33%; **2023** - 26%);
- Të anketuarit/at me arsim më të lartë (**2009** - 47%; **2018** - 50%; **2023** - 44%) sesa ato me arsim fillor (**2009** - 30%; **2018** - 38%; **2023** - 34%); dhe

- Maqedonasit/et etnikë/e (**2009** - 45%; **2018** - 46%; **2023** - 37%) dhe shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 28%; **2018** - 43%; **2023** - 38%) barazuan në 2023
- Myslimanët/et (**2009** - 27%; **2018** - 42%; **2023** - 41%) sesa të krishterët/et (**2009** - 45%; **2018** - 45%; **2023** - 37%).

Krahasuar me 5 vjet më parë, perceptimi i diskriminimit në bazë të orientimit seksual është zvogëluar ndjeshëm midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe maqedonasve/eve etnikë/e, dhe në vitin 2023 ai barazohet midis këtyre dy grupeve. Më shumë anëtarë të fesë myslimane perceptojnë se ky diskriminim është i zakonshëm sesa anëtarët e fesë së krishterë, e cila ka parë një rënie të konsiderueshme në 5 vitet e fundit.

Diskriminimi në bazë të seksit perceptohet si i zakonshëm, si më e shpeshtë te:

- Gratë (**2009** - 43%; **2018** - 40%; **2023** - 43%) sesa burrat (**2009** - 37%; **2018** - 34%; **2023** - 37%)
- Shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 49%; **2018** - 40%; **2023** - 49%) sesa maqedonasit/et etnikë/et (**2009** - 38%; **2018** - 36%; **2023** - 38%)
- Myslimanët/et (**2009** - 44%; **2018** - 40%; **2023** - 44%) sesa të krishterët/et (**2009** - 38%; **2018** - 36%; **2023** - 38%).

Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar perceptohet si i më i zakonshëm në:

- Gratë (**2009** - 44%; **2018** - 44%; **2023** - 52%) sesa burrat (**2009** - 45%; **2018** - 39%; **2023** - 46%)
- Të anketuarit/ate moshës 15-24 vjeç (**2009** - 45%; **2018** - 36%; **2023** - 43%) sesa të anketuarit/at e moshës 35-44 vjeç (**2009** - 43%; **2018** - 42%; **2023** - 54%) dhe ata/ato të moshës 65+ (**2009** - 42%; **2018** - 43%; **2023** - 53%)
- maqedonasit/et etnikë/e (**2009** - 44%; **2018** - 44%; **2023** - 48%) dhe shqiptarët/et etnikë/et (**2009** - 53%; **2018** - 35%; **2023** - 47%) barazuan në vitin 2023
- Të anketuarit/at në zonat urbane (**2009** - 45%; **2018** - 46%; **2023** - 51%) sesa në zonat rurale (**2009** - 45%; **2018** - 35%; **2023** - 45%).

Në 5 vitet e fundit, perceptimi i diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar si frekuencë është rritur ndjeshëm në popullatën e grave dhe burrave, por është akoma më i shpeshtë tek gratë. Të anketuarit/at e moshës 35 deri në 44 vjeç dhe mbi 65 vjeç më shpesh e perceptojnë atë si të shpeshtë, dhe në popullsinë më të re 15-24 përqindja është më e vogla, por në të gjitha këto grup moshë ka një rritje të perceptimit në 5 vitet e fundit. Ka një rritje midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe më të butë midis maqedonasve/eve etnikë/e, dhe në vitin 2023 ajo barazohet midis këtyre dy grupeve. Të anketuarit/at në zonat urbane përgjigjen në numër më të madh se ky diskriminim është i zakonshëm sesa ato nga zonat rurale, por në të dy grupet shohim një rritje të perceptimit.

Diskriminimi ndaj moshës perceptohet si më i zakonshëm te:

- Të anketuarit/at mbi moshën 65 vjeç (**2009** - 50%; **2018** - 46%; **2023** - 48%) sesa të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç (**2009** - 44%; **2018** - 33%; **2023** - 31%);
- Ndër lëndët me arsim të mesëm (**2009** - 51%; **2018** - 44%; **2023** - 42%) dhe me arsim fillor (**2009** - 44%; **2018** - 41%; **2023** - 42%), ka një barazim në 2023; dhe
- Maqedonasit/et etnikë/e (**2009** - 51%; **2018** - 46%; **2023** - 42%) sesa shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 43%; **2018** - 31%; **2023** - 37%).

Hendeku i brezave në perceptimin nëse diskriminimi i moshës është i zakonshëm, midis popullsisë më të re dhe më të vjetër në sondazh është rritur me kalimin e viteve, dhe është më i madhi në këtë valë dhe është 17 pp. Ky perceptim në vitin 2023 barazohet midis të anketuarve sipas shkallës së arsimit të përfunduar. Maqedonasit/et etnikë/e ende e perceptojnë diskriminimin më shpesh në bazë të moshës sesa shqiptarët/et etnikë/e, por dallimi i tyre tenton të barazohet.

Diskriminimi në bazë të fesë dhe besimit perceptohej si më i shpeshtë te:

- Të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç (47% në tre sondazhet) sesa të moshuarit e moshës mbi 65 vjeç (**2009** - 31%; **2018** - 28%; **2023** - 44%);

- Shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 50%; **2018** - 49%; **2023** - 41%) dhe maqedonasit/et etnikë/e (**2009** - 32%; **2018** - 35%; **2023** - 40%) kanë një barazim në 2023; dhe
- Myslimanët/et (**2009** - 47%; **2018** - 46%; **2023** - 45%) sesa të krishterët/et (**2009** - 32%; **2018** - 35%; **2023** - 40%).

Perceptimi se diskriminimi në bazë të fesë dhe besimit është i zakonshëm vërehet qartë në një numër më të madh të rinjve të moshës 15 deri në 24 vjeç, si në 2009, 2018 dhe 2023, me 47%. Por në 5 vitet e fundit, ka pasur një rritje të konsiderueshme të perceptimit midis të rriturve mbi 65 vjeç. Në valën e fundit të sondazhit, maqedonasit/et etnikë/e dhe shqiptarët/et etnikë/e gjithashtu e perceptuan diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit si të shpeshtë, ky nivelim është për shkak të rënies së perceptimit midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe rritjes midis maqedonasve/eve etnikë/e. Shumica e anëtarëve të fesë myslimane e perceptojnë se ky diskriminim është i zakonshëm dhe në një masë më të vogël një perceptim i tillë është i pranishëm midis anëtarëve të fesë së krishterë. Hulumtimi i fundit tregon një tendencë për të zvogëluar hendekun e perceptimit midis të anketuarve nga të dy fetë, për shkak të rritjes së perceptimit midis anëtarëve të fesë së krishterë.

2.2 Niveli i perceptuar i diskriminimit në periudhën afatmesme


Analiza e përgjigjeve në lidhje me mënyrën se si lloje të caktuara të diskriminimit krahasohen me situatën e pesë viteve më parë bën të mundur vlerësimin e perceptimit të të anketuarve për një periudhë më të gjatë kohore. Këto perceptime të diskriminimit janë një lloj treguesi përmes të cilit mund të vlerësohen efektet e masave të marra në luftën kundër diskriminimit. Përgjigjet se disa lloje të diskriminimit janë më të shpeshta janë një tregues i dështimit për të luftuar diskriminimin, ndërsa përgjigjet se disa lloje të diskriminimit janë më pak të shpeshta tregojnë efektet pozitive të përpjekjeve për të zvogëluar diskriminimin.

Rezultatet e anketës tregojnë se për sa i përket diskriminimit në bazë të përkatësisë politike në **vitin 2009**, 60% e të anketuarve e konsideruan

atë më të shpeshtë se në 5 vitet e mëparshme, 12% e konsideruan atë më të rrallë dhe 24% mendonin se ka mbetur e njëjtë. Në **vitin 2018**, 57% e vlerësuan më të shpeshta, 11% e vlerësuan më të rralla dhe 30% e vlerësuan të njëjta. Në **vitin 2023**, 60% e vlerësuan më të shpeshtë, 10% e vlerësuan më të rrallë dhe 28% e vlerë-

suan të njëjtë. Që do të thotë se nuk ka pasur ndryshim të rëndësishëm gjatë viteve. Përgjigjet se diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është më i zakonshëm janë më të shumta kur krahasohen me llojet e tjera të diskriminimit, dhe për këtë arsye kjo bazë renditet e para, në të katër sondazhet (shih Grafikonun numër 4).


Grafiku numër 4 Nëse krahasoni situatën aktuale me situatën e 5 viteve më parë, a do të thoshit se format e mëposhtme të diskriminimit janë më të shpeshta ose më pak të shpeshta në vendin tonë?



Për të pasur një pasqyrë të perceptimit të publikut nëse situata e diskriminimit është përqësuar ose përmirësuar, kemi llogaritur një koeficient K⁷ që tregon se sa është përqindja e

përgjigjeve se diskriminimi është “më i shpeshtë” në lidhje me përgjigjet se diskriminimi është “më i rrallë” në krahasim me situatën pesë vjet më parë (shih Grafikon 5).

Grafiku numër 5 Trendi i koeficientit K për pyetjen Nëse krahasoni situatën aktuale me situatën e pesë viteve më parë, a do të thoshit se format e mëposhtme të diskriminimit janë më të shpeshta ose më pak të shpeshta në vendin tonë?



Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike renditet si i pari në të gjitha sondazhet, në vitin 2023 me $K = 6.09$ (më i zakonshëm 60.5%; më

i rrallë 9.9%), që do të thotë se në këtë sondazh pjesa e notës “më e shpeshtë” është 6 herë më e pranishme në krahasim me rezultatet “më

⁷ Koeficienti K përftohet kur nota “më e shpeshtë” pjesëtohet me notën “më pak e shpeshtë”. Çdo vlerë K mbi 1 tregon se sa proporcionalisht më e madhe është pjesëmarrja e notës “më e shpeshtë” krahasuar me notën “më pak e shpeshtë”. Çdo vlerë nën 1 tregon pjesëmarrjen proporcionalisht më të ulët të notës “më e shpeshtë” në krahasim me notën “më pak e shpeshtë”. Koeficienti K më i madh se 1 tregon se nuk janë arritur rezultate të dukshme dhe/ose se stereotipet negative tradicionale përfaqësojnë një pengesë të fshehtë ndaj ndryshimit. Koeficientët nën një, tregojnë një rezultat relativisht pozitiv në luftën kundër diskriminimit në sferën e një fushe specifike që është objekt i hulumtimit.

e rrallë". Cili është ndryshimi më i madh deri më tani.

Kryqëzimi me karakteristikat socio-demografike të të anketuarve tregon se:

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politikenë krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua të jetë më i shpeshtë në grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:

Të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç (**2009** - 61%; **2018** - 54%; **2023** - 65%) dhe ata/ato mbi 65 vjeç (**2009** - 50%; **2018** - 54%; **2023** - 68%) sesa ata/ato mbi 35 deri në 44 vjeç (**2009** - 62%; **2018** - 59%; **2023** - 55%).

- Sipas arsimit:

Në **vitin 2009**, nuk kishte dallim të rëndësishëm midis të anketuarve/ave me nivele të ndryshme të arsimit: arsimi i lartë (59%), arsimi i mesëm (61%), arsimi fillor (58%);

Në **vitin 2018** - më i lartë (60%) dhe arsimi i mesëm (58%) se arsimi fillor (50%).

Në **vitin 2023** - arsimi i lartë (64%) dhe i mesëm (64%) sesa fillor (57%).

Për herë të parë në studimin e fundit nga viti 2023, të anketuarit/at më të moshuar të moshës 45 deri në 54 vjeç dhe mbi 65 vjeç perceptuan se diskriminimi në bazë të përkatësisë politike ishte më i zakonshëm në 5 vitet e fundit, me një rritje të konsiderueshme prej 11 p.p. dhe 14 p.p. Ndërsa për herë të parë në studimin e ri, të anketuarit/at më të rinj të moshës 15-24 vjeç nuk janë më të shumtë që e përjetojnë atë si më të shpeshtë. Niveli i arsimit është gjithashtu i rëndësishëm në analizimin e përgjigjeve. Në vitin 2009, dallimi në perceptimin se diskriminimi është më i zakonshëm është pothuajse i barabartë me nivelin e arsimit, ndërsa në 5 vitet e fundit kemi një kërcim në ata/ato me arsim të mesëm dhe fillor që e konsiderojnë më të shpeshtë, ndërsa ngecje në ata/ato me arsim më të lartë.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike renditet i dyti. Në vitin 2009, koeficienti $K = 1.39$ (më i shpeshtë 36.8%; më i rrallë 26.4%), për vitin 2013 $K = 1.40$ (më i shpeshtë 56%; më i rrallë

40%), 2018 $K = 1.31$ (më i shpeshtë 34.4%; më i rrallë 26.3%) dhe 2023 $K = 2.23$ (më i shpeshtë 44%; më i rrallë 20%). Të dhënat tregojnë se ka pasur një përkeqësim të ndjeshëm të perceptimit të këtij lloji të diskriminimit.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua si më i zakonshëm se grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:

Në **vitin 2009** nga të anketuarit/at e moshës 15 deri në 44 vjeç (ndryshon nga 38% në 40%) sesa tek ata mbi 55 vjeç (ndryshon nga 29% në 33%);

Në **vitin 2018**, të anketuarit/at e moshës 15-34 vjeç (ndryshon nga 39% në 42%) sesa te ata mbi 55 vjeç (ndryshon nga 26% në 27%).

Në **vitin 2023**, nga të anketuarit/at e moshës 15 deri në 34 vjeç (49%) sesa tek ata mbi 65 vjeç (38%).

- Sipas përkatësisë etnike:

Në të tre hulumtimet - nga shqiptarët/et etnikë/e (**2009** - 59%; **2018** - 50%; **2023** - 54%) sesa nga maqedonasit/et etnikë/e (**2009** - 30%; **2018** - 30%; **2023** - 39%).

- Sipas vendbanimit:

Në të tre hulumtimet - nga banorët e zonave rurale (**2009** - 40%; **2018** - 36%; **2023** - 42%) sesa nga banorët e zonave urbane (**2009** - 35%; **2018** - 33%; **2023** - 45%).

Në të gjitha hulumtimet, perceptimi se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është më i zakonshëm zvogëlohet me moshën, në të gjitha kategoritë e moshës ka një rritje të perceptimit se është më i shpeshtë, ndërsa te personat te të cilët ka ndryshime më të mëdha në 5 vitet e fundit janë: grup moshë nga 45 në 55 vjeç dhe personat mbi 65 vjeç me 12 p.p. dhe personat e moshës midis 55 dhe 64 vjeç me 15 p.p. rritje. Lidhur me përkatësinë etnike, megjithëse shqiptarët/et etnikë/e në numër më të madh vlerësojnë se diskriminimi është më i shpeshtë në krahasim me maqedonasit/et etnikë/e në hulumtimet e fundit, ka një rritje të konsiderueshme të

perceptimit të shqiptarëve/eve etnikë/e dhe një rritje të lehtë midis maqedonasve/eve etnikë/e.

Diskriminimi në bazë të fesë dhe besimit u rendit i gjashti në vitin 2009 ($K = 0.92$). Në atë kohë, përgjigjet se diskriminimi është më i rrallë (28.5%) ishin më të shumta në krahasim me përgjigjet se ai është më i shpeshtë (26.2%). Në dy hulumtimet e mëposhtme, koeficienti K është në rritje. Në vitin 2013, $K = 1.02$ (më i shpeshtë 48%; më i rrallë 47%), dhe në vitin 2018, $K = 1.16$ (më i shpeshtë 29%; më i rrallë 25.1%). Në vitin 2023, $K = 1.36$ (më i shpeshtë 35%; më i rrallë 25%). Të dhënat tregojnë se në 5 vitet e fundit, nuk ka pasur ndryshime të mëdha në përvojat e diskriminimit të bazuar në fe dhe besim si më të shpeshta.

Diskriminimi në bazë të religjionit dhe bindjes në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua si më i zakonshëm se grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:
Të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç (**2009** – 32%; **2018** – 37%; **2023** – 38%) sesa të anketuarit/at e moshës mbi 65 vjeç (**2009** – 21%; **2018** – 22%; **2023** – 32%).
- Sipas arsimit:
Të anketuarit/at me arsim të mesëm (**2009** – 28%; **2018** – 30%; **2023** – 33%) dhe arsim të lartë (**2009** – 28%; **2018** – 31%; **2023** – 37%) dhe me arsim fillor (**2009** – 22%; **2018** – 25%; **2023** – 35%) janë pothuajse të barabartë në vitin 2023.
- Sipas përkatësisë etnike:
Në të dy hulumtimet - shqiptarët/et etnikë/e (**2009** dhe **2018** - 38%; **2023** – 41%) sesa maqedonasit/et etnikë/e (**2009** – 22%; **2018** - 26%; **2023** – 30%).
- Sipas përkatësisë fetare:
Në të dy hulumtimet - nga myslimanët/et (**2009** dhe **2018** - 35%; **2023** – 44%) sesa të krishterët/et (**2009** - 22%; **2018** - 26%; **2023** – 30%).
- Sipas vendbanimit:
Në **vitin 2009** nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, urban (27%) apo rural (25%);

Në **vitin 2018**, më shumë nga banorët/et ruralë (31%) sesa banorët/et urbanë (28%);

Në **vitin 2023**, më shumë nga banorët/et e zonave urbane (37%) sesa të zonave rurale (31%).

Hulumtimi i vitit 2023 tregon rritje në grup moshat 55-64 vjeç dhe mbi 65 vjeç nga 10 p.p. Në të gjitha valët, perceptimi i shpeshtësisë së diskriminimit në bazë të fesë dhe besimit zvogëlohet me moshën, por në valën e fundit të vitit 2023 dallimet e tyre janë shumë të afërta. Hulumtimi i fundit nuk tregoi dallime të rëndësishme midis nivelit të arsimit të të anketuarve/ave. Sipas përkatësisë fetare, myslimanët/et në të tre hulumtime (2009, 2018 dhe 2023) vlerësuan se diskriminimi është më i shpeshtë në krahasim me të krishterët/et. Dhe sipas përkatësisë etnike, shohim rritje të dy grupet në perceptimin për frekuencën e saj, por ende shqiptarët/et etnikë/e e perceptojnë atë si më të shpeshtë se maqedonasit/et etnikë/e.

Diskriminimi në bazë të moshës në vitin 2009 u rendit i treti, koeficienti $K = 1.48$ (më i shpeshtë 33%; më pak i shpeshtë 22.3%). Në vitin 2013, koeficienti u zvogëlua $K = 1.04$ (më i shpeshtë 48%; më pak i shpeshtë 46%). Në vitin 2018, koeficienti K vazhdon të ulet dhe bie nën numrin një $K = 0.90$ (më i shpeshtë 25.5%; më pak i shpeshtë 28.3%). Në vitin 2023, koeficienti u rrit $K = 1.51$ (më i shpeshtë 33%; më i rrallë 21%) dhe është në nivelin më të lartë deri tani në të gjitha hulumtimet. Kjo tregon një perceptim në rritje të incidencës së diskriminimit në bazë të moshës.

Diskriminimi në bazë të moshës në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua të jetë më i shpeshtë në grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:
Në **vitin 2009**, nga të anketuarit/at e moshës 55 deri në 64 vjeç (43%) sesa të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç (26%);
Në **vitin 2018** nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në grup moshat nga 15 në 24 vjeç (28%), pra nga 55 në 64 vjeç (26%).

Në **vitin** 2023 nga të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç (39%) sesa grup moshat e tjera.

- Sipas arsimit:

Në **vitin 2009**, të anketuarit/at me arsim të lartë (38%) dhe të mesëm (36%) sesa me arsim fillor (28%);

Në **vitin 2018** nuk ka asnjë ndryshim të rëndësishëm sipas nivelit të arsimit: fillor dhe të mesëm (26%) dhe arsimit të lartë (24%).

Në **vitin 2023**, të anketuarit/at me arsim të mesëm (36%) sesa me arsim fillor (31%).

Rezultatet tregojnë se në vitin 2023, të gjitha grup moshat dhe nivelet e arsimit përjetuan një rritje të perceptimit të incidencës së këtij lloji të diskriminimit, krahasuar me pesë vitet e mëparshme, por raporti i tyre ndryshoi. Në vitin 2023, të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç dhe të anketuarit/at me arsim të mesëm të përfunduar diskriminimin e shohin më të shpeshtë në bazë të moshës, krahasuar me kategoritë e tjera.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual në vitin 2009 ishte me $K = 1.05$, gjë që tregon se kishte një ekuilibër midis vlerësimeve se diskriminimi është më i shpeshtë (24.8%) krahasuar me vlerësimin se është më i rrallë (23.7%). Në vitin 2013, koeficienti u rrit $K = 1.37$ (më i shpeshtë 48%; më i rrallë 35%) dhe u rendit i pesti, ndërsa në vitin 2018 $K = 1.18$ (më i shpeshtë 24.5%; më i rrallë 20.8%) u ul, por pavarësisht kësaj mbeti i pesti. Në vitin 2023, $K = 1.11$ (më i shpeshtë 28%; më i rrallë 26%).

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua si më i shpeshtë, më shumë nga këto grupe të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:

Në të dy hulumtimet, të anketuarit/at më të rinj/reja të moshës 15 deri në 24 vjeç (**2009** – 28%; **2018** – 31%; **2023** – 30%) sesa të anketuarit/at e moshës mbi 65 vjeç (**2009** – 21%; **2018** – 19%; **2023** – 23%).

- Sipas arsimit:

Në të dy hulumtimet, të anketuarit/at me arsim të lartë (**2009** – 28%; **2018** – 27%; **2023** – 30%) sesa me arsimin fillor (**2009** – 20%; **2018** – 22%; **2023** – 25%).

Në të tre hulumtimet 2009, 2018 dhe 2023, të rinjtë dhe të anketuarit/at me arsim të lartë vlerësuan se diskriminimi mbi këtë bazë ishte më i shpeshtë në krahasim me pesë vitet e mëparshme, krahasuar me të anketuarit/at e moshës mbi 65 vjeç dhe të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar.

Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar në vitin 2009 kishte një koeficient prej $K = 0.91$, kur 26.9% e të anketuarve/ave e vlerësuan më të shpeshtë ndërsa 29.6% e vlerësuan më pak të shpeshtë. Në vitin 2013 shënoi rënie në $K = 0.82$ (më i shpeshtë 42%; më i rrallë 51%) dhe vazhdoi të bjerë në vitin 2018 kur arriti $K = 0.75$ (më i shpeshtë 22.7%; më i rrallë 30.2%). Në vitin 2023, koeficienti u rrit $K = 1.29$ (më i shpeshtë 32%; më i rrallë 25%) dhe është në nivelin më të lartë deri tani në të gjitha hulumtimet. Kjo tregon një perceptim në rritje të incidencës së diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar.

Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua të jetë më i shpeshtë në grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas moshës:

Në **vitin 2009** - të anketuarit/at e moshës 15 deri në 44 vjeç (26%) sesa të anketuarit/at mbi 65 vjeç (18%);

Në **vitin 2018**, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në perceptim sipas moshës së të anketuarve/ave nga 15 në 24 vjeç, pra mbi 65 vjeç (25%).

Në **vitin 2023** - të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç dhe mbi 65 vjeç (36%), sesa ndër më të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç (26%);

- Sipas përkatësisë etnike:

Në të tre hulumtimet – shqiptarët/et etnikë/e (**2009** – 38%; **2018** – 29%; **2023** – 42%) sesa maqedonasit/et etnikë/e (**2009** – 24%; **2018** – 22%; **2023** – 28%).

Në hulumtimin e vitit 2023, pati një rritje të madhe prej 11 p.p. te popullsia më e vjetër mbi 65 vjeç në perceptimin e incidencës së diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar sesa pesë vjet më parë, duke i bërë ata, për herë të parë, grup moshën më të shqetësuar në krahasim me të tjerët. Ndërkaq për herë të parë, të rinjtë e konsiderojnë këtë lloj diskriminimi më pak të shpeshtë. Sa i përket përkatësisë etnike, shqiptarët/et etnikë/e e konsiderojnë këtë diskriminim më të shpeshtë në krahasim me maqedonasit/et etnikë/e në tre hulumtimet, dhe në të dy grupet në vitin 2023 ka një rritje të perceptimit të shpeshtësisë së këtij lloji të diskriminimit.

Diskriminimi me bazë gjinore u rendit i katërti në vitin 2009 me koeficient $K = 0.93$ (më i shpeshtë 27.3%; më i rrallë 29.3%), në vitin 2013 u rendit i gjashti me $K = 0.94$ (më i shpeshtë 46%; më i rrallë 49%), ndërsa në vitin 2018 zuri pozicionin e shtatë, me $K = 0.67$ (më i shpeshtë 20.5%; më i rrallë 30.4%). Në vitin 2023, koeficienti u rrit $K = 1.28$ (më i shpeshtë 32%; më i rrallë 24%) dhe është në nivelin më të lartë deri tani në të gjitha hulumtimet. Kjo tregon një perceptim në rritje të incidencës së diskriminimit në bazë të gjinisë.

Diskriminimi në bazë të gjinisë në krahasim me situatën pesë vjet më parë u perceptua të jetë më i shpeshtë në grupet e mëposhtme të të anketuarve/ave:

- Sipas gjinisë:
Në hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018 – nuk kishte dallim të rëndësishëm midis burrave (2009 - 27%; 2018 - 20%; 2023 - 28%) dhe grave (2009 - 28%; 2018 - 21%; 2023 - 28%).
Në vitin 2023 gratë (33%) sesa burrat (30%)
- Sipas arsimit:

Në hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018 – të anketuarit/at me arsim të mesëm (2009 - 29%; 2018 - 22%; 2023 - 28%) dhe të lartë (2009 - 30%; 2018 - 20%; 2023 - 28%) sesa me arsimin fillor (2009 - 24%; 2018 - 18%; 2023 - 28%)

Në vitin 2023, të anketuarit/at me arsim të lartë (33%) sesa me arsim fillor (30%)

- Sipas përkatësisë etnike:
Në tre hulumtimet – shqiptarët/et etnikë/e (2009 - 35%; 2018 - 24%; 2023 - 42%) sesa maqedonasit/et etnikë/e (2009 - 26%; 2018 - 19%; 2023 - 27%).

Në vitin 2009 dhe 2018, si burrat ashtu edhe gratë, në numër të barabartë, konsideruan se diskriminimi në bazë të gjinisë është më i shpeshtë, dhe në hulumtimin e fundit, një ndryshim i vogël po fillon të ndihet midis grave që e perceptojnë atë si më të shpeshtë në 5 vitet e fundit sesa burrat. Të dhënat tregojnë një rritje të madhe të perceptimit midis dy grupeve etnike, veçanërisht midis shqiptarëve/eve etnikë/e, e cila është rritur me 18 pikë të përqindjes, duke e bërë dallimin më të madh ndonjëherë midis tyre dhe maqedonasve/eve etnikë/e.

2.3 Pranimi i dallimeve

Hulumtimi tregon një prirje të qëndrueshme të gatishmërisë së lartë të të anketuarve/ave për të pranuar grupe të ndryshme në sferën e tyre private të jetës⁸. Rezultatet tregojnë se gatishmëria është më e madhe për pranimin e një fqinji/nje që është anëtar/e ose simpatizant/e i/e një partie⁹ politike "tjetër" dhe personave me aftësi të kufizuara. Midis anëtarëve/eve të komuniteteve "të tjera" fetare dhe etnike, hulumtimi i fundit tregon një prirje negative të gatishmërisë më të ulët për t'i pranuar ata, kra-


⁸ Në hulumtimet e viteve 2009, 2018 dhe 2023, të anketuarit u pyetën: "Duke përdorur shkallën nga 1 deri në 10, a mund të më thoni se si do të ndiheshit personalisht në secilën prej këtyre situatave". Në shkallën, "1" do të thotë se ndiheni "shumë pakëndshëm" ndërsa "10" do të thotë që ndiheni "mjafat rahat" në atë situatë. Shkalla e përdorur në hulumtimin e vitit 2013 ka ndryshuar: "Duke përdorur shkallën nga 1 në 9, a mund të më thoni se si do të ndiheshit personalisht Ju në secilën prej këtyre situatave?" Në shkallën, "1" do të thotë se ndiheni "shumë pakëndshëm" ndërsa "9" do të thotë që ndiheni "mjafat rahat" në atë situatë. Për këtë arsye, rezultatet e vitit 2013 u morën vetëm si një tregues për të identifikuar ndryshimet e mundshme të mëdha në strukturën e qëndrimeve në popullatë.

⁹ Termi "tjetri/a" në thojza përdoret për të treguar se bëhet fjalë për grupe/komunitete të cilave u përkasin të anketuarit/at.

hasuar me 5 vjet më parë. Pranimi i një fqinj/e i/e cili/a është nga komuniteti etnik rom është mjaft i lartë, por ende më i ulët se ata që përgjithësisht pranojnë një fqinj/e të përkatësisë etnike "tjetër". Më e vogël është gatishmëria për

të pranuar persona me orientime të ndryshme seksuale. Distanca sociale shumë e theksuar nga ky grup tregon një tendencë për një rënie të lehtë në vitin 2023 (shih grafikun numër 6).¹⁰

Grafiku numër 6 Duke përdorur shkallën nga 1 (shumë e pakëndshme) deri në 10 (mjaft rehat), shënoni se si do të ndiheshit personalisht nëse do të kishit një fqinj/e që është ...?



Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e rom/e është më e lartë në:

- Të anketuarit/at mbi moshën 65 vjeç sesa të anketuarit/at të moshës 15-24 vjeç;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Banorët/et e zonave urbane sesa rurale.

Hulumtimi i fundit tregon një prirje pozitive të rritjes së gatishmërisë së popullsisë së re nga moshë 15 deri në 24 vjeç për të pranuar fqinj/e rom/e. Rezultatet gjithashtu tregojnë një prirje të vazhdueshme gjatë viteve të gatishmërisë më të madhe për pranimin e romëve/eve midis maqedonasve/eve etnikë/e dhe banorët/et e zonave urbane, megjithëse ka pasur një rënie në të dy kategoritë në 5 vitet e fundit (shih Tabelën 8).

¹⁰ Është fituar si vlerë mesatare në sistemin spss përmes ndryshoreve të koduara pa vlerat "Nuk e di" dhe "indiferent/e".

Tabela numër 8

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e rom/e						
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7.5	7.7	7.7	7.8	8.1	8.0
2018	6.9	7.4	7.8	7.6	7.6	7.9
2023	7.6	7.2	7.5	7.3	7.3	7.3
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8.0			6.5		
2018	8.2			5.8		
2023	7.8			5.7		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8.0			7.3		
2018	8.0			6.9		
2023	7.5			7.1		

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e me aftësi të kufizuar është më e lartë te:

- Të anketuarit/at me arsim të lartë sesa ta të anketuarit/at me arsim fillor;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Të ndihesh rehat të kesh një fqinj/e me aftësi të kufizuara është një nga kategoritë më të

vlerësuara në hulumtim. Hulumtimi i fundit tregon pothuajse barazim sipas nivelit të arsimit dhe vendbanimit midis të anketuarve/ave. Gatishmëria më e ulët për të pranuar persona me aftësi të kufizuara është regjistruar midis shqiptarëve/eve etnikë/e, të cilët gjithashtu tregojnë prirje të lehtë të rritjes së distancës sociale prej tyre me kalimin e viteve (shih Tabelën 9).

Tabela numër 9

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e rom/e			
Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë
2009	8.4	8.6	8.5
2018	7.6	8.3	8.4
2023	7.9	8.1	8.1
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e
2009	8.8		7.4
2018	8.6		6.9
2023	8.6		6.4
Vendbanimi:	Urban		Rural
2009	8.8		8.1
2018	8.4		7.8
2023	8.0		8.1

Shkalla e rehatisë për të pasur një person me orientim të ndryshëm seksual për fqinj/e është më e lartë te:

- Të anketuarit/at e moshës 35 deri në 44 vjeç, sesa ata të moshës 65 vjeç e lart;
- Të anketuarit/at me arsim të lartë sesa ta të anketuarit/at me arsim fillor.

Hulumtimi i vitit 2023 tregon një nivelim të dallimit midis grupeve të shumta socio-demografike mbi gatishmërinë e përfshirjes sociale të homoseksualëve midis të anketuarve/ave. Një prirje

pozitive e gatishmërisë më të lartë për pranimin e homoseksualëve është e dukshme tek gratë, të anketuarat e moshës 15 deri në 44 vjeç dhe 55 deri në 64 vjeç, në të gjitha nivelet e arsimit, në të dy nivelet e mëdha etnike dhe komunitete, veçanërisht midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe myslimanëve/eve dhe të anketuarve/ave që jetojnë në zonat rurale. Për herë të parë në hulumtim, në valën e fundit të vitit 2023, dallimet midis grupeve etnike dhe fetare pothuajse u barazuan (shih Tabelën numër 10).

Tabela numër 10

Shkalla e rehatisë për të pasur person me orientim të ndryshëm seksual për fqinj/e

Gjinia:	Burrë					Grua	
2009	4.3					4.7	
2018	4.2					4.8	
2023	4.7					4.6	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	4.8	4.6	4.5	4.3	4.4	4.1	
2018	4.5	4.6	5.0	4.4	4.4	3.9	
2023	4.9	5.0	5.2	4.3	4.7	3.9	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	3.9		4.6		5.5		
2018	3.4		4.6		5.2		
2023	3.8		4.8		5.9		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e		
2009	4.9				3.5		
2018	4.8				3.6		
2023	5.0				4.2		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e		
2009	4.8				3.6		
2018	5.1				3.3		
2023	4.9				4.1		
Vendbanimi:	Urban				Rural		
2009	4.8				4.0		
2018	5.2				3.6		
2023	4.8				4.4		

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e nga një grup tjetër etnik është më e lartë te:

- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Hulumtimi i fundit tregon një zgjerim të vazhdueshëm të hendekut midis maqedonasve/

eve etnikë/e dhe shqiptarëve/eve etnikë/e, dhe në të dy kategoritë ekziston një tendencë e rritjes së distancës sociale nga etnitë e ndryshme, e cila është veçanërisht e theksuar midis shqiptarëve/eve etnikë/e (shih Tabelën numër 11).

Tabela numër 11

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e nga një grup tjetër etnik

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7.8	7.6	7.9	7.7	7.9	8.1
2018	7.9	8.0	8.2	8.1	8.0	8.3
2023	8.0	7.7	7.9	7.9	7.9	7.7
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8.0			7.2		
2018	8.5			7.0		
2023	8.2			6.4		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8.1			7.5		
2018	8.4			7.8		
2023	7.9			7.7		

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e të një religjioni ose besimi tjetër është më e lartë te:

- Të anketuarit/at me arsim të lartë, sesa ta të anketuarit/at me arsim fillor;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Hulumtimi i fundit tregon një përkeqësim të vazhdueshëm të gatishmërisë për të pranuar

anëtarë të religjioneve ose besimeve të ndryshme, midis maqedonasve/eve etnikë/e dhe shqiptarëve/eve etnikë/e, si dhe midis dy komuniteteve më të mëdha fetare në vend. Gjatë viteve, shqiptarët/et etnikë/e dhe myslimanët/et kanë treguar më pak gatishmëri për të pranuar fqinj/e të një religjioni ose besimi tjetër sesa maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et (shih Tabelën 12).

Tabela numër 12

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e të një religjioni ose besimi tjetër

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8.0	7.8	8.1	7.8	7.9	8.3
2018	7.9	8.1	8.3	8.2	8.0	8.6
2023	7.8	7.6	7.7	8.0	7.8	7.6
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	7.7		8.0		8.6	
2018	7.7		8.3		8.4	
2023	7.6		7.8		8.0	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8.2			7.2		
2018	8.6			6.9		
2023	8.2			6.4		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2009	8.2			7.5		
2018	8.6			7.4		
2023	8.1			6.9		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8.3			7.5		
2018	8.4			7.8		
2023	7.8			7.6		

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e nga një parti tjetër politike është më e lartë te:

- Të anketuarit/at mbi moshën 65 vjeç sesa të anketuarit/at të moshës 15-24 vjeç;
- Të anketuarit/at me arsim të lartë, sesa ta të anketuarit/at me arsim fillor; dhe
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Një tendencë e vazhdueshme nga 5 vjet më parë vërehet midis grupeve të ndryshme socio-demografike. Hulumtimi i vitit 2023 detekton rehati të reduktuar për të pasur fqinj/e nga një parti tjetër politike midis të anketuarve/ave të moshës 65+, shqiptarëve/eve etnikë/e dhe banorëve të zonave urbane (shih Tabelën 13).

Tabela numër 13

Shkalla e rehatisë për të pasur fqinj/e nga një parti tjetër politike

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8.4	8.6	8.6	8.2	8.4	8.8
2018	7.8	8.0	8.2	8.1	8.3	8.7
2023	7.9	8.0	8.2	7.8	8.1	8.3
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	8.2		8.6		8.9	
2018	7.8		8.3		8.4	
2023	7.8		8.1		8.4	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8.8			7.5		
2018	8.7			6.8		
2023	8.7			6.1		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8.7			8.2		
2018	8.4			7.9		
2023	8.1			8.0		


Kur bëhet fjalë për gatishmërinë për të pranuar dallimet në sferën publike¹¹, studimi tregon se nuk ka ndryshime drastike në shpërndarjen e përgjigjeve midis të anketuarve/ave.

Të anketuarit/at në të gjitha hulumtimet tregojnë më së paku rezerva në lidhje me idenë që një grua të jetë mbajtëse e pozitës më të lartë të pushtetit në vend. E dyta në radhë është gatishmëria e lartë e të anketuarve/ave për të pranuar një anëtar të një partie opozitare si mbajtës të atij posti. Menjëherë pas saj qëndron

gatishmëria për të pranuar persona që i përkasin një grupi fetar ose etnik jo-shumicë, në të cilin është evidentuar një rënie e lehtë, ndërsa dipka më pak prej tyre është gatishmëria për të pranuar persona me aftësi të kufizuar. Kur bëhet fjalë për moshën, për të anketuarit/at është më e pranueshme të mbështesin funksionar/e të ri/re në pozicionin më të lartë të pushtetit sesa një person mbi 75 vjeç. Por gatishmëria për të pranuar persona më të moshuar, është gjithashtu në trend rritës. Më pak e pranueshme për të

¹¹ Në hulumtimet e viteve 2009, 2018 dhe 2023, të anketuarit u pyetën: "Duke përdorur shkallën nga 1 deri në 10, a mund të më thoni se si do të ndiheshit nëse ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të personave do të mbante pozicionin më të lartë të zgjedhur të pushtetit në vend?" (Në shkallën, "1" do të thotë se ndiheni "shumë pakëndshëm" ndërsa "10" do të thotë që ndiheni "mjaft rehat"). Shkalla e përdorur në hulumtimin e vitit 2013 ka ndryshuar: "Duke përdorur shkallën nga 1 në 9, a mund të më thoni se si do të ndiheshit nëse ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të personave do të mbante pozicionin më të lartë të zgjedhur të pushtetit në vend?" (Në shkallën, "1" do të thotë se ndiheni "shumë pakëndshëm" ndërsa "9" do të thotë që ndiheni "mjaft rehat"). Për këtë arsye, rezultatet e vitit 2013 u morën vetëm si një tregues për të identifikuar ndryshimet e mundshme të mëdha në strukturën e qëndrimeve në popullatë.

Grafiku numër 7 Duke përdorur shkallën nga 1 (shumë e pakëndshme) deri në 10 (mjafat rehat), tregoni se si do të ndiheshit nëse bartësi i pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet në vend do të ishte ...?



anketuarit/at është ideja se një person me orientim seksual të ndryshëm është bartës/e i/e detyrës më të lartë të pushtetit në vend. Rezervimi i të anketuarve/ave ndaj këtyre personave shprehet dukshëm në sferën publike, por edhe në sferën private (shih grafikun numër 7)¹².

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një grua si bartëse e pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Gratë sesa burrat;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe

- Banorët/et e zonave urbane sesa rurale.

Gatishmëria për të pranuar një grua si bartëse të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është kategoria më e vlerësuar në të gjitha hulumtimet ndër vite, dhe nuk ka dallime të mëdha sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve/ave, përveç midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend. Vazhdimisht gatishmëria më e madhe për të pranuar një grua si bartëse të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet shprehet nga maqedonasit/et etnike dhe të krishterët/et sesa nga shqiptarët/et etnike dhe muslmanët/et (shih Tabelën numër 14).

¹² Është fituar si vlerë mesatare në sistemin spss përmes ndryshoreve të koduara pa vlerat "Nuk e di" dhe "indiferent/e".

Tabela numër 14

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një grua si bartëse të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet

Gjinia:	Burrë	Grua
2009	8.6	9.2
2018	8.5	9.0
2023	8.5	8.8
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	9.1	8.4
2018	9.2	7.4
2023	9.3	7.0
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e	Mysliman/e
2009	9.1	8.4
2018	9.2	7.9
2023	9.2	7.5
Vendbanimi:	Urban	Rural
2009	9.0	8.7
2018	9.0	8.3
2023	8.8	8.5

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person nga një parti opozitare si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Të anketuarit/at me arsim të lartë, sesa të anketuarit/at me arsim fillor; dhe
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Gjatë viteve, një nga gatishmëritë më të larta për të pranuar një person nga një parti opozitare

në funksionin më të lartë zgjedhor në pushtet ka qenë midis të anketuarve/ave mbi moshën 65 vjeç, të të cilët gjithashtu vërehet një rënie e vazhdueshme. Hulumtimi gjithashtu zbulon një ndryshim të vazhdueshëm sipas nivelit etnik në gatishmërinë për të pranuar një opozitar/e në funksionin më të lartë të pushtetit, e cila në të gjitha hulumtimet është më e lartë te maqedonasit/et etnikë/e sesa te shqiptarët/et etnikë/e (shih Tabelën 15).

Tabela numër 15

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person nga një parti opozitare si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7.8	7.6	7.7	7.7	7.9	7.9
2018	7.0	7.2	7.6	7.4	7.6	8.1
2023	7.0	7.3	7.6	7.2	7.5	7.6
Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë			
2009	7.5	7.8	8.2			
2018	6.9	7.7	7.6			
2023	7.0	7.6	7.8			
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e				
2009	8.0	6.8				
2018	8.0	5.9				
2023	7.9	6.1				
Vendbanimi:	Urban	Rural				
2009	8.1	7.3				
2018	7.8	7.1				
2023	7.4	7.4				

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person që është anëtar/e i/e një pakice etnike ose fetare si bartës të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Të anketuarit/at sipas shkallës së tyre të arsimit;
- Maqedonasit/et etnikë/e dhe shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Të krishterët dhe myslimanët/et.

Shikuar sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve/ave, dallimet në gatishmërinë për të pranuar një anëtar të grupit të pakicave etnike ose fetare në funksion më të lartë ishin pothuajse të niveluara në të gjithë parametrat e rëndësishëm të monitoruar në këtë studim. Ka një prirje të lehtë në rënie të gatishmërisë për pranim me kalimin e viteve midis grupeve etnike dhe fetare, por rezultatet e shqiptarëve/eve etnikë/e dhe myslimanëve/eve janë të vetmet nën mesataren totale të hulumtimit (shih Tabelën numër 16 dhe Tabelën numër 17).

Tabela numër 16

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person që është anëtar/e i/e një pakice etnike ose fetare si bartës të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet:

Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë
2009	6.7	6.4	7.1
2018	6.7	7.1	7.3
2023	6.6	6.8	7.0
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e
2009	6.3		6.8
2018	7.1		6.5
2023	6.9		6.1
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e		Mysliman/e
2009	6.4		7.1
2018	7.1		6.9
2023	6.9		6.4
Vendbanimi:	Urban		Rural
2009	6.8		6.3
2018	7.3		6.8
2023	6.7		6.8

Tabela numër 17

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person që është anëtar/e i/e një pakice fetare si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet:

Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë
2009	6,9	6,6	7,4
2018	6,9	7,3	7,4
2023	6.6	6.9	7.2
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e
2009	6,6		7,0
2018	7,4		6,6
2023	7.0		6.2
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e		Mysliman/e
2009	6,6		7,2
2018	7,4		7,0
2023	7.0		6.6
Vendbanimi:	Urban		Rural
2009	7,0		6,4
2018	7,5		7,0
2023	6.9		6.9

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person më të ri se 30 vjeç si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Të anketuarit e moshës 15 deri në 34 vjeç sesa të anketuarit/at e moshës 45-64 vjeç;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Subjektet më të reja të moshës 15-34 vjeç janë më të gatshme të pranojnë një person më të ri se 30 vjeç në zyrën më të lartë të qeverisë. Me-

gjithëse gatishmëria zvogëlohet me moshën e të anketuarve/ave, megjithatë ende shohim ndryshime në rritje me kalimin e viteve në popullatën e moshuar.

Një rënie e ndjeshme është evidentuar tek shqiptarët/et etnikë/e dhe myslimanët/et, që së bashku me rritjen e lehtë të maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et, për herë të parë në hulumtim ndryshon pozicionet e gatishmërisë së këtyre dy grupeve (shih Tabelën 18).

Tabela numër 18

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person më të ri se 30 vjeç si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7.1	6.5	6.3	6.2	5.8	5.9
2018	7.6	7.0	6.6	6.4	6.3	6.1
2023	7.3	6.9	6.7	6.0	6.2	6.4
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	6.7		6.2		6.1	
2018	7.0		6.6		6.5	
2023	6.5		6.6		6.7	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	6.0			7.6		
2018	6.4			7.2		
2023	6.9			5.9		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2009	6.0			7.2		
2018	6.3			7.4		
2023	6.9			5.9		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	6.2			6.6		
2018	6.6			6.8		
2023	6.3			6.7		

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person më të moshuar se 75 vjeç si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Në pesë vitet e fundit, në të gjitha grupet e konsiderueshme të të anketuarve/ave të analizuar në këtë hulumtim, ka pasur një rritje të gatishmërisë për të pranuar personat e moshuar si bartës të pozitës më të lartë zgjedhore në

pushtet. Rritja më e madhe e gatishmërisë për të pranuar njerëz të moshuar në sferën publike u vërejt tek të anketuarit/at nga të dy gjinitë, popullsia më e re dhe më e moshuar 55+ vjetësh, dy grupet më të mëdha etnike dhe banorët e zonave rurale. Një ndryshim më i rëndësishëm midis karakteristikave socio-demografike ndodh midis maqedonasve/eve etnikë/e, për të cilët është më e pranueshme ideja për bartës së pozitës më të lartë në pushtet të zgjidhet person më i vjetër se 75 vjeç sesa për shqiptarët/et etnikë/e (shih Tabelën 19).

Tabela numër 19

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person më të moshuar se 75 vjeç si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet:

Gjinia:	Burrë			Grua		
2009	3.9			3.3		
2018	4.5			4.4		
2023	5.5			5.2		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	3.7	3.7	3.5	3.4	3.5	3,8
2018	3.5	5.0	4.9	4.2	4.3	4,4
2023	5.4	5.2	5.3	5.0	5.2	5.7
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	3.6			3.5		
2018	4.7			3.9		
2023	5.6			4.6		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	3.8			3.3		
2018	4.7			4.1		
2023	5.4			5.1		

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person me aftësi të kufizuara si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Të anketuarit/at e moshës nga 55 deri në 64 vjeç;
- Të anketuarit/at me nivel më të larta të arsimit të përfunduar;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e;

- Të krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- Banorët/et e zonave urbane.

Hulumtimi i fundit nuk tregon dallime të rëndësishme në profilin socio-demografik të të anketuarve/ave kur bëhet fjalë për shkallën e pranimit të personave me aftësi të kufizuara në sferën publike. Rritja e lehtë pozitive në 5 vitet e fundit vërehet në popullsinë më të re të moshës 15 deri në 24 vjeç dhe të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar (shih Tabelën numër 20).

Tabela numër 20

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person me aftësi të kufizuara si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	6.8	6.6	6.8	6.9	6.5	6.7
2018	5.6	6.8	6.8	6.3	6.7	6.5
2023	6.3	6.4	6.6	6.3	6.7	6.3
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	6.6		6.7		7.1	
2018	5.8		6.6		7.0	
2023	6.4		6.4		6.6	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	6.7			6.7		
2018	6.9			5.8		
2023	6.6			6.0		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2009	6.8			6.6		
2018	6.9			5.7		
2023	6.6			6.0		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	6.9			6.4		
2018	6.9			5.9		
2023	6.6			6.1		

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person me orientim të ndryshëm seksual si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është më e lartë te:

- Të anketuarit/at me arsim të lartë sesa ta të anketuarit/at me arsim fillor.

Gatishmëria për të pranuar person me orientim të ndryshëm seksual si bartës të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet është kategoria e dytë më e vlerësuar pozitivisht në të gjitha hu-

lumtimet ndër vite. Hulumtimi i fundit nga viti 2023 tregon nivelimin e dallimeve sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve/ave. Gatishmëria më e madhe për të pranuar persona me orientim të ndryshëm seksual në sferën publike rritet me arsimin dhe është në trend rritës gjatë viteve. Një tendencë veçanërisht pozitive vërehet edhe midis shqiptarëve/eve etnikë/e, myslimanëve/eve dhe banorëve ruralë (shih Tabelën numër 21).

Tabela numër 21

Shkalla e gatishmërisë për të pranuar një person me orientim të ndryshëm seksual si bartës/e të pozitës më të lartë zgjedhore në pushtet

Gjinia:	Burrë		Grua	
2009	3.2		3.5	
2018	3.6		4.1	
2023	3.8		3.8	
Arsimi:	Fillor	I mesëm		I lartë
2009	3.0	3.5		3.8
2018	3.1	3.9		4.4
2023	3.0	3.9		4.8
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e	
2009	3.6		2.8	
2018	4.2		2.9	
2023	3.8		4.0	
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e		Mysliman/e	
2009	3.6		2.8	
2018	4.2		3.0	
2023	3.8		3.7	
Vendbanimi:	Urban		Rural	
2009	3.6		3.0	
2018	4.4		3.0	
2023	3.9		3.6	


3. Përvojat me diskriminimin

3.1 Përvojat personale me diskriminimin

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se çdo i treti i anketuar është diskriminuar për të paktën një

nga arsyet që janë objekt i hulumtimeve (2009 – 34%; 2013 – 22%¹³; 2018 – 36%; 2023 – 34%). Ndërsa shumica, në numër pothuajse të barabartë, deklaruan se nuk ishin të diskriminuar personalisht (2009 – 65%; 2013 – 78%; 2018 – 64%; 2023 – 65%) (shih grafikun numër 8).

Grafiku numër 8 A jeni ndjerë personalisht të diskriminuar ose të ngacmuar për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme në 12 muajt e fundit?




¹³ Rezultatet nga viti 2013 janë siguruar përmes anketës me telefon, ndryshe nga hulumtimet në terren në vitin 2009, 2018 dhe 2023, dhe për këtë arsye e përdorim atë si një tregues që në thelb tregon të njëjtën strukturë, por me frekuencë të ndryshme përgjigjesh.

3.2 Prezenca gjatë diskriminimit të personave të tjerë

Nga ana tjetër, në situatë si dëshmitarë në të paktën një lloj diskriminimi janë gjetur 38% e

të anketuarve/ave në vitin **2009**, 31% në vitin **2013**, 40% në vitin **2018** dhe 38% në vitin **2023**.¹⁴ 60% thanë se nuk kishin qenë dëshmitarë në vitin **2009** dhe **2018**, 69% në vitin **2013** dhe 59% në vitin **2023** (shih grafikun numër 9).

Grafiku numër 9 Në 12 muajt e fundit, a keni qenë dëshmitarë të diskriminimit ose ngacmimit të dikujt për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme?



Në të gjitha hulumtimet ndër vite, përkatësia politike është lloji më i zakonshëm i diskriminimit, si në situatat kur të anketuarit/at diskriminohen personalisht (**2009** – 18%; **2013** – 13%; **2018** – 18%; **2023** – 11%) ashtu edhe kur paraqiten si

dëshmitarë të diskriminimit (**2009** – 25%; **2013** – 18%; **2018** – 22%; **2023** – 15%). Por në vitin 2023 ka një rënie statistikisht të konsiderueshme si në situatën e diskriminimit personal ashtu edhe në situatën si dëshmitar i diskriminimit

¹⁴ Është krijuar një variabël e re që numëron përgjigjet e të anketuarve/ave ndaj kësaj pyetjeje me përgjigje të shumëfishta. Çdo i/e anketuar paraqet një, dy, tre ose më shumë lloje diskriminimi dhe rezultati është shuma e të gjithë atyre që kanë numëruar një ose më shumë diskriminime.

prej 7 p.p. Ka një rënie të lehtë në të dy rastet e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjë që e barazon dhe e vendos në vend të parë së bashku me diskriminimin politik. Të dhënat tregojnë se në një numër më të madh të rasteve të anketuarit/at ishin në situatë dëshmitare dhe jo të diskriminuar personalisht mbi këtë bazë. Më pak raste u diskriminuan personalisht në bazë të orientimit seksual (**2009** – 1%; **2013** – 0.4%; **2018** – 3%; **2023** – 2%) dhe gjithashtu në numër më të vogël të anketuarit/at e gjetën veten të jenë dëshmitarë të këtë lloj diskriminimi (**2009** – 3%; **2013** – 7%; **2018** – 3%; **2023** – 3%).

Diskriminim personal kanë përjetuar në bazë të përkatësisë politike më shumë:

- Burrat sesa gratë; dhe

- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Baza më e zakonshme e diskriminimit me personal në vend është përkatësia politike, e cila shënon një prirje në rënie në hulumtimin e fundit. Megjithëse në një prirje rënëse, burrat janë akoma më shpesh të ekspozuar ndaj diskriminimit në bazë të përkatësisë politike sesa gratë. Sa i përket përkatësisë etnike të të anketuarve/ave, në vitin 2009 shqiptarët/et etnikë/e (30%) ishin dy herë më të përfaqësuar si viktimë në krahasim me maqedonasit/et etnikë/e (14%). Në vitin 2023, ky lloj diskriminimi u ul ndjeshëm midis shqiptarëve/eve etnikë/e me 14 p.p., të cilët për herë të parë në hulumtim, maqedonasit/et etnikë/e janë më shpesh viktimë të diskriminimit mbi këtë bazë sesa shqiptarët/et etnikë/e (shih Tabelën 22).

Tabela numër 22

Personat që kanë përjetuar diskriminim personal në bazë të përkatësisë politike:

Gjinia:	Burrë	Grua
2009	21%	15%
2018	20%	15%
2023	13%	9%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	14%	30%
2018	18%	22%
2023	12%	8%

Mesatarisht, rreth 79% e popullsisë së përgjithshme e konsiderojnë këtë lloj diskriminimi të shpeshtë, në krahasim me 20% mesatarisht që e konsiderojnë të rrallë. Nga ata që thanë se ishin të diskriminuar mbi këtë bazë, 88% mendonin se ishte diskriminim i shpeshtë ndërsa 12% mendonin se ishte i rrallë. Të dhënat tregojnë se rreth një në shtatë qytetarë deklaruan se ishin diskriminuar për arsye politike. Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është veçanërisht i rëndësishëm sepse lidhet në mënyra të ndryshme me krijimin e kushteve për mundësi të barabarta punësimi dhe shanse të barabarta për të ndërtuar një karrierë profesionale bazuar në merita, aftësi, kualifikime dhe njohuri.

Sipas përvojës personale të diskriminimit, përkatësia etnike e të anketuarve u rendit e dyta në tre hulumtimet e mëparshme (**2009** – 13%; **2013** – 10%; **2018** – 14%; **2023** – 11%), por në hulumtimin e fundit ishte në të njëjtin nivel me diskriminimin për sa i përket përkatësisë politike. Ndërsa ky lloj diskriminimi u rendit i dyti në të katër hulumtimet në situatat ku të anketuarit/at ishin dëshmitarë të diskriminimit (**2009** – 15%; **2013** – 13%; **2018** – 16%; **2023** – 12%).

Diskriminim personal kanë përjetuar në bazë të përkatësisë politike më shumë:

- Burrat sesa gratë; dhe
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e;

- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Krahasuar me maqedonasit/et etnikë/e (5%), në vitin 2009, shqiptarët/et etnikë/e (34%) dukshëm më shpesh deklaruan se ishin diskriminuar personalisht në bazë të përkatësisë etnike. Ky perceptim edhe pas katërmbëdhjetë vjetësh, pavarësisht tendencës për të zvogëluar dallimet midis tyre, është dukshëm më i shpeshtë në mesin e shqiptarëve/eve etnikë/e (23%) krahasuar me maqedonasit/et etnikë/e (5%). Në vendin tonë, përkatësia etnike dhe feja janë të lidhura

ngushtë. Kjo konfirmohet nga të dhënat që tregojnë se përgjigjet e të anketuarve/ave sipas përkatësisë së tyre fetare janë në proporcion shumë të ngushtë me përgjigjet sipas përkatësisë së tyre etnike. Gjinia e të anketuarve/ave kontribuon gjithashtu në përvoja të ndryshme personale me diskriminimin. Sipas deklaratave të të anketuarve/ave, burrat kanë tendencë më të theksuar sesa gratë të deklarojnë se janë diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike¹⁵ (shih Tabelën 23).

Tabela numër 23

Personat që kanë përjetuar personalisht diskriminim për shkak të përkatësisë etnike:

Gjinia:	Burrë	Grua
2009	15%	11%
2018	17%	12%
2023	13%	8%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	5%	34%
2018	7%	28%
2023	5%	23%
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e	Mysliman/e
2009	4%	32%
2018	7%	27%
2023	5%	22%

I ranguar si i treti sipas përvojës personale është diskriminimi në bazë të moshës (**2009** – 9%; **2013** – 5%; **2018** – 12%; **2023** – 9%), i cili gjithashtu renditet i treti në situatat ku të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (**2009** – 9%; **2013** – 10%; **2018** – 9%; **2023** – 9%).

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të moshës më shumë:

- Të anketuarit/at e moshës 65+ vjeç; dhe
- Pensionistët.

Hulumtimi i fundit nga viti 2023 zbulon ndryshime të mëdha diametrike në shpërndarjen e diskriminimit me përvojë personale në bazë të moshës. Për herë të parë, të anketuarit/at më të moshuar mbi 65 vjeç dhe pensionistët janë viktimat të këtij lloji të diskriminimit, i cili pothuajse është dyfishuar në pesë vitet e fundit, dhe më shumë se dyfish është zvogëluar te popullsia më e re nga 15 në 24 vjeç dhe për 20 herë midis nxënësve dhe studentëve (gjë që e bën atë pothuajse inekzistent) (shih Tabelën numër 24).

¹⁵ Lidhur me vlerësimin nëse ka ndodhur apo jo një ndryshim, duhet të merret parasysh se analizojmë segmente të tabelave të kryqëzuara, të cilat kanë një numër relativisht të vogël të të anketuarve/ave në secilën prej tyre, të cilat duhet të shihen si tregues që pasqyrojnë tendenca të caktuara në përgjigjet e të anketuarve/ave, me një nivel të caktuar probabiliteti.

Tabela numër 24

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të moshës më shumë:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8%	6%	10%	12%	11%	6%
2018	18%	12%	13%	12%	10%	8%
2023	7%	6%	6%	7%	10%	15%
Statusi i punës:	I/e vetëpunësuar	I/e papunë	Amvis/e	Student/e dhe nxënës/e	Pensionist/e	
2009	10%	9%	5%	11%	8%	
2018	12%	12%	10%	21%	8%	
2023	7%	9%	11%	1%	15%	

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të religjionit më shumë:

- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Për shkak të numrit relativisht të vogël të të anketuarve/ave që iu përgjigjën pozitivisht arsyeve të mëposhtme të diskriminimit, duhet të kihet parasysh se analizojmë segmente të tabelave të kryqëzuara, kështu që secili prej tyre duhet të shihet vetëm si tregues që pasqyron tendenca të caktuara në shoqëri (shih Tabelën nr. 25).

Tabela numër 25

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të religjionit ose bindjes:

Gjinia:	Burrë	Grua				
2009	7%	5%				
2018	9%	5%				
2023	7%	6%				
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8%	8%	7%	5%	4%	3%
2018	10%	12%	6%	6%	5%	2%
2023	5%	8%	8%	5%	6%	5%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e				
2009	2%	17%				
2018	3%	18%				
2023	4%	10%				
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e	Mysliman/e				
2009	2%	16%				
2018	3%	14%				
2023	4%	12%				
Vendbanimi:	Urban	Rural				
2009	5%	7%				
2018	6%	9%				
2023	7%	6%				

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të gjinisë më shumë:

- Gratë sesa burrat;

- Dhe të anketuarit/at e moshës 15-34 vjeç; dhe
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e.

Tabela numër 26

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të gjinisë:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2009	5%				8%	
2018	5%				8%	
2023	6%				8%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8%	8%	8%	7%	5%	3%
2018	9%	9%	8%	5%	4%	2%
2023	11%	14%	9%	5%	6%	2%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	4%			14%		
2018	5%			10%		
2023	3%			19%		

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar më shumë:

- Burrat sesa gratë; dhe

- Të anketuarit/at e moshës mbi 65 vjeç, sesa të moshës 15 deri në 24 vjeç.

Tabela numër 27

Personalisht kanë përjetuar diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2009	3%				2%	
2018	3%				3%	
2023	4%				2%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	3%	3%	2%	2%	4%	3%
2018	4%	3%	4%	4%	2%	2%
2023	1%	2%	4%	3%	2%	5%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	2%			7%		
2018	2%			6%		
2023	3%			3%		

Në fund të renditjes sipas përvojës personale të diskriminimit është orientimi seksual (2009 – 1%; 2013 – 0.4%; 2018 – 3%; 2023 – 3%), i cili renditet pothuajse identikisht në situatat ku të anketuarit/at gjithashtu kanë qenë dëshmi-

tarë/e të diskriminimit (2009 – 3%; 2013 – 7%; 2018 – 3%; 2023 – 2%).

Diskriminimi i përjetuar personalisht në bazë të orientimit seksual nuk tregoi dallime të rëndë-

sishme në karakteristikat socio-demografike të të anketuarve/ave.

Analiza e karakteristikave socio-demografike të të anketuarve/ave që përjetuan diskriminim në bazë të orientimit seksual është e kufizuar sepse është e pranishme në një numër të vogël të të anketuarve/ave që kanë konfirmuar përvojat e tyre personale, gjë që mund të jetë një tregues se qytetarët me orientime të ndryshme seksuale shmangin të flasin për problemet e tyre edhe në një situatë anonime gjatë një hulumtimi. Monitorimi i prevalencës së tij është i rëndësishëm, ndër të tjera, sepse lidhet ngushtë me formimin e personalitetit dhe si i tillë, në periudha të shkurtër kohore, madhësia e këtij komuniteti nuk

mund të rritet ose të ulet në mënyrë drastike. Prandaj, mund të thuhet se numri modest i atyre që flasin për problemet e tyre është rezultat i ndryshimit gradual të klimës sociale që lejon që ky komunitet, në parim i izoluar dhe i segreguar i qytetarëve, të flasë më hapur për përvojat e tyre me diskriminim. Rezultatet e hulumtimit të vitit 2023 tregojnë se ata që u diskriminuan në bazë të orientimit seksual në numër të barabartë gjenden si tek burrat ashtu edhe tek gratë. Në përmasa të ngjashme, përvoja personale e diskriminimit mbi këtë bazë u përjetua edhe nga të anketuarit/at nga grup moshë dhe nivele të ndryshme arsimore (shih Tabelën numër 28).

Tabela numër 28

Personat që kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të orientimit seksual:

Gjinia:	Burrë				Grua		
2009	1%				1%		
2018	3%				2%		
2023	2%				2%		
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	2%	1%	0%	1%	1%	0%	
2018	3%	4%	3%	4%	1%	0%	
2023	1%	3%	2%	2%	1%	2%	
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë		
2009	1%		1%		1%		
2018	1%		2%		4%		
2023	1%		2%		2%		

Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave tregoi se në një numër rastesh përvoja personale e ekspozimit ndaj diskriminimit lidhej me situatën në të cilën të anketuarit/at e gjetën veten si dëshmitarë, pavarësisht nga lloji i diskriminimit në fjalë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se vetëm 9% në vitin **2009**, 9% në vitin **2018** dhe 7% në **vitin 2023** janë diskriminuar, por jo si dëshmitarë. Ndërsa vetëm si dëshmitarë të diskriminimit

janë gjetur në vitin **2009** – 13%, në vitin **2018** – 13% dhe në **vitin 2023** – 11%.¹⁶ Një në katër të anketuar/a deklaruan se e gjetën veten në situata edhe si të diskriminuar/a personalisht ashtu edhe si dëshmitarë/e të diskriminimit (**2009** – 24%, **2018** – 27%, **2023** – 27%). Shumica e të anketuarve/ave (52% edhe në **2009**, **2018** dhe **2023**) deklaruan se nuk ishin diskriminuar dhe as ishin dëshmitarë të diskriminimit.

¹⁶ Për të fituar këto të dhëna, së pari gjenerohet një ndryshore që përshkruan se ishte/nuk ishte diskriminuar në asnjë bazë, dhe pastaj një ndryshore tjetër ishte/nuk ishte dëshmitar/e. Pastaj, variabli i tretë bashkon të gjitha kombinimet e dy variablave të mëparshëm si më poshtë: vetëm ishte diskriminuar, por jo dëshmitar; vetëm ishte dëshmitar, por jo i diskriminuar; ishte edhe i diskriminuar, edhe dëshmitar; dhe nuk ishte as i diskriminuar, as dëshmitar i diskriminimit.

Personalisht kanë përjetuar dhe kanë qenë dëshmitar/e të diskriminimit më shumë:

- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Analiza më tej tregon se shqiptarët/et etnikë/e dhe anëtarët/et e fesë myslimane dukshëm më shpesh sesa maqedonasit/et etnikë/e dhe anëtarët e fesë krishtere/rë deklaruan se ishin në

një situatë të dyfishtë të jenë të diskriminuar dhe dëshmitarë. Ky raport në të vërtetë nuk ka ndryshuar në periudhën e mbuluar nga hulumtimi, por në valën e fundit të hulumtimit ka pasur një rritje të madhe të numrit të shqiptarëve/eve etnikë/e dhe pjesëtarëve/eve të fesë myslimane. Arsimi, në hulumtimin e fundit, nuk u tregua si një faktor që bën dallimin e përvojave të tilla në mesin e të anketuarve/ave (shih Tabelën numër 29).

Tabela numër 29

Personat që kanë përjetuar personalisht dhe kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit:


Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë
2009	22%	24%	26%
2018	21%	27%	32%
2023	28%	25%	30%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	17%	43%	
2018	21%	41%	
2023	18%	54%	
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e	Mysliman/e	
2009	16%	40%	
2018	21%	37%	
2023	18%	45%	

3.3 Rrethanat në të cilat ka ndodhur diskriminimi

Për ata të anketuar/a që kanë deklaruar se janë diskriminuar në çfarëdo baze, për herë të parë në hulumtimin e vitit 2023, u është bërë pyetja se në cilat rrethana ka ndodhur kjo. Rezultatet tregojnë se të anketuarit/at që u diskriminuan në 12 muajt e fundit u diskriminuan më shpesh në hapësirën publike (27%), e dyta më e zakonshme

ishte gjatë kërkimit të një pune ose derisa kanë qenë në punë (23%, 22% në mënyrë përkatëse). Një në pesë të anketuar/a deklaruan se ishin diskriminuar nga personeli shëndetësor (21%). Ndërsa një në dhjetë të anketuar/a përmendën rrjetet sociale, dyqanet /bankat, stafin e shërbimit publik dhe kafenetë, restorantet, baret dhe klubet e natës si vende ku ata përjetuan diskriminim (11%) (shih grafikun numër 10).

Grafiku numër 10: Duke menduar për herën e fundit kur jeni ndjerë të diskriminuar, në çfarë rrethana ka ndodhur?



Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar për shkak të përkatësisë etnike:

- Kur kanë kërkuar punë
- Në një hapësirë publike
- Nga personeli shëndetësor.

Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar në bazë të gjinisë:

- Kur kanë kërkuar punë
- Në një hapësirë publike
- Në punë.

Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar në bazë të orientimit seksual:

- Nga personeli shëndetësor
- Nga stafi i shkollës ose universitetit
- Nga personeli i shërbimit social.

Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar për shkak të moshës, fesë ose besimit:

- Nga personeli shëndetësor

- Në një hapësirë publike
- Kur kanë kërkuar punë.

Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar:

- Në një hapësirë publike
- Nga personeli shëndetësor
- Në rrjetet sociale.

Vendi më i zakonshëm ku të anketuarit/at janë diskriminuar për shkak të përkatësisë partiake:

- Në punë
- Kur kanë kërkuar punë
- Në një hapësirë publike.

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit në hapësirën publike janë më së shpeshti:

- Të anketuar/a të moshës mbi 65 vjeç dhe midis 35-44 vjeç;
- Ata/ato me arsim fillor dhe të mesëm të përfunduar sesa ata/ato me arsim më të lartë;

- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Hulumtimi i vitit 2023 tregon se maqedonasit/et etnikë/e dhe të anketuarit/at me arsim fi-

llor dhe të mesëm të përfunduar diskriminohen shumë më shpesh në hapësirën publike sesa shqiptarët/et etnikë/e dhe ata me arsim të lartë të përfunduar (shih Tabelën numër 30).

Tabela numër 30

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit në hapësirën publike:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	15%	13%	20%	13%	15%	24%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	40%		39%		22%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	52%			38%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	55%			45%		

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit gjatë kërkimit të punës janë më së shpeshti:

- Moshë 25-34 vjeç;
- Të kenë përfunduar arsimin e mesëm; dhe
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Hulumtimi i vitit 2023 tregon se të anketuarit/at me arsim të mesëm të përfunduar, pothuajse dy herë më shumë diskriminohen gjatë kërkimit të një pune sesa ata/ato me arsim fillor ose të lartë të përfunduar. Është pothuajse dyfish ose trefish më i shpeshtë në grup-moshën nga 25 deri në 34 vjeç sesa në grup-moshat e tjera (shih Tabelën numër 31).

Tabela numër 31

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit gjatë kërkimit të punës:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	10%	35%	19%	14%	9%	12%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	26%		47%		27%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	47%			39%		

Të anketuarit që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit në punë janë më së shpeshti:

- Moshë 25-34 vjeç;
- Kanë të kryer arsimin e mesëm;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe

■ Të krishterët/et sesa myslimanët/et.
Anketa e vitit 2023 tregon se subjektet e arsimuara në shkollë të mesme diskriminohen në një numër shumë më të madh gjatë kërkimit të punës sesa ata me arsim fillor ose të lartë (shih Tabelën 32).

Tabela numër 32

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit në punë:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	11%	27%	21%	20%	13%	9%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	27%		51%		22%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	52%			42%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	56%			44%		

Të anketuarit/at që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit nga personeli shëndetësor janë më së shpeshti:

- Mbi moshën 65 vjeç;
- Kanë të kryer arsimin e mesëm;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Popullsia e moshuar mbi moshën 65 vjeç është më e ekspozuar ndaj diskriminimit nga personeli shëndetësor, krahasuar me grup-moshat e tjera. Dallime të mëdha vërehen edhe në lëndët me arsim të mesëm sesa në ato me arsim fillor ose të lartë të përfunduar. Tre nga pesë të anketuarit që ishin të diskriminuar nga personeli shëndetësor janë maqedonas/e dhe të krishterë/e etnikë/e, gjë që është shumë më e zakonshme sesa midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe myslimanëve/eve (shih Tabelën numër 33).

Tabela numër 33

Të anketuarit që janë diskriminuar në 12 muajt e fundit nga personeli shëndetësor:

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	8%	13%	20%	12%	17%	30%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	37%		48%		15%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	58%			28%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	60%			39%		


4. Përvojat dhe perceptimi me diskriminim të shumëfishtë

4.1 Përvoja personale të diskriminimit të shumëfishtë

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se shumica e qytetarëve nuk janë diskriminuar në asnjë bazë (**2009** – 65%; **2013** – 78%; **2018** – 64%; **2023** – 66%). Përafërsisht, për një qytetar që ka qenë viktimë e një lloj diskriminimi, mesatarisht, ka

dy qytetarë që nuk janë diskriminuar. Shumica e atyre që janë diskriminuar deklarojnë se janë diskriminuar në një bazë të vetme (**2009** – 17%; **2013** – 12%; **2018** – 19%; **2023** – 25%). Gjatë viteve, numri i shtetasve që deklarojnë se janë diskriminuar mbi një bazë është rritur, ndërsa ka rënë për ata që janë diskriminuar mbi disa baza (shih grafikun numër 11)¹⁷.

Grafiku numër 11 Përvoja personale të diskriminimit të shumëfishtë



¹⁷ Këto përqindje merren nga një sërë përgjigjesh se mbi sa baza dikush personalisht ka qenë i diskriminuar.

Përvoja personale e diskriminimit të shumëfishtë është më e përhapur në:

- Të anketuarit/at që janë të papunë ose me kohë të pjesshme;
- Të anketuarit/at e moshës 25 deri në 34 vjeç; dhe
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e.

Në vitin 2023, ka një rënie të përvojës personale me diskriminim të shumëfishtë dhe një rritje paralele të diskriminimit të njëhershëm, prandaj ka ndryshime të mëdha në karakteristikat e

ndryshme socio-demografike të popullsisë. Analiza e të dhënave tregon se përvojat personale me diskriminim të shumëfishtë përcaktohen nga disa faktorë, mbi bazën e të cilëve mund të bëhet një profil i personave që kanë përjetuar personalisht këtë lloj diskriminimi. Me një korrektësie, mund të thuhet se karakteristikat e personit që më shpesh mendon se është i ekspozuar ndaj situatave të cilat i përjeton dhe i vlerëson si diskriminuese të shumëfishta, është i moshës 25 deri në 34 vjeç, i/e papunë ose i/e punësuar me kohë të pjesshme dhe sipas përkatësisë etnisë shqiptar/e (shih Tabelën nr. 34).

Tabela numër 34

Përvojë personale me diskriminim të shumëfishtë


Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	20%	19%	18%	19%	13%	8%
2018	24%	23%	20%	14%	9%	7%
2023	3%	15%	11%	8%	9%	9%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8%			43%		
2018	12%			29%		
2023	7%			13%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	14%			21%		
2018	14%			19%		
2023	10%			10%		
Statusi i punës:	I/e punësuar me orar të plotë	I/e punësuar me orar të pjesshëm	I/e papunë	Amvis/e	Student/e nxënës/e	Pensionist/e
2009	15%	42%	16%	20%	23%	10%
2018	18%	30%	19%	18%	21%	6%
2023	8%	15%	20%	12%	0%	9%

4.2 Përvojat e diskriminimit të shumëfishtë ndaj të tjerëve

Shumica e qytetarëve (62%/60%) në **periudhën e anketës (2009-2023)** nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Numri i atyre që deklaruan se ishin dëshmitarë të një lloj diskriminimi po-

thuajse ka mbetur i njëjtë (**2009** – 18%; **2018** – 23%; **2023** – 24%). Nga ana tjetër, numri i të anketuarve që raportuan se ishin dëshmitarë të dy ose më shumë llojeve të diskriminimit ka tendencë të bjerë (**2009** – 20%, **2018** – 17%; **2023** – 14%) (shih grafikun numër 12).

Grafiku numër 12 Përvoja si dëshmitar i diskriminimit të shumëfishtë



Dëshmia e diskriminimit të shumëfishtë është më e përhapur midis:

- Të anketuarve/ave me arsim fillor dhe të lartë, se sa ata/ato me arsim të mesëm; dhe
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e.

Në anketën e fundit, moshë e të anketuarve nuk ndikoi në përvojën e diskriminimit të shumëfishtë kur ata u paraqitën në pozicionin e dëshmitarëve të diskriminimit. Hulumtimi i vitit 2023

vuri në dukje se kishte një rënie të popullsisë më të re dhe atyre të moshës 35-44 vjeç, të cilët deklaruan se kishin qenë dëshmitarë të të paktën dy llojeve të diskriminimit. Një tendencë e ngjashme u vërejt sipas arsimit - midis atyre me arsim të lartë të përfunduar dhe një rritje tek ata/ato me arsim fillor të përfunduar. Sipas përkatësisë etnike, shqiptarët/et etnikë/e në një numër shumë më të madh deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit të shumëfishtë ndaj maqedonasve/eve etnikë/e (shih Tabelën 35).

Tabela numër 35


Dëshmitar i diskriminimit të shumëfishtë						
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	26%	22%	21%	22%	15%	9%
2018	25%	19%	23%	15%	11%	5%
2023	13%	16%	15%	15%	11%	12%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	19%		20%		25%	
2018	9%		18%		21%	
2023	17%		11%		15%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	13%			38%		
2018	15%			22%		
2023	11%			20%		

4.3 Perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë

Rezultatet mbi perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë¹⁸ tregojnë se ka pasur ndryshime të

lehta në 5 vitet e fundit. Në vitin 2018, 43% e të anketuarve/ave e konsideruan diskriminimin e shumëfishtë si të zakonshëm¹⁹, ndërsa në vitin 2023 kjo pikëpamje pati një rritje të lehtë (49%) (shih Grafikon numër 13).

Grafiku numër 13 A mendoni se diskriminimi i shumëfishtë është shumë i shpeshtë, mjaft i shpeshtë, mjaft i rrallë, shumë i rrallë ose nuk ekziston në vendin tonë?



¹⁸ Pyetja për perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë nuk u shtrua në hulumtimin e vitit 2013.

¹⁹ Përgjigjet "shumë i shpeshtë" dhe "mjaft i shpeshtë" grumbullohen në kategorinë "shpesh"; përgjigjet "shumë rrallë" dhe "mjaft rrallë" grumbullohen në kategorinë "rrallë".

Ndryshimet në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë lidhen ndjeshëm me përvojën e diskriminimit. Rezultatet tregojnë se rritja më e madhe në perceptimin se diskriminimi i shumëfishtë është i zakonshëm në 5 vitet e fundit u evidentua në mesin e atyre të anketuarve/ave të cilët vetë ishin diskriminuar (**2009** – 58%; **2018** – 47%; **2023** – 58%); dhe pas tyre në mesin e atyre të anketuarve/ave që nuk ishin të diskriminuar dhe as dëshmitarë të diskriminimit (**2009** – 43%; **2018** – 27%; **2023** – 39%). Përgji-

gjet më të shpeshta se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë, në të tre hulumtimet, jepen nga të anketuarit/at që kanë qenë dëshmitarë dhe viktima të diskriminimit (**2009** – 68%; **2018** – 66%; **2023** – 63%). Këto të dhëna tregojnë se pozicioni i dyfishtë i të qenit dëshmitarë dhe viktima të diskriminimit mbështet fuqimisht përshtypjen se diskriminimi jo vetëm që është i pranishëm, por shpesh ndodh në formën e diskriminimit të shumëfishtë.


5. Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta gjatë punësimit

5.1 Qëndrimi ndaj mundësive të barabarta gjatë punësimit

Ndër të anketuarit/at, “përkatësia politike” mbetet faktori kryesor diskriminues për trajtimin e pabarabartë të kandidatëve/eve me të njëjtat kualifikime gjatë procesit të punësimit (**2009** – 67%; **2018** – 65%; **2023** – 55%), i cili është në një trend rënës. Faktori “moshë” (**2009** – 40%; **2018** – 30%; **2023** – 28%) ishte faktori i dytë kryesor

për të anketuarit/at. Menjëherë pas tij është “përkatësia etnike” si faktori i tretë më i përmendur që e vë njërin/njërën nga kandidatët/et në disavantazh (**2009** – 28%; **2018** – 27%; **2023** – 19%). Nga ana tjetër, faktorët që kanë ndikimin më të vogël në procesin e përzgjedhjes për punësim janë adresa e vendbanimit (**2009** – 5%; **2018** – 4%; **2023** – 6%) dhe zakonet e pirjes së duhanit të kandidatit (**2009** – 6%; **2018** – 3%; **2023** – 5%) (shih grafikun numër 14).

Grafiku numër 14 Kur një kompani, në vendin tonë dëshiron të punësojë dikë dhe mund të zgjedhë midis dy kandidatëve/eve me aftësi dhe kualifikime të barabarta, cili nga kriteret e mësipërme e vendos një nga kandidatët/et në disavantazh?



Përkatësia politike si faktor diskriminimi gjatë punësimit më shumë përmendet nga:

- Të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç dhe të moshës mbi 65 vjeç;
- Maqedonasit/et etnikë/e sesa shqiptarët/et etnikë/e; dhe

- Pensionistët/et dhe të punësuarit, më shumë se të papunët.

Ndarja e pikëpamjeve është më e dukshme në komunitetet e ndryshme etnike. Maqedonasit/et etnikë/e pothuajse dy herë më shumë e shohin përkatësinë politike si bazë për diskriminim sesa shqiptarët/et etnikë/e (shih Tabelën 36).

Tabela numër 36

Përkatësia politike si faktor diskriminues për punësim

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+		
2009	63%	70%	73%	69%	72%	55%		
2018	60%	63%	66%	64%	65%	70%		
2023	51%	47%	53%	62%	57%	60%		
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë			
2009	62%		70%		71%			
2018	58%		66%		68%			
2023	54%		57%		54%			
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e				
2009	69%			62%				
2018	73%			45%				
2023	60%			35%				
Statusi i punës:	I/e vetëpunësuar		I/e papunë		Student/e nxënës/e		Pensionist/e	
2009	72%		67%		60%		64%	
2018	65%		65%		53%		70%	
2023	56%		47%		54%		60%	

Mosha si faktor për diskriminimin gjatë punësimit më shumë përmendet nga:

- Të anketuarit/at e moshës 45-54 vjeç; dhe
- Të anketuarit/at me arsim fillor dhe të mesëm të përfunduar.

Të anketuarit/at e moshës 45 deri në 54 vjeç kanë më shumë gjasa të mendojnë se mosha e kandidatit është një faktor diskriminues gjatë punësimit, si dhe personat me arsim fillor dhe të mesëm të përfunduar, sesa personat me arsim të lartë të përfunduar (shih Tabelën numër 37).

Tabela numër 37

Mosha si faktor diskriminues gjatë punësimit

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	34%	38%	45%	47%	42%	37%
2018	24%	23%	34%	34%	34%	29%
2023	30%	25%	24%	33%	25%	31%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2009	35%		42%		49%	
2018	27%		32%		27%	
2023	30%		28%		24%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	44%			30%		
2018	33%			23%		
2023	28%			26%		

Përkatësia etnike e kandidatit si faktor diskriminimi gjatë punësimit më shumë përmendet nga:

- Të anketuarit/at e moshës 25-34 vjeç dhe 45-54 vjeç;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Të anketuarit/at e papunë.

Në vitin 2023, kishte ndryshime në perceptimin e përkatësisë etnike si një faktor kryesor për trajtimin e pabarabartë gjatë punësimit të mosha e të anketuarve/ave. Në dy valët e më-

parshme të viteve 2009 dhe 2018, ajo u ul me moshën e të anketuarve/ave. Në vitin 2023 është më e shpeshtë tek të anketuarit/at e moshës 25 deri në 34 vjeç dhe 45 deri në 54 vjeç. Megjithëse ekziston një prirje në rënie në dy komunitetet më të mëdha etnike në vend në perceptimin e rolit të përkatësisë etnike në përzgjedhjen për punësim, megjithatë, ekziston një hendek i madh midis tyre. Shqiptarët/et etnikë/e në dyfishin e numrit e shohin përkatësinë politike si bazë për diskriminim sesa maqedonasit/et etnikë/e (shih Tabelën numër 38).

Tabela numër 38

Përkatësia etnike e kandidatit/es si faktor diskriminimi gjatë punësimit

Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	33%	32%	25%	29%	19%	17%
2018	36%	35%	32%	25%	24%	16%
2023	24%	29%	24%	30%	24%	13%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	18%			47%		
2018	22%			37%		
2023	16%			34%		
Statusi i punës:	I/e vetëpunësuar	I/e papunë	Student/e nxënës/e	Pensionist/e		
2009	25%	29%	35%	20%		
2018	31%	33%	29%	16%		
2023	25%	30%	21%	14%		

5.2 Mbështetje për masat që sigurojnë mundësi të barabarta gjatë punësimit

Në të tre hulumtimet nga viti 2009 deri në vitin 2018, të anketuarve/ave u janë bërë një sërë pyetjesh që kanë të bëjnë me gatishmërinë e tyre për të mbështetur masat dhe aktivitetet që synojnë sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit. Vendosja e masave specifike i referohet programeve të veçanta për trajnim ose kuota për grupet më pak të përfaqësuara në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, përkatësisë


politike, moshës, fesë dhe besimit, aftësisë së kufizuar ose orientimit seksual (veprime afirmative).

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se gatishmëria për të mbështetur masa të tilla dominon mbi kundërshtimin ndaj vendosjes së këtyre masave²⁰ (shih grafikun numër 15). Përrjashtimi i vetëm janë masat që synojnë personat me orientime të ndryshme seksuale, ku shumica e të anketuarve/ave kundërshtojnë vendosjen e masave afirmative që synojnë përfaqësimin më të madh të këtij grupi.²¹ Të dhënat në tekst grumbullohen për analizë më të lehtë.

²⁰ Përgjigjet "pajtohem" paraqesin përmbledhje të të gjitha përgjigjeve "pajtohem plotësisht" dhe "pajtohem pjesërisht", ndërsa përgjigjet "jam kundër" janë një përmbledhje e përgjigjeve "plotësisht jam kundër" dhe "pjesërisht jam kundër".

²¹ Anketa telefonike e kryer në vitin 2013 pa përrjashtim dominohet nga gatishmëria për të pranuar vendosjen e masave specifike (veprime afirmative) për të gjitha kategoritë, përrfshirë personat me orientim seksual të ndryshëm bazuar në orientimin e tyre seksual.

Grafiku numër 15 A do të pajtoheshit apo do të kundërshtonit vendosjen e masave specifike për të siguruar mundësi të barabarta punësimi për të gjithë personat?



Në vitin 2023, shohim një rënie të lehtë të mbështetjes për të gjitha kategoritë e masave të analizuara nga hulumtimi. Shumica e të anketuarve/ave mbështesin vendosjen e masave specifike kundër diskriminimit në vendin e punës në bazë të aftësisë së kufizuar (68%) dhe në bazë të moshës (66%). Menjëherë pas tyre vijnë masat kundër diskriminimit në bazë të gjinisë (63%), përkatësisë etnisë dhe përkatësisë fetare

(59%). Për sa i përket përkatësisë politike (51%), shohim rënie më të madhe të mbështetjes prej 7 pp. Mbështetja për personat sipas orientimit të tyre seksual është vazhdimisht më e vogla në krahasim me të gjithë të tjerët, dhe është në rënie të vazhdueshme me kalimin e viteve, (**2009** – 40%; **2018** – 41%; **2023** – 34%).

Statusi i punës së të anketuarve/ave është një nga karakteristikat më të rëndësishme socio-de-

mografike kur bëhet fjalë për gatishmërinë për të mbështetur vendosjen e masave specifike për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë personat. Të dhënat tregojnë se gatishmëria për të mbështetur masa të tilla është shumë e ndryshueshme midis personave me status të ndryshëm punësimi. Në pesë vitet e fundit nga viti 2018 deri në vitin 2023, ka një trend të madh negativ midis studentëve/eve dhe nxënësit/et. Tek të të cilët gatishmëria për mbështetje u ul ndjeshëm për gjashtë nga shtatë bazat e testuara. Këto ndryshime kanë të bëjnë me mbështetjen e zvogëluar për bazat: përkatësia etnike (2009 – 59%; 2018 – 73%; 2023 – 59%), gjinia (2009 – 62%; 2018 – 74%; 2023 – 59%), mosha (2009 – 61%; 2018 – 76%; 2023 – 68%), feja dhe besimi (2009 – 55%; 2018 – 77%; 2023 – 51%), orientimi seksual (2009 – 41%; 2018 – 53%; 2023 – 36%) dhe përkatësia politike (2009 – 41%; 2018 – 53%; 2023 – 47%). Ka një ndryshim pozitiv në këtë kategori të të anketuarve/ave vetëm në mbështetjen e bazuar në aftësi të kufizuara (2009 – 63%; 2018 – 62%; 2023 – 74%).

Për më tepër, ndryshime pozitive vërehen vetëm midis të papunëve. Këto ndryshime zbatohen për katër nga shtatë bazat, përkatësisht: personat sipas religjionit dhe përkatësisë gjinore, personat me aftësi të kufizuara dhe homoseksualët.


Një gjetje kryesore të hulumtimeve është fakti se sipas profesionit të të anketuarve/ave vetëm midis drejtorëve/eve dhe menaxherëve/eve, niveli i mbështetjes për vendosjen e masave specifike është rritur në vitin 2023, krahasuar me vitin

2018. Gjetja është indikative (megjithëse bëhet fjalë për një nën-popullsi statistikisht e vogël) sepse për zbatimin e suksesshëm të masave kontributi i tyre është i një rëndësie të veçantë. Midis tyre, rritja është më e lartë kur bëhet fjalë për vendosjen e masave të barabarta për personat sipas përkatësisë së tyre partiake (2009 – 51%; 2018 – 45%; 2023 – 65%), gjinisë (2009 – 73%; 2018 – 52%; 2023 – 65%), përkatësisë etnike (2009 – 67%; 2018 – 59%; 2023 – 71%) dhe më pas për personat me aftësi të kufizuara (2009 – 79%; 2018 – 56%; 2023 – 70%).

5.3 Mbështetje për masat për mbikëqyrje në vendin e punës

Ekziston mbështetje publike për masat që synojnë sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit për anëtarët/et e bashkësive etnike më të vogla. Përkatësisht, kjo mbështetje është më e madhe në raport me kundërshtimin e këtyre masave. Në hulumtimin e vitit 2023, përqindja e atyre që mbështesin monitorimin e procedurave të punësimit ishte pak më e lartë se përqindja e atyre që mbështesin evidentimin e përbërjes etnike të punonjësve (57% kundrejt 51%). Por në të dyja masat, hulumtimi i fundit tregon një rënie të madhe të mbështetjes së tyre. Kjo rënie është kryesisht për shkak të ndryshimeve në gatishmërinë për të mbështetur masa të tilla te dy komunitetet më të mëdha etnike në vend (shih Grafikun 16).

Grafiku numër 16: Deri në çfarë mase jeni dakord ose do të kundërshtonit që gjërat e mëposhtme të zbatohen në vendin e punës?



Për herë të parë në hulumtim, mbështetja midis maqedonasve/eve etnikë/e për evidentimin e përbërjes etnike të punonjësve është më e ulët në raport me kundërshtimin e kësaj mase. Në të dy komunitetet më të mëdha etnike, shohim një rënie të madhe të mbështetjes, me një rënie prej 13p p.p., në mesin e shqiptarëve/eve etnikë/e (**2009** – 84%; **2018** – 78%; **2023** – 65%) dhe një rënie prej 21 p.p., në mesin e maqedonasve/eve etnikë/e (**2009** – 55%; **2018** – 64%; **2023** – 43%). Në të gjitha valët e hulumtimit, shqiptarët/et etnikë/e tregojnë gatishmëri më të

madhe për mbështetje sesa maqedonasit/et etnikë/e. Përveç këtyre ndryshimeve sasiore, është e nevojshme të theksohet trendi pozitiv midis drejtorëve/eve dhe menaxherëve/eve, si një kategori specifike e të anketuarve/ave, të cilët janë në gjendje të ndikojnë ndjeshëm në zbatimin e suksesshëm të masave afirmative. Pëlqimi për evidencën e punonjësve te drejtorët/et dhe menaxherët/et ka qenë i lartë gjatë viteve (**2009** – 43%; **2018** – 68%; **2023** – 63%) dhe në vitin 2023 është mbi mesataren e hulumtimit (51%) (shih Tabelën numër 39).

Tabela numër 39

Të evidentohet përbërja e punonjësve në mënyrë që të mund të monitorohet dhe vlerësohet se sa të përfaqësuar/a janë pjesëtarët/et e komuniteteve etnike më të vogla		Maqedonas/e	Shqiptarë/e	Drejtorë/e dhe menaxherë/e
2023:	Gjithsej:			
Pajtohem	51%	43%	65%	63%
Kundër	47%	54%	34%	36%
2018:	Gjithsej:			
Pajtohem	69%	64%	78%	68%
Kundër	25%	30%	15%	29%
2009:	Gjithsej:			
Pajtohem	63%	55%	84%	43%
Kundër	31%	40%	10%	54%

Monitorimi i procedurave që synojnë sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit për personat që i përkasin komuniteteve më të vogla etnike pranohet nga një shumicë e madhe e qytetarëve/eve në të gjitha hulumtimet (**2009** – 71%; **2018** – 72%; **2023** – 57%). Edhe këtu, një numër më i madh i shqiptarëve/eve etnikë/e

pajtohen me miratimin e masave të tilla në raport me maqedonasit/et etnikë/e (**2009**: Mak. – 66%, Alb. – 83%; **2018**: Mak. – 69%, Alb. – 78%; **2023**: Mak. – 51%, Alb. – 68%). Mbështetja te drejtorët/et dhe menaxherët/et është rritur gjatë viteve (**2009** – 59%; **2018** – 62%; **2023** – 68%) (shih Tabelën numër 40).

Tabela numër 40

Procedurat e punësimit ndiqen për të siguruar që personat që i përkasin komuniteteve etnike më të vogla, të kenë mundësi të barabarta për punësim si kandidatët e tjerë me aftësi ose kualifikime të ngjashme		Maqedonas/e	Shqiptarë/e	Drejtorë/e dhe menaxherë/e
2023:	Gjithsej:			
Pajtohem	57%	51%	68%	68%
Kundër	40%	45%	32%	30%
2018:	Gjithsej:			
Pajtohem	73%	69%	78%	62%
Kundër	22%	25%	16%	30%
2009:	Gjithsej:			
Pajtohem	72%	66%	83%	59%
Kundër	23%	29%	9%	30%

6. Lufta kundër diskriminimit

6.1 Vlerësimi i përpjekjeve për luftë kundër diskriminimit

kalimin e kohës tregojnë një prirje në rënie në rezultat (**2009** – 46%; **2013** – 34%; **2018** – 36%; **2023** – 24%) (shih Tabelën numër 41).

Përgjigjet në pyetjen nëse po bëhen përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin me

Tabela numër 41

Në përgjithësi, a mund të thoni se po bëhen përpjekje të mjaftueshme në vendin tonë për luftë kundër të gjitha formave e diskriminimit?	Viti			
	2009	2013	2018	2023
Investohen	46%	34%	36%	24%
Nuk investohen	49%	59%	58%	73%

Në të gjithë hulumtimet, ekziston një tendencë e qëndrueshme që të anketuarit/at që e konsiderojnë diskriminimin të shpeshtë, pavarësisht nga lloji i diskriminimit në fjalë, të konsiderojnë se po bëhen përpjekje të pamjaftueshme për të luftuar diskriminimin në krahasim me të anketuarit/at që e konsiderojnë diskriminimin si të rrallë. Në vitin 2023, ekziston një perceptim

i theksuar negativ kur të dhënat shikohen përmes prizmit të përvojave me diskriminimin. Pavarësisht nëse të anketuarit/at kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të diskriminimit apo jo, një shumicë dërrmuese mendojnë se nuk po bëhen përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin.


7. Ndërgjegjësimi mbi të drejtat dhe kërkimi i mbrojtjes në rast të diskriminimit

7.1 Ndërgjegjësimi për të drejtat në rast diskriminimi

Gjatë viteve, informimi te të anketuarit/at për të drejtat e tyre, në rast se janë viktimë të diskriminimit, ka qenë vazhdimisht në rritje (**2009** – 40%; **2018** – 43%; **2023** – 47%)²². Megjithatë,

ende shumica e të anketuarve/ave deklarojnë se nuk i njohin të drejtat e tyre në rastet kur janë viktimë të diskriminimit (**2009** – 56%; **2018** – 52%; **2023** – 50%). Megjithëse ka pasur një rritje të atyre që kanë deklaruar se janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, megjithatë, ndryshimi është i vogël dhe i ngadaltë (shih Grafikonin 17).

Grafiku numër 17 A e dini se cilat janë të drejtat tuaja në rast se jeni viktimë e diskriminimit?



²² Nuk mund të dihet me siguri nëse ndryshimi në të dhënat që rrjedhin nga hulumtimi në vitin 2013 është për shkak të ndryshimeve që ndodhën në popullatë ose për shkak të metodologjisë së ndryshuar të përdorur për hulumtimin (në vitin 2013 metoda e hulumtimit ishte me telefon, ndërsa në vitin 2009, 2018 dhe 2023 ishte sy më sy, në shtëpinë e të anketuarit). Për këtë arsye, të dhënat e vitit 2013 për pyetjet e kësaj teme nuk janë analizuar.

Ndërgjegjësimi për të drejtat personale në rast diskriminimi është më i theksuar te:

- Burrat sesa gratë;
- Të anketuarit/at me arsim të kryer më shumë se shkolla e mesme;
- Maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et sesa shqiptarët/et etnikë/e dhe myslimanët/et; dhe
- Të krishterët/et sesa myslimanët/et.

Hulumtimi i fundit shënon një rritje të ndërgjegjësimit për të drejtat në rast diskriminimi midis grupeve përkatëse socio-demografike, të cilët janë lëndë e hulumtimit. Sipas perceptimit të

të anketuarve/ave, burrat janë më të informuar për të drejtat e tyre në rast se janë viktimat të diskriminimit sesa gratë. Ndërgjegjësimi rritet me nivelin e arsimit të të anketuarve/ave. Një rritje e madhe e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre vërehet te shqiptarët/et etnikë/e (11 p.p.) dhe anëtarët/et e fesë myslimane (9 p.p.). Që në vitin 2023, përsëri si në vitin 2009, i bën këto dy grupe të të anketuarve/ave në numër dukshëm më të madh të deklarojnë se janë të informuar për të drejtat e tyre sesa nga maqedonasit/et etnikë dhe të krishterët/et (te të cilët, nga ana tjetër, nuk vërehet rritje e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre) (shih Tabelën numër 42).

Tabela numër 42


Njohja e të drejtave personale në rast diskriminimi

Gjinia:	Burrë		Grua
2009	44%		37%
2018	48%		38%
2023	50%		43%
Arsimi:	Fillor	I mesëm	I lartë
2009	33%	41%	58%
2018	28%	43%	57%
2023	36%	47%	65%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e
2009	37%		50%
2018	46%		38%
2023	46%		49%
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e		Mysliman/e
2009	38%		48%
2018	45%		39%
2023	46%		48%

Është e rëndësishme të theksohet se sa të anketuarit/at që deklaruan se kishin qenë viktimë e diskriminimit (për një ose më shumë arsye) në 12 muajt e fundit në një numër relativisht të madh thanë se ishin të vetëdijshëm për të drejtat e tyre. Analiza tregon ndryshime në drejtimin pozitiv në informimin për të drejtat personale te një numër i madh i viktimave të diskriminimit për arsye të shumta. Në pesë vitet e fundit, ndërgjegjësimi midis viktimave të diskriminimit për të drejtat e tyre në pothuajse të gjitha bazat

është rritur. Rritja më e madhe e ndërgjegjësimit është në mesin e viktimave të diskriminimit në bazë të fesë dhe bindjes (12 p.p.) dhe viktimave të diskriminimit në bazë të përkatësisë partiake (10 p.p.). Një rritje më e vogël vërehet tek ata që diskriminohen në bazë të orientimit seksual (4 p.p.), përkatësisë etnike (3 p.p.) dhe aftësisë së kufizuar (3 p.p.). Është vërejtur një rënie e lehtë në informimin te personat e diskriminuar në bazë të gjinisë (5 p.p.) dhe moshës (4 p.p.) (shih grafikun numër 18).

Grafiku numër 18 Ata që kanë deklaruar se janë viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit (për një ose më shumë arsye) dhe që kanë deklaruar se janë të vetëdijshëm për të drejtat



Por nëse analizojmë nëse ata që u ndjenë si viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit janë më të informuar apo jo sesa ata që nuk u ndjenë të diskriminuar, rezultatet nuk janë shumë bindëse. Të anketuarit/at që deklarojnë se janë diskriminuar nuk janë kryesisht më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre sesa ata që deklaro-

jnë se nuk janë diskriminuar. Por ndryshime të vazhdueshme pozitive vërehen tek ata që kanë deklaruar se janë të diskriminuar mbi një bazë, si dhe tek ata që kanë deklaruar se nuk janë të diskriminuar (shohim një rritje prej 4 p.p. / 3 p.p., përkatësisht, në 5 vitet e fundit) (shih Tabelën nr. 43).

Tabela numër 43


A e dini se cilat janë të drejtat tuaja në rast se jeni viktimë e diskriminimit?	Të anketuarit që janë diskriminuar personalisht në 12 muajt e fundit		
	Nuk janë diskriminuar	Mbi një bazë	Mbi më shumë baza
2023:			
Po	47%	46%	51%
Jo	50%	50%	46%
2018:			
Po	43%	42%	48%
Jo	52%	53%	48%
2009:			
Po	40%	40%	37%
Jo	56%	56%	60%

7.2 Gatishmëria për t'iu drejtuar institucioneve përkatëse në rast diskriminimi

Shumica e të anketuarve/ave (57%), si në valët e hulumtimit në vitin 2018 dhe 2023, deklaruan

se do të kërkonin mbrojtje nga institucionet përkatëse nëse hipotetikisht do ta gjenin veten viktimë të diskriminimit ose ngacmimit. Një e treta e tyre (33%) deklaruan se nuk do ta raportonin diskriminimin (shih Grafikon numër 19).

Grafiku numër 19 Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose ngacmimit, a do të kërkon mbrojtje nga institucionet, organizatat përkatëse?



Gatishmëria e të anketuarve/ave për t'iu drejtuar institucioneve dhe organizatave kompetente për mbrojtje nga diskriminimi është shumë më e madhe te ata që personalisht kanë qenë viktimë të diskriminimit mbi çfarëdo baze (76%) sesa te ata që kanë deklaruar se nuk janë diskriminuar

në 12 muajt e fundit (40%). Por një e pesta (20%) e atyre që u diskriminuan personalisht, megjithatë, deklaruan se nuk do të kërkonin mbrojtje nga asnjë institucion ose organizatë kompetente (shih Tabelën numër 44).


Tabela numër 44

Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose ngacmimit, a do të kërkon mbrojtje nga institucionet, organizatat përkatëse?		A e dini se cilat janë të drejtat tuaja në rast se jeni viktimë e diskriminimit?	
		Po	Jo
2023:			
Po	57%	76%	40%
Jo	32%	20%	46%
2018:			
Po	57%	71%	47%
Jo	32%	23%	41%

Analiza tregon se nuk ka dallime të mëdha midis grupeve të ndryshme të cënueshme ndaj diskriminimit, kur bëhet fjalë për gatishmërinë e tyre për t'iu drejtuar për ndihmë dhe mbrojtje institucioneve në vend. Në të shtatë grupet që u diskriminuan të përfshira me hulumtimin, shumica e tyre (përqindjet variojnë nga 57% në 66%) u për-

gjigjën se do të kërkonin mbrojtje, ndërsa rreth një e treta e tyre (përqindjet variojnë nga 29% në 36%) u përgjigjën se, nëse ndiheshin të diskriminuar, nuk do t'i drejtoheshin institucioneve kompetente për ndihmë (shih Grafikon numër 20).

Grafiku numër 20 Ata që kanë deklaruar se janë viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit (për një ose më shumë arsye) dhe nëse kanë kërkuar ose jo mbrojtje nga institucionet / organizatat përkatëse



Ka dallime në përgjigjet e kësaj pyetjeje në segmente të caktuara të popullsisë. Gatishmëria për të raportuar një rast diskriminimi në një skenar hipotetik nëse i/e anketuari/a do të diskriminohej ka më shumë gjasa të ndodhë te njerëzit me arsim të lartë në të dy hulumtimet (**2018**: fillor – 51%, i mesëm – 57%, i lartë – 63%; **2023**: fillor – 57%, i mesëm – 54%, i lartë – 64%). Gjatë pesë viteve të fundit ka pasur ndryshime të mëdha përgjatë linjave etnike dhe fetare. Në vitin 2018, gatishmëria për të raportuar një rast diskriminimi ishte më e theksuar në mesin e

maqedonasve/eve etnikë/e dhe të krishterëve/eve sesa në mesin e shqiptarëve/eve etnikë/e dhe myslimanëve/eve (**2018**: maqedonasit/et – 62%, shqiptarët/et – 45%, të krishterët/et – 62%, myslimanët/et – 47%). Në vitin 2023, dallimet midis tyre barazohen, midis maqedonasve/eve etnikë/e dhe të krishterëve/eve, ka një rënie të gatishmërisë, ndërsa anasjelltas midis shqiptarëve/eve etnikë/e dhe myslimanëve/eve ka rritje (**2023**: maqedonas/e – 57%, shqiptarë/e – 56%, të krishterë/e – 57%, myslimanët/e – 58%).

Nga të anketuarit/at që thanë se do të kërkonin mbrojtje nëse do të diskriminoheshin²³ - 57% (N = 919), shumica e tyre do t'i drejtoheshin policisë (64%), të cilën ata e konsiderojnë si institucionin përkatës përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe në një numër pak më të ulët do t'i drejtoheshin Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (47%). Pas tyre vijnë Avokati i Popullit (37%), gjykata (31%), avokati (27%) dhe organizatat e shoqërisë civile (12%). Dhe në numrin më të vogël përmenden sindikatat (7%). Në 5 vitet e fundit, ndër hulumtimet e kryera që nga viti 2018, besimi tek gjykatat dhe organizatat e shoqërisë civile ka rënë ndjeshëm. Të anketuarit/at në numër konsiderueshëm më të ulët përmendin gjykatën (rënie prej 16 për qind) dhe organizatat e shoqërisë civile (diferencë prej 7 për qind) si zgjedhje nëse duhet të kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi.

Rezultatet tregojnë se, kur të anketuarit/at konsiderojnë se ku do të drejtoheshin për të kërkuar ndihmë nëse do të diskriminoheshin, institucioni më i zakonshëm që ju kujtohet së pari është policia (38%), i dyti është Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (24%), dhe i treti është Avokati i Popullit (13%). Gjykata (7%), avo-


kati (5%), organizatat e shoqërisë civile (2%) dhe sindikatat (1%) nuk përmenden shpesh si zgjedhja e parë midis të anketuarve/ave. Kjo shpërndarje e përgjigjeve të para të përmendura është e njëjtë si në hulumtimin e vitit 2018 ashtu edhe në atë të vitit 2023, me ndryshime të vogla në përqindje.

Ndërsa më shpesh "e dyta ose e tjera e përmendur" është gjykata (44%) në vitin 2018, në vitin 2023 shohim një rënie të madhe me 16 p.p. (28%). Që në vitin 2023 e bën pothuajse të barabartë me Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (28%), Avokatin e Popullit (29%) dhe avokat (27%), te të cilët nuk ka pasur ndryshime në 5 vitet e fundit. Rënia e besimit në gjykata në vitin 2023 e bën policinë zakonisht "të dytën ose tjetrën të përmendur" (31%), te e cila ka një rritje të lehtë prej 3 p.p. Në të dy hulumtimet shumë më rrallë përmenden organizatat e shoqërisë civile (13%), dhe më rrallë përmendet sindikata (7%). Është interesante të theksohet se policia është zgjedhja e parë për të anketuarit/at, megjithëse ky institucion nuk ka jurisdikcion për të vepruar në rastet e diskriminimit (përveç rasteve të shkeljes së nenit 417 të Kodit penal²⁴).

²³ Të anketuarit u pyetën, "Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose ngacmimit, a do të kërkonit mbrojtje nga institucionet dhe organizatat përkatëse?". Atyre që u përgjigjën se do të kërkonin ndihmë, iu bë një pyetje e hapur: "Ku do të drejtoheshit për të kërkuar mbrojtje? Ku në vend tjetër? Po në vend tjetër?", me mundësinë të përmendin më shumë institucione që ata njohin, pa i'u lexuar asnjë zgjedhje përgjigjesh.

²⁴ Neni 417 i Kodit penal: Diskriminim racor ose diskriminim tjetër.

Grafiku numër 21 Ku do të drejtoheni të kërkonti mbrojtje?
(Ata që u përgjigjën se do të kërkonin mbrojtje)



Te të anketuarit/at me arsim fillor dhe të mesëm të përfunduar në të dy hulumtimet, policia është shumë më shpesh institucioni i parë i përmendur (**2018**: fillor – 48%, i mesëm – 44%; **2023**: fillor – 46%, i mesëm – 39%) sesa në mesin e të anketuarve/ave me arsim të lartë të përfunduar (**2018** - 28%; **2023** - 23%;). Te shqiptarët/et etnikë/e dhe maqedonasit/et etnikë/e në vitin 2018, institucionet më të përmendura janë: po-

licia, gjykata dhe Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (**policia**: Mak. - 63%, Alb. - 71%; **gjykata**: Mak. - 44%, Alb. - 60%; **Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi**: Mak. - 42%, Alb. - 58%). Ndërsa në vitin 2023 vetëm policia dhe Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, sepse te gjykatat është vërejtur një rënie e madhe në këtë institucion, duke e bërë atë pothuajse të

parëndësishëm në këtë segment (**policia:** Mak. - 42%, Alb. - 24%; **gjykata:** Mak. - 7%, Alb. -8%; **Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi:** Mak. - 21%, Alb. - 37%).

Shqiptarët/et etnikë/e në vitin 2023 më shpesh deklarojnë se do të kërkojnë mbrojtje nga **Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi** sesa maqedonasit/et etnikë/e. Ndërsa maqedonasit/et etnikë/e në numër të madh deklarojnë se do t'i drejtoheshin **policisë për mbrojtje**, sesa shqiptarët/et etnikë/e.

Analiza tregon se policia është zgjedhja më e zakonshme e të anketuarve/ave pavarësisht nëse kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kanë qenë viktimë e diskriminimit për një (54%) ose më shumë arsye (74%) ose aspak nuk kanë qenë viktimë të diskriminimit (67%). Rezultatet pas 5 viteve tregojnë se ka një ulje të përzgjedhjes së

viktimave të diskriminimit mbi një bazë për policinë (12 p.p.) dhe gjykatat (26 p.p.) si institucione nga të cilat ata do të kërkonin ndihmë, dhe një rritje prej 15 p.p. për Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Rënia e zgjedhjes së gjykatave nuk është regjistruar vetëm tek ky grup qytetarësh (megjithëse tek ata është më i madh), por edhe tek ata që janë diskriminuar për shkaqe të shumëfishta (13 p.p.) dhe ata që deklaruan se nuk janë diskriminuar në 12 muajt e fundit (12 p.p.).

Te Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, shohim një rritje të atyre që kanë deklaruar se kanë qenë viktimë e diskriminimit mbi një bazë ose nuk kanë qenë fare viktimë e diskriminimit (15 p.p.), ndërsa një rënie të viktimave të diskriminimit mbi baza të shumëfishta (18 p.p.) (shih Tabelën numër 45).

Tabela numër 45

Ku do të drejtoheni të kërkonin mbrojtje? (Ata që u përgjigjën se do të kërkonin mbrojtje – N = 916)	Të anketuarit që janë diskriminuar personalisht në 12 muajt e fundit		
	Nuk janë diskriminuar	Mbi një bazë	Mbi më shumë baza
2023:			
Polici	64%	67%	54%
Gjykatë	31%	32%	19%
Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi	47%	59%	56%
2018:			
Polici	65%	64%	66%
Gjykatë	47%	44%	45%
Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi	46%	44%	41%


8. Matja e gatishmërisë për të pranuar përfshirjen e informacioneve për diversitetet në materialin shkollor

8.1 Matja e gatishmërisë për të përfshirë informacionet për diversitetet në materialin shkollor

Hulumtimi i vitit 2023 tregon se të anketuarit/at kanë gatishmërinë më të lartë për pranim në materialet shkollore të përfshihen informacione mbi aftësinë e kufizuar (73%), në vend të dytë është përfshirja e informacioneve mbi diversite-

tin në religjion ose besim (69%), pastaj origjina etnike (63%). Të anketuarit/at janë të ndarë në pyetjen nëse materialet shkollore duhet të përfshijnë informacione mbi kulturën dhe historinë rome, 50% pajtohen, ndërsa 47% nuk pajtohen. Mbështetja më e vogël është për përfshirjen e informacionit në shkolla mbi orientimin seksual (25%) dhe personat transgjjinorë (18%) (shih Grafikon numër 22).

Grafiku numër 22 Në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me secilën nga deklaratat e mëposhtme? Orët shkollore dhe materiali shkollor duhet të përfshijë informacion mbi diversitetin në lidhje me ...



Të anketuarit/at që pajtohen të përfshihen informacione në materialin shkollor në lidhje me diversitetin në religjion dhe besim, më shpesh janë:

- Gratë sesa burrat;
- Të moshës nga 15-24 vjeç;
- Me arsim fillor të përfunduar se sa me arsim të mesëm dhe të lartë të përfunduar;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe

- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Dallimet më të mëdha ekzistojnë midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend për këtë çështje. Shqiptarët/et etnikë/e dhe pjesëtarët/et e fesë myslimane në një numër dukshëm më të madh deklarojnë se pajtohen që informacioni mbi diversitetin në bazë të fesë dhe besimit duhet të përfshihet në materialet shkollore sesa maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et (shih Tabelën numër 46).

Tabela numër 46

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshihen informacione në materialin shkollor në lidhje me diversitetin në religjion dhe besim:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	67%				71%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	75%	71%	71%	68%	69%	64%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	72%		68%		68%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e	
2023	66%				78%	
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e	
2023	66%				78%	
Vendbanimi:	Urban				Rural	
2023	70%				68%	

Të anketuarit/at që pajtohen për përfshirjen e informacioneve në materialin shkollor mbi diversitetin sipas origjinës etnike dhe ngjyrës së lëkurës, më shpesh janë:

- Të moshës nga 15-34 vjeç;
- Me arsim fillor dhe të lartë të përfunduar, se sa me arsim të mesëm të përfunduar;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Përsëri dallimet më të mëdha ekzistojnë midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend për këtë çështje. Shqiptarët/et etnikë/e dhe pjesëtarët/et e fesë myslimane në një numër dukshëm më të madh deklarojnë se pajtohen që materialet shkollore duhet të përfshijnë informacione për dallimet në bazë të origjinës etnike dhe ngjyrës së lëkurës, sesa maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et (shih Tabelën numër 47).

Tabela numër 47

Të anketuarit/at që pajtohen për përfshirjen e informacioneve në materialin shkollor mbi diversitetin sipas origjinës etnike dhe ngjyrës së lëkurës:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	63%				64%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	67%	66%	64%	62%	63%	59%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	66%		59%		66%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	57%			70%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	58%			75%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2023	64%			63%		

Të anketuarit/at që pranojnë të përfshijnë informacione në materialin shkollor mbi orientimin seksual, më shpesh janë:

- Të moshës nga 15-24 vjeç;
- Të ketë përfunduar arsimin e lartë sesa të ketë përfunduar arsimin fillor dhe të mesëm;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e;
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et; dhe
- Të anketuarit nga zonat urbane, sesa nga zonat rurale.

Pëlqimi për përfshirje të informacioneve në materialin shkollor mbi orientimin seksual është një nga më të ulëtat e pranuar në hulumtim. Megjithatë, rezultatet japin disa tregues për dalli-

met në karakteristikat socio-demografike të të anketuarve/ave. Mbështetja për inkorporimin e informacioneve seksuale në materialet shkollore është më e madhe te popullata më e re dhe zvogëlohet me moshën e të anketuarve ndërsa rritet me shkallën e nivelit të arsimit të përfunduar. Dallimet janë gjithashtu të dukshme midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend, për këtë çështje. Shqiptarët/et etnikë/e dhe anëtarët/et e fesë myslimane në numër të madh deklarojnë se pajtohen që informacioni rreth orientimit seksual duhet të përfshihet në materialet shkollore, sesa maqedonasit/et etnikë/e dhe të krishterët/et. Gjithashtu, banorët urbanë tregojnë gatishmëri më të madhe në pranimin, sesa ata në zonat rurale (shih Tabelën numër 48).

Tabela numër 48

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacione në materialin shkollor mbi orientimin seksual:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	24%				24%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	33%	25%	29%	25%	19%	18%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	20%		26%		29%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	23%			31%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	23%			26%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2023	27%			21%		

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacione në materialin shkollor mbi personat transgjjinorë, më shpesh janë:

- Të moshës 25-44 vjeç;
- Të ketë përfunduar arsimin e lartë sesa të ketë përfunduar arsimin fillor dhe të mesëm;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Pëlqim për përfshirjen e informacioneve në materialin shkollor në lidhje me një person transgjjinor është më i ulëti i pranuar në hulumtim. Mbështetja është më e ulët te të anketuarit/

at të moshës mbi 65 dhe të moshës 45-55 vjeç, ndërsa më e lartë në popullsinë më të re të moshës 15-24 vjeç. Gjithashtu rritet me nivelin e arsimit të përfunduar, personat me arsim të lartë kanë më shumë gjasa të mbështesin një iniciativë të tillë sesa ata me arsim fillor të përfunduar. Dallimet janë gjithashtu të dukshme midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend, për këtë çështje. Shqiptarët/et etnikë/e dhe anëtarët/et e besimit mysliman në numër të madh deklarojnë se pranojnë të përfshijnë informacion mbi një personat transgjjinor në materialet shkollore, sesa maqedonasit/es etnikë/e dhe të krishterët/et (shih Tabelën 49).

Tabela numër 49

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacione në materialin shkollor mbi personat transgjjinorë:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	17%				18%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	19%	21%	20%	17%	19%	14%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	16%		19%		22%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e	
2023	15%				28%	
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e	
2023	15%				24%	
Vendbanimi:	Urban				Rural	
2023	17%				20%	

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacione në materialin shkollor për aftësitë e kufizuara, më shpesh janë:

- Të moshës nga 15-24 vjeç;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e;
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et; dhe
- Të anketuarit nga zonat urbane, sesa nga zonat rurale.

Pëlqim për përfshirjen e informacioneve në materialin shkollor për aftësinë e kufizuar nuk krijon dallime të mëdha në karakteristikat socio-demografike të të anketuarve/ave. Dallimet më të mëdha janë të dukshme te të anketuarit/at më të ri/reja nga mosha 15 deri në 24 vjeç, të cilët do ta mbështesin këtë iniciativë në një numër më të madh se grup moshat e tjera (shih Tabelën numër 50).

Tabela numër 50

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacione në materialin shkollor për aftësitë e kufizuara:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	72%				73%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	78%	72%	72%	73%	72%	70%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	75%		70%		73%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	70%			75%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	71%			77%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2023	74%			70%		

Të anketuarit/at që pranojnë të përfshijnë informacion në materialin shkollor mbi kulturën dhe historinë rome, më shpesh janë:

- Të moshës 15-34 dhe 55-64 vjeç;
- Me arsim fillor dhe të lartë të përfunduar, se sa me arsim të mesëm të përfunduar;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Tema për përfshirje në materialin shkollor, tema për kulturën dhe historinë rome, e ndan publikun mbi dhënien e pëlqimit për një iniciativë të tillë. Rezultatet zbulojnë dallime më të mëdha që ekzistojnë midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend, për këtë çështje. Shqiptarët/et etnikë/e dhe anëtarët/et e besimit mysliman në numër dukshëm më të madh deklarojnë se pranojnë të përfshijnë informacion mbi kulturën dhe historinë rome në materialet shkollore, sesa maqedonasit/es etnikë/e dhe të krishterët/et (shih Tabelën 51).

Tabela numër 51

Të anketuarit/at që pajtohen të përfshijnë informacion në materialin shkollor mbi kulturën dhe historinë rome:


Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	51%				50%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	53%	55%	51%	48%	53%	43%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	53%		46%		53%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2023	41%			63%		
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e			Mysliman/e		
2023	42%			67%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2023	51%			49%		

9. Matja e gatishmërisë për të pranuar përcaktuesin e tretë në dokumentet personale përveç burrë ose grua

Rezistenca e dukshme e të anketuarve ndaj idesë së futjes së një opsioni të tretë në kolonën gjinore në dokumentet zyrtare të identifikimit është e dukshme, gjë që do të mundësonte individët të identifikoheshin ndryshe nga zgjedhja aktuale binare ndërmjet burrit dhe gruas. Të anketuarit kundërshtojnë në numër të madh idenë e futjes

së një përcaktimi të tretë (79%) ndërsa një numër i vogël (12%) janë të gatshëm ta pranojnë, 9% e të anketuarve/ave nuk kanë formuar një qëndrim mbi temën dhe u përgjigjën me "Nuk e di" (shih grafikun numër 23).

Grafiku numër 23 A mendoni se dokumentet zyrtare, si pasaportat, letërnjoftimet dhe certifikatat e lindjes, duhet të kenë opsion të tretë, si X ose O (tjetër) përveç burrë (B) dhe grua (G) për ata persona që nuk identifikohen si femra ose



Duke kryqëzuar të dhënat me të anketuarit/at që kanë deklaruar se janë diskriminuar në 12 muajt e fundit, vetëm viktimat në bazë të orientimit seksual tregojnë një gatishmëri më të madhe (46%) për të mbështetur vendosjen e një opsi- oni të tretë në dokumentet zyrtare, ndërsa ndër te të diskriminuarit mbi të gjitha bazat e tjera, mbështetja është shumë më e ulët dhe varion nga 13% në 22%.

Të anketuarit/at që besojnë se duhet të ketë përcaktim të tretë në dokumentet zyrtare, më shpesh janë:

- Burrat, sesa gratë;
- Të moshës 35-44 vjeç;
- Personat me arsim të mesëm dhe të lartë sesa me arsim fillor të përfunduar;
- Shqiptarët/et etnikë/e sesa maqedonasit/ et etnikë/e; dhe
- Myslimanët/et sesa të krishterët/et.

Tabela numër 52

Të anketuarit/at që besojnë se duhet të ketë përcaktim të tretë gjinor në dokumentet zyrtare:

Gjinia:	Burrë				Grua	
2023	13%				10%	
Grup-moshat madhore:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2023	12%	10%	15%	8%	13%	11%
Arsimi:	Fillor		I mesëm		I lartë	
2023	9%		14%		12%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e				Shqiptar/e	
2023	10%				15%	
Përkatësia religjioze:	I/e krishterë/e				Mysliman/e	
2023	10%				17%	
Vendbanimi:	Urban				Rural	
2023	14%				9%	

10. Përfundime

Perceptimet për diskriminimin

Analiza e të dhënave nga të gjitha hulumtimet (2009, 2013, 2018 dhe 2023) tregon se fenomeni i diskriminimit është gjerësisht i përhapur në publik, me një trend të rritjes së moderuar, në pesë nga shtatë bazat e diskriminimit, dy të tjerat tregojnë stanjacion. Të dhënat vazhdimisht tregojnë se shumica e të anketuarve/ave e konsiderojnë diskriminimin si të zakonshëm, në krahasim me ata që nuk pajtohen me këtë pikëpamje dhe e konsiderojnë diskriminimin të rrallë edhe pse kjo përqindje ka treguar një prirje të qëndrueshme në rritje gjatë viteve.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe etnike ka qenë më i përhapuri në të gjitha hulumtimet gjatë viteve. Këto të dhëna tregojnë se publiku i njeh ato si "gjeneratorët" kryesorë, të cilët janë pengesë për realizimin e mundësive të barabarta për qytetarët në sfera të ndryshme të jetës. Të dhënat tregojnë se në shumicën e rasteve, viktimat ose dëshmitarët e diskriminimit janë persona që vendosen në disavantazh vetëm në bazë të përkatësisë së tyre politike ose etnike. Përveç kësaj, sipas vlerësimit të të anketuarve/ave, në krye të listës së faktorëve që i vendosin kandidatët/et me aftësi dhe kualifikime të barabarta në një pozitë të pabarabartë gjatë punësimit janë pikërisht përkatësia e tyre politike dhe etnike.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual sipas perceptimit të publikut është në fund të renditjes si më pak i përhapuri, në të gjitha hulumtimet. Ambienti i përgjithshëm në vend tregon se publiku ka tendencë më të madhe të mospranimit të këtij grupi minoritar. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në jetën reale ka një distancim të madh nga personat me orientime të ndryshme seksuale. Në fund të listës së pranimit si fqinj/e ose mik/e janë anëtarë të këtij grupi,

dhe gjithashtu për këtë kategori personash gatishmëria është më e vogël për mbështetje të masave specifike për të siguruar mundësi të barabarta gjatë punësimit, si dhe gatishmëri më të vogël për të pranuar që informacioni mbi orientimin seksual të përfshihet në materialet shkollore.

Një aspekt i veçantë i perceptimeve të diskriminimit paraqesin vlerësimet e të anketuarve/rave nëse një lloj i veçantë diskriminimi është më i shpeshtë ose më i rrallë në krahasim me situatën në pesë vitet e fundit. Sipas këtij parametri, midis hulumtimeve nga viti 2018 deri më tani, rezultatet tregojnë se ka një përqendrim të perceptimit të incidencës së diskriminimit. Analiza e strukturës dhe dinamikës së ndryshimeve tregon urgjencën për të ndër marrë veprime në luftën kundër diskriminimit.

Perceptimi më i pafavorshëm për diskriminimin në planin afatmesëm (në pesë vitet e fundit) është në aspektin e përkatësisë politike. Për gjashtëfish është më i madh numri i të anketuarve/ave që e vlerësojnë këtë lloj diskriminimi si më të shpeshtë, se ata që e vlerësojnë si të rrallë. Dallimi drastik midis perceptimit të diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, krahasuar me të gjitha të tjerat, tregon faktin se tashmë në diskriminimin e rangut të dytë në bazë të përkatësisë etnike, dominimi i perceptimit se është më i shpeshtë është vetëm 2.2 herë më shumë në krahasim me atë se ky diskriminim është më i rrallë.

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se qytetarët deklarojnë një nivel të lartë tolerance kur bëhet fjalë për sferën private, përkatësisht për jetën në një lagje me pjesëtarë të grupeve të ndryshme. E njëjta gjë reflektohet edhe në sferën publike, kur bëhet fjalë për pranimin e pjesëtarëve/eve të grupeve të ndryshme në pozicionin më të lar-

të zgjedhor në pushtet. Në shkallën e tolerancës ndaj grupeve të ndryshme, të anketuarit/at tregojnë gatishmëri të madhe për të pranuar si fqinjë ashtu edhe si bartës të një funksioni të zgjedhur nga orientimi politik "tjetër" dhe anëtarë nga komunitetet "e tjera" etnike dhe fetare.

Në zonën negative të "barometrit" të tolerancës, rezervimi ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual shprehet dukshëm si në sferën publike ashtu edhe në sferën private. Një emërues i përbashkët i të dhënave në lidhje me perceptimet për orientimin seksual, për të gjitha temat dhe aspektet në hulumtim, është se ato kanë një ogur negativ. Nga këto gjetje mund të konkludohet se pranimi dhe integrimi i këtij grupi paraqet një nga sfidat më të mëdha në luftën kundër diskriminimit.

Përvoja me diskriminimin

Të dhënat për përvojat personale me diskriminimin tregojnë se çdo i/e treti/a i/e anketuar deklaroi se ka qenë viktimë e diskriminimit ndërsa katër nga dhjetë të anketuar raportuan se ishin dëshmitarë të diskriminimit. Në të gjitha sondazhet (2009, 2013, 2018 dhe 2023), përkatësia politike u perceptua si lloji më i zakonshëm i diskriminimit, si në situatat kur individët diskriminohen personalisht ashtu edhe kur janë dëshmitarë të diskriminimit. Por në vitin 2023 pati një rënie statistikisht të konsiderueshme si në situatë të diskriminimit personal ashtu edhe në situatë si dëshmitar/e i/e diskriminimit. Ka një rënie të lehtë në të dy rastet e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, që në vitin 2023 barazohet dhe e vendos në vend të parë së bashku me diskriminimin politik. Në jetën e përditshme, në një numër rastesh, tregohet lidhja midis përvojës personale të ekspozimit ndaj diskriminimit dhe situatës në të cilën ata persona e kanë gjetur veten si dëshmitarë të saj. Një përvojë e tillë e dyfishtë diskriminimi ndikon ndjeshëm në perceptimin e tyre për ekzistencën e diskriminimit. Kjo konfirmohet nga të dhënat, përkatësisht një numër dukshëm i madh i këtyre personave e perceptojnë diskriminimin si të zakonshëm në raport me të gjitha kategoritë e tjera të të anketuarve/ave. Një konstatim i tillë duhet të për-

doret në shënjestrimin e personave me përvoja të tilla nga organizatat që përqendrohen në luftën kundër diskriminimit në mënyrë që të marrin informacione specifike dhe konkrete prej tyre, të cilat mund të kontribuojnë në rezultate më të mira në luftën kundër diskriminimit.

Për herë të parë në hulumtimin e vitit 2023, ata të anketuar që deklaruan se ishin diskriminuar për çfarëdo arsye, u pyetën në çfarë rrethana ka ndodhur ngjarja. Rezultatet tregojnë se të anketuarit që u diskriminuan në 12 muajt e fundit u diskriminuan më shpesh në hapësirën publike, ndërsa në vend të dytë zakonisht ka qenë derisa kanë kërkuar punë ose derisa ishin në punë. Një në pesë të anketuar/a deklaruan se ishin diskriminuar nga personeli shëndetësor. Ndërsa një në dhjetë të anketuar/a përmendin rrjetet sociale, dyqanet /bankat, stafin e shërbimit publik dhe kafenetë, restorantet, baret dhe klubet e natës si vende ku kanë përjetuar diskriminim.

Gjysma e personave që kanë raportuar se janë diskriminuar, kanë përjetuar diskriminim të shumëfishtë, por numri i tyre ka rënë ngadalë gjatë viteve. Nga ana tjetër, të dhënat mbi perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë në pesë vitet e fundit tregojnë një rritje të lehtë. Përvoja e diskriminimit ka një ndikim të rëndësishëm në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë. Rritja më e madhe në perceptimin se diskriminimi i shumëfishtë është i zakonshëm ka ndodhur në mesin e të anketuarve/ave të cilët vetëm janë diskriminuar, dhe më pas në mesin e të anketuarve/ave të cilët as nuk janë diskriminuar dhe as nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Nga ana tjetër, përgjigjet më të shpeshta se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë jepen nga të anketuarit/at që kanë qenë dëshmitarë dhe viktima të diskriminimit.

Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta gjatë punësimit

Analiza e perceptimeve të të anketuarve/ave zbulon tre faktorë kryesorë që çojnë në trajtim të pabarabartë gjatë punësimit: përkatësia politike, mosha e kandidatëve/eve dhe përkatësia e tyre etnike.

Analiza tregon se në perceptimin e faktorëve më të shpeshtë që çojnë në trajtim të pabarabartë gjatë punësimit nga njëra anë dhe gatishmërinë për të mbështetur masa specifike për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit, ka një rënie të lehtë. Ndërsa rënia më e madhe në të dyja kategoritë vërehet në përgjigjet për përkatësinë politike të kandidatit. Në vitin 2023, shumica e të anketuarve/ave mbështetën vendosjen e masave specifike kundër diskriminimit në vendin e punës në bazë të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të moshës. Menjëherë pas tyre vijnë masat kundër diskriminimit në bazë të gjinisë, etnisë dhe përkatësisë fetare. Mbështetja për personat sipas orientimit të tyre seksual është vazhdimisht më e ulët në krahasim me të gjithë të tjerët, dhe ka qenë në rënie të vazhdueshme gjatë viteve. Megjithatë, te të dyja masat (për evidentimin e përbërjes së punonjësve dhe ndjekjen e procedurave të punësimit), hulumtimi i fundit tregon një rënie të madhe të mbështetjes së tyre. Kjo rënie është kryesisht për shkak të ndryshimeve në gatishmërinë për të mbështetur masa të tilla te dy komunitetet më të mëdha etnike në vend.

Fakti që mbështetja e masave specifike për të siguruar mundësi të barabarta gjatë punësimit në një shkallë të lartë përkon me faktorët kryesorë që dëmtojnë mundësitë e barabarta gjatë punësimit, tregon se diskriminimi gjatë punësimit ndikon në interesat jetike ekzistenciale dhe socio-ekonomike të qytetarëve. Këto gjetje mbështeten edhe nga gatishmëria e shprehur e shumicës së qytetarëve/eve për të mbështetur masa për evidentimin dhe monitorimin e procedurave të punësimit të personave që i përkasin bashkësive etnike më të vogla në numër. Ashtu si me aspektet e tjera të diskriminimit, në këtë rast, neglizhohet barazia e personave me orientime të ndryshme seksuale.

Lufta kundër diskriminimit

Vlerësimi i qytetarëve/eve për përpjekjet në luftën kundër diskriminimit me kalimin e kohës tregon një prirje në rënie në vlerësimin se po bëhen përpjekje të mjaftueshme reale. Në vitin 2023, ka një pamje të theksuar negative kur të dhënat

shikohen përmes prizmit të përvojave me diskriminim. Pavarësisht nëse të anketuarit/at kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të diskriminimit apo jo, një shumicë dërrmuese mendojnë se nuk po bëhen përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin.

Ndërgjegjësimi mbi të drejtat dhe kërkimi i mbrojtjes në rast të diskriminimit

Në periudhën e mbuluar me hulumtimin, nga viti 2009 deri në vitin 2023, shumica e të anketuarve/ave deklaruan se nuk i dinin të drejtat e tyre në rast se ishin viktimë të diskriminimit. Por pavarësisht kësaj, mund të vihet re një efekt pozitiv në luftën kundër diskriminimit. Të dhënat e hulumtit tregojnë se ka një rritje të numrit të të anketuarve/ave që janë të vetëdijshëm/e për të drejtat e tyre midis atyre që kanë qenë viktimë e diskriminimit mbi një bazë.

Gatishmëria e të anketuarve/ave për t'iu drejtuar institucioneve dhe organizatave kundër diskriminimit është shumë më e madhe për ata që personalisht kanë qenë viktimë të diskriminimit sesa për ata që kanë deklaruar se nuk kanë qenë. Megjithatë, një e pesta e atyre që u diskriminuan personalisht thanë se nuk do të kërkonin mbrojtje nga asnjë institucion ose organizatë kompetente.

Nga të anketuarit/at që deklaruan se do të kërkonin mbrojtje nëse do të ishin hipotetisht viktimë e diskriminimit, përgjigja më përfaqësuese është se ata do t'i drejtoheshin policisë, të cilën e konsiderojnë se është institucioni përkatës përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa në një numër pak më të vogël do t'i drejtoheshin Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Pas tyre vijnë Avokati i Popullit, gjykata, avokati dhe organizatat e shoqërisë civile. Dhe në numër më të vogël përmenden sindikatat. Struktura e këtyre përgjigjeve çon në përfundimin se, *de facto*, një pjesë e madhe e qytetarëve/eve nuk i njohin institucionet përkatëse anti-diskriminuese, megjithëse subjekti visht janë të bindur se i njohin. Kjo tregon se ka nevojë për një promovim më të madh publik të

institucioneve përgjegjëse për luftimin e diskriminimit, në veçanti për promovim të Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit dhe gjykatës.

Në vitin 2023, shohim një rënie të madhe të zgjedhjes së gjykatës si institucioni i dytë ose i përmendur, të cilit të anketuarit/at do t'i drejtoheshin për ndihmë nëse do të ishin viktimë e diskriminimit. Kjo e ul nga vendi i parë në vitin 2018, në vendin e dytë aktual. Në vitin 2023, policia zuri vendin e parë, edhe për përgjigjen e dytë dhe përgjigjet e tjera në lidhje me këtë pyetje. Vërehet një tendencë e rritjes së besimit në Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi.

Ndikimi i kontekstit shoqëror mbi qëndrimet ndaj diskriminimit

Analiza e kontekstit shoqëror dhe e ndërveprimeve midis grupeve të ndryshme shoqërore tregon se një shumicë e madhe e qytetarëve i përjetojnë anëtarët e grupeve të ndryshme shoqërore si pjesë e rrethit të tyre shoqëror. Trendi i socializimit me grupet minoritare në Maqedoninë e Veriut tregon stanjacion në 5 vitet e fundit, grupet minoritare të analizuar nuk tregojnë dallime statistikore midis hulumtimeve të vitit 2018 dhe 2023. Por gjatë katërmbëdhjetë viteve të hulumtimit, ka pasur një rënie të vazhdueshme të personave që kanë deklaruar se rrethi i tyre shoqëror përfshin edhe persona me aftësi të kufizuara.

Një shumicë e madhe e të anketuarve/ave deklarojnë se kanë miq/mike ose të njohur/a që janë të ndryshëm nga ata për sa i përket pikëpamjeve politike, etnisë dhe religjioze. Gjithashtu, tre nga pesë të anketuar/a u përgjigjën se kanë mik/e ose të njohur/a që janë nga komuniteti etnik rom dhe persona me aftësi të kufizuara. Në të kundërt, vetëm një në dhjetë të anketuar/a raportuan se në rrethin e tyre më të ngushtë ose më të gjerë social takojnë edhe persona me orientim të ndryshëm seksual.

Është rritur përqindja e të anketuarve/ave që e përjetojnë veten se i përkasin një pakice në vendin ku jetojnë në pesë vitet e fundit. Në të gjithë

periudhën, më të shumtë janë personat që ndjehen si pakicë etnike, e cila në valën e fundit ka pasur një rritje dhe është më e larta në të gjithë periudhën e hulumtimit ndër vite. E dyta është pakica fetare, pasuar nga pakicë për sa i përket përkatësisë politike, e cila gjatë viteve shënon një rënie të vogël. Në të njëjtën kohë, shumë pak të anketuar/a deklarojnë se i përkasin një pakice për sa i përket aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual.

Bazuar në këto gjetje, nga hulumtimet mund të nxirret një përfundim i përgjithshëm sipas të cilit perceptimi dhe pikëpamjet mbi diskriminimin në publik do të jenë të përhapura gjerësisht, për sa kohë që ekzistojnë baza për parashikimin e diskriminimit në baza politike dhe etnike. Fokus i luftës kundër perceptimit të përhapur të diskriminimit në publik në vendin tonë duhet të drejtohet kah hulumtimi i thelluar i faktorëve që përcaktojnë qëndrime të tilla.

Gatishmëria për të pranuar përfshirjen e informacioneve për diversitetin në materialin shkollor

Hulumtimi i vitit 2023 tregon se te të anketuarit/at ka gatishmëri më të lartë për pranim në materialet shkollore të përfshihen edhe informacione për aftësitë e kufizuara dhe pak më pak në lidhje me përfshirjen e informacionit në lidhje me diversitetin në religjion ose bindje dhe origjinën etnike. Të anketuarit/at janë të ndarë në pyetjen nëse materialet shkollore duhet të përfshijnë informacion mbi kulturën dhe historinë rome. Mbështetja më e vogël është për përfshirjen e informacioneve në shkolla, rreth orientimit seksual dhe personave transgjinorë.

Analiza tregon se dallimet më të mëdha ekzistojnë midis dy komuniteteve më të mëdha etnike dhe fetare në vend lidhur me këtë çështje, shqiptarët/et etnikë/e dhe myslimanët/et në numër më të madh shprehin mbështetje për futjen e informacioneve mbi diversitetin në materialin shkollor, sesa maqedonasit/et etnikë dhe të krishterët/et. Ekzistojnë gjithashtu dallime në moshën e anketuarve/ave, më të rinjtë e moshës 15-34 vjeç tregojnë një gatishmëri më të

madhe për të mbështetur zgjerimin e programin shkollor me informacione mbi diversitetin sesa grup moshat të tjera.

Pranimi i përcaktimit të tretë përveç burrë/grua në dokumentet zyrtare të identifikimit

Rezistenca evidente e të anketuarve ndaj idesë së futjes së një opsioni të tretë në kolonën gjinore në dokumentet zyrtare të identifikimit është e dukshme, gjë që do tu mundësonte individët

të identifikoheshin ndryshe nga zgjedhja aktuale binare ndërmjet burrit dhe gruas. Të anketuarit/at në numër të madh e kundërshtojnë idenë e prezantimit të një opsioni të tretë, ndërsa një në dhjetë të anketuar/a janë të gatshëm të pranojnë një ndryshim të tillë.

Analiza tregon se të anketuarit/at që kanë deklaruar se kanë pasur përvojë personale të diskriminimit në bazë të orientimit seksual mbështesin vendosjen e një opsioni të tretë në dokumentet zyrtare, ndërsa personat që janë diskriminuar për të gjitha arsyet e tjera japin shumë më pak mbështetje.

SHTOJCAT

Shtojca 1 Metodologjia që u aplikua në hulumtim

Katër valët e hulumtimit u kryen nga viti 2009 deri në vitin 2023, në një distancë kohore prej rreth pesë vjetësh. Të dhënat nga hulumtimi i parë u fituan midis 9 dhe 15 prillit 2009, nga i dyti midis 10 dhe 27 shtatorit 2013, nga hulumtimi i tretë midis 5 dhe 17 shtatorit 2018 dhe nga viti i fundit 2023 midis 25 majit dhe 12 qershorit.

Hulumtimi i parë (2009), i tretë (2018) dhe i katërt (2023) u zhvilluan nga Agjencia për hulumtimin e opinionit publik, marketing dhe media BRIMA, duke përdorur të njëjtën metodologji dhe dizajn të mostrës. Të tre hulumtimet ishin reprezentative me popullsinë mbi moshën 15 vjeç, duke përdorur një metodë të anketimit sy më sy në shtëpinë e të anketuarit/ës. Intervistat u zhvilluan në gjuhën maqedonase (me maqedonasit/et etnikë/e dhe anëtarët e bashkësive më të vogla etnike) dhe në gjuhën shqipe (me shqiptarët/et etnikë/e). Mostra e vitit 2009 përfshiu N = 1606 të anketuar/a, në vitin 2018 N = 1607 të anketuar/a, dhe në vitin 2023 N = 1608, me një marzh gabimi prej $\pm 2.5\%$ në nivelin e besimit prej 95%. Dizajni i mostrës i aplikuar në hulumtimet është një mostër me shumë nivele, e shtresuar, e rastësishme.

- Faza e parë: Shpërndarja e "sektorëve" (sampling points) në mënyrë proporcionale me karakteristikat rajonale, urbane/rurale dhe etnike të popullsisë - duke aplikuar metodën PPS (Probability Proportion to Size), përkatësisht probabiliteti proporcional me madhësinë.
- Faza e dytë: Përzgjedhja e familjeve duke përdorur metodën e përzgjedhjes së

rastësishme. Secilit "sektor" i caktohet një pikënisje dhe një drejtim i caktuar.

- Faza e tretë: Përzgjedhja e vetëm 1 të anketuari/e për familje, duke përdorur çelës përzgjedhës "ditëlindja e parë e ardhshme", që është personi në familje i moshës 15 vjeç e lart, ditëlindja e të cilit është e radhës.
- Faza e katërt: Zëvendësimi i familjes, duke përdorur një procedurë të përzgjedhjes së familjes, nëse anëtari i zgjedhur i familjes refuzon ose nuk është i disponueshëm për të marrë pjesë në një intervistë pas gjithsej tre përpjekjeve (vizita fillestare dhe dy përpjekje të tjera).

Mostrat për hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018 u përgatitën duke përdorur të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikave (rezultatet e regjistrimit të vitit 2002) për popullsinë e moshës 15 vjeç e lart. Ndërsa mostra për vitin 2023 u përgatit duke përdorur të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikave (rezultatet e regjistrimit të vitit 2021) Mostra përfshiu gjithashtu strukturën e popullsisë sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, përbërjes etnike dhe rajonit, të cilat azhurnohen në përputhje me vlerësimet e fundit dhe të dhënat parësore të Entit Shtetëror të Statistikave për popullsinë në vend, të përpunuara nga BRIMA. Baza e të dhënave të hulumtimit u rregullua sipas moshës dhe gjinisë, rajonit dhe përkatësisë etnike.

Hulumtimi i dytë (2013) u krye nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), në bashkëpunim me M-Prospekt SHPK - Shkup. Hulumtimi u krye me telefon (80% përmes linjave fikse dhe 20% përmes telefonave celularë, duke përdorur bazën e të dhënave të numrave të telefonit të M-perspektit) duke përdorur metodën "ditëlindja e radhës" të popullsisë

së moshës 15 vjeç e lart. Metoda e projektimit të mostrës ishte shumë-fazore, duke marrë parasysh shpërndarjen e popullsisë sipas vendbanimit në zonat rurale dhe urbane dhe përkatësinë etnike. Intervistat u zhvilluan në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Mostra përfshiu 1600 subjekte me një marzh gabimi prej $\pm 2.5\%$ në nivelin e besimit 95%.

Problemimet metodologjike

Pyetësi i përdorur në të tre hulumtimet ishte me strukturë dhe tema dhe pyetje të njëjta, me qëllim për të fituar njohuri për ndryshimet në perceptimet, qëndrimet, njohuritë dhe ndërgjegjësimin për diskriminimin, me ndryshime të caktuara në disa nga pyetjet në hulumtimin e vitit 2013.

Në vitin 2013 janë bërë ndryshime në pyetjet e mëposhtme:

- Në pyetjen P2 është anashkaluar opsioni: “as më të shpeshta dhe as më pak të shpeshta” në përgjigjet;
- Pyetjet P5, P7, P10_1 dhe P10_2 nuk janë pjesë e pyetësorit;
- Shkalla e matjes e përdorur për pyetjet P6 dhe P8 u ndryshua nga 1-10 në 1-9 gradë;
- Në pyetjen P9 u shtua opsion i ri: “as pajtohem as nuk pajtohem”;
- Në P13 nuk është përdorur asnjë filtër.

Këto ndryshime në pyetësor kufizuan mundësitë e krahasimit të rezultateve të të tre hulumtimeve.

Janë shtuar gjithashtu pyetje të reja (P13 dhe P14) nga viti 2013 për të monitoruar ndikimin dhe ecurinë e zbatimit të *Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi*. Gjithashtu u mat ndërgjegjësimi i të anketuarve/ave për *Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi* si organ qendror kombëtar.

Shtojca 2 Pyetësi anketues

(LEXOHET PARA FILLIMIT TË PYETJES SË PARË)

Pyetjet që vijojnë kanë të bëjnë me temën e *diskriminimit*.

Diskriminimi nënkupton trajtim të pabarabartë të njerëzve, domethënë trajtim të ndryshëm të njerëzve vetëm sepse janë femra ose meshkuj, anëtarë të një grupi ose komuniteti të caktuar etnik, kanë një fe të caktuar, nëse janë persona

me aftësi të kufizuara (domethënë janë persona me aftësi të kufizuara mendore ose fizike), dhe të ngjashme. Trajtimi i pabarabartë mund të jetë i dukshëm, siç për shembull kur një konkurs pune postohet qëllimisht, në të cilin shkruhet se kërkohen punëtorë të një grupi të caktuar etnik ose vetëm meshkuj. Gjithashtu, trajtimi i pabarabartë mund të fshihet, si për shembull, kur testimi për punë është mbajtur në festë fetare sepse anëtarët e një përkatësie fetare nuk do të mund të marrin pjesë.

Karta e shfaqjes P1

P1. A mund të më thoni se çfarë mendoni, sa e shpeshtë është secila prej këtyre formave të diskriminimit në vend? Diskriminimi në bazë të ...

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Shumë e shpeshtë	Mjaft e shpeshtë	Mjaft i rrallë	Shumë rrallë	Jo ekziston	Nuk e di (NUK LEXOHE)
P1_1 Përkatësia etnike	1	2	3	4	5	9
P1_2 Gjinia	1	2	3	4	5	9
P1_3 Orientimi seksual (p.sh. homoseksualiteti)	1	2	3	4	5	9
P1_4 Moshë	1	2	3	4	5	9
P1_5 Religjioni ose besimi	1	2	3	4	5	9
P1_6 Aftësi të kufizuara	1	2	3	4	5	9
P1_7 Përkatësia partiake	1	2	3	4	5	9

Karta e ekspozimit P2

P2. Nëse krahasoni situatën aktuale me situatën e 5 viteve më parë, a do të thoshit se format e mëposhtme të diskriminimit janë më të shpeshta ose më pak të shpeshta në vend? Diskriminimi në bazë të ...

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Shumë Më i shpeshtë	Mjaft i shpeshtë	As i shpeshtë, as i rrallë (e njëjtë)	Mjaft i rrallë	Shumë më i rrallë	Nuk e di (NUK LEXOHE)
P2_1 Përkatësia etnike	1	2	3	4	5	9
P2_2 Gjinia	1	2	3	4	5	9
P2_3 Orientimi seksual (p.sh. homoseksualiteti)	1	2	3	4	5	9
P2_4 Moshë	1	2	3	4	5	9
P2_5 Religjioni ose besimi	1	2	3	4	5	9
P2_6 Aftësi të kufizuara	1	2	3	4	5	9
P2_7 Përkatësia partiake	1	2	3	4	5	9

PËRGJIGJEN ATA TË CILËT NË P3 JANË PËRGJIGJUR SE JANË NDIER TË DISKRIMINUAR

Karta e ekspozimit Q3a

P3a. Duke menduar për herën e fundit kur jeni ndjerë të diskriminuar, në çfarë rrethana ka ndodhur?

LEJOHEN MË SHUMË PËRGJIGJE		
P3a_1	Kur kërkonit punë	1
P3a_2	Në punë	2
P3a_3	Kur kërkonit shtëpi ose apartament me qira	3
P3a_4	Nga personeli shëndetësor (p.sh. recepcionist, infermier/e ose mjek)	4
P3a_5	Nga personeli i shërbimit social	5
P3a_6	Nga stafi i shkollës ose universitetit; kjo mund t'ju ketë ndodhur si student ose si prind	6
P3a_7	Në kafene, restorant, bar ose klub nate	7
P3a_8	Në dyqan ose bankë	8
P3a_9	Në një hapësirë publike	9
P3a_10	Në mediat sociale/rrjetet	10
P3a_11	Tjetër, shkruani _____	11
P3a_99	Nuk e di (NUK LEXOHE T)	99

PYETI TË GJITHË

Karta e shfaqjes P3

P3. A jeni ndjerë personalisht të diskriminuar ose të ngacmuar për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme në 12 muajt e fundit? A jeni diskriminuar në bazë të ...? Ju lutemi tregoni arsyet që mendon se janë të rëndësishme.

LEJOHEN MË SHUMË PËRGJIGJE		
P3_1	Përkatësia etnike	1
P3_2	Gjinia	2
P3_3	Orientimi seksual	3
P3_4	Mosha	4
P3_5	Religjioni ose besimi	5
P3_6	Aftësi të kufizuara	6
P3_7	Përkatësia partiake	7
P3_8	Arsye tjetër, shkruaj _____	8
P3_98	Nuk jeni diskriminuar (NUK LEXOHE T)	98
P3_99	Nuk e di (NUK LEXOHE T)	99

Karta e shfaqjes P4

P4. Në 12 muajt e fundit, a keni qenë dëshmitarë të diskriminimit ose ngacmimit të dikujt për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme? A ishte diskriminim i bazuar në ...? Ju lutemi tregoni arsyet që mendoni se janë të rëndësishme.

LEJOHEN MË SHUMË PËRGJIGJE		
P4_1	Përkatësia etnike	1
P4_2	Gjinia	2
P4_3	Orientimi seksual	3
P4_4	Mosha	4
P4_5	Religjioni ose besimi	5
P4_6	Aftësi të kufizuara	6
P4_7	Përkatësia partiake	7
P4_8	Arsye tjetër, shkruaj _____	8
P4_98	Nuk keni qenë dëshmitar (NUK LEXOHE)	98
P4_99	Nuk e di (NUK LEXOHE)	99

Karta e shfaqjes P5

P5. Vetëm diskutoni për diskriminim në bazë të etnisë, gjinisë, orientimit seksual, moshës, religjionit ose besimit dhe/ose aftësisë së kufizuar. Disa njerëz mund të përjetojnë diskriminim për arsye të shumëfishta. Kur njerëzit diskriminohen për arsye të shumëfishta, këtë e quajmë "diskriminim i shumëfishtë". A mund të më thoni nëse, sipas mendimit tuaj, diskriminimi i shumëfishtë është shumë i shpeshtë, mjaft i shpeshtë, mjaft i rrallë, shumë i rrallë ose nuk ekziston në vend?

LEXO	
Shumë i shpeshtë	1
Mjaft i shpeshtë	2
Mjaft i rrallë	3
Shumë i rrallë	4
Nuk ekziston	5
Nuk e di (NUK LEXOHE)	9

Karta e ekspozimit P6

P6. Duke përdorur shkallën nga 1 deri në 10, ju lutem më tregoni se si do të ndiheshit personalisht në secilën prej këtyre situatave. Në shkallën, "1" do të thotë se ndiheni "shumë pakëndshëm" ndërsa "10" do të thotë që ndiheni "mjaft rehat" në atë situatë.

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Shumë parehatshëm	2	3	4	5	6	7	8	9	Mjaft këndshëm	Indif.	Nuk e di (NUK LEXOHE)
P6_1 Nëse keni një fqinj/e që është rom/e	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P6_2 Nëse keni një fqinj/e që është person me aftësi të kufizuara	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P6_3 Nëse keni një fqinj/e me orientim të ndryshëm seksual (homoseksual ose lezbike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P6_4 Nëse keni një fqinj/e të një përkatësie tjetër etnie, ndryshe nga e jotja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P6_5 Nëse keni një fqinj/e të një religjioni tjetër ose bindje tjetër nga ato të tuat	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P6_6 Nëse keni një fqinj/e që është anëtar/e ose simpatizant i një partie tjetër politike, të ndryshme nga ajo që e simpatizoni ju ose anëtar/e e së cilës jeni	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99

Karta e ekspozimit P7

P7. Në vend, kur një kompani dëshiron të punësojë dikë dhe mund të zgjedhë midis dy kandidatëve/eve me aftësi dhe kualifikime të barabarta, çfarë mendoni, cili nga kriteret e mësipërme e vendos një nga kandidatët/et në disavantazh? (në bazë të asaj që kompania do të vendosë se cilin nga dy kandidatët/et nuk do të punësojë)

LEXO, RROTULLO LEJOHEN MË SHUMË PËRGJIGJE	
P7_1 Emri i kandidatit/es	1
P7_2 Adresa e kandidatit/es	2
P7_3 Mënyra se si kandidati/ja flet, theksi i tij/saj	3
P7_4 Përkatësia etnike e kandidatit/es	4
P7_5 Gjinia e kandidatit/es	5
P7_6 Orientimi seksual i/e kandidatit/es (për shembull, nëse ai/ajo është homoseksual)	6
P7_7 Mosha e kandidatit/es	7
P7_8 Aftësi të kufizuara	8
P7_9 Shprehja e besimit fetar (p.sh., veshje si simbol fetar)	9
P7_10 Përkatësia partiake	10
P7_11 Nëse kandidati/ja është duhanpirës ose jo	11
P7_12 Pamja e jashtme e kandidatit/es, mënyra e veshjes dhe paraqitja e jashtme	12
P7_13 Pamja e përgjithshme fizike e kandidatit/es (lartësia, pesha, fytyra, etj.)	13
P7_14 Tjetër, shkruani _____	14
P7_98 Asnjë nga sa më sipër (NUK LEXOHE)	98
P7_99 Nuk e di (NUK LEXOHE)	99

Karta e ekspozimit P8

P8. Duke përdorur shkallën nga 1 deri në 10, a mund të më thoni se si do të ndiheshit nëse ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të personave do të mbante pozicionin më të lartë të zgjedhur të pushtetit në vend?

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Shumë parehatshëm	2	3	4	5	6	7	8	9	Mjaft këndshëm	Indif.	Nuk e di (NUK LEXOHET)
P8_1 Grua	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_2 Person me orientim seksual të ndryshëm (mashkull gej ose femër lezbike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_3 Person me përkatësi etnike të ndryshme nga shumica	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_4 Person më i ri se 30 vjeç	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_5 Personi me përkatësi fetare të ndryshme nga shumica	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_6 Person me aftësi të kufizuara	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_7 Person nga një parti politike që nuk merr pjesë në pushtet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
P8_8 Person mbi 75 vjeç	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99

Karta e ekspozimit P9

P9. A do të pajtoheshit apo do të kundërshtoni vendosjen e masave specifike për të siguruar mundësi të barabarta punësimi për të gjithë personat? Për shembull, masa të tilla janë: programe të veçanta trajnimi ose kuota për punësimin e personave në bazë të ...

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Pajtohem plotësisht	Pjesërisht pajtohem	Pjesërisht jam kundër	Plotësisht jam kundër	Nuk e di (NUK LEXOHET)
P9_1 Përkatësia etnike	1	2	3	4	9
P9_2 Gjinia	1	2	3	4	9
P9_3 Moshë	1	2	3	4	9
P9_4 Religjioni ose besimi	1	2	3	4	9
P9_5 Aftësi të kufizuara	1	2	3	4	9
P9_6 Orientimi seksual	1	2	3	4	9
P9_7 Përkatësia partiake	1	2	3	4	9

Karta e ekspozimit P10

P10. Deri në çfarë mase jeni dakord ose do të kundërshtonit që gjërat e mëposhtme të zbatohen në vendin e punës?

LEXO, RROTULLO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Pjesërisht Jam kundër	Plotësisht jam kundër	Nuk e di (NUK LEXOHEJ)
P10_1 Të evidentohet përbërja e punonjësve në mënyrë që të mund të monitorohet dhe vlerësohet se sa të përfaqësuar/a janë pjesëtarët/et e komuniteteve etnike më të vogla	1	2	3	4	9
P10_2 Të ndiqen procedurat e punësimit me qëllim që personat që i përkasin komuniteteve etnike më të vogla, të kenë mundësi të barabarta për punësim si kandidatët e tjerë me aftësi ose kualifikime të ngjashme	1	2	3	4	9

Karta e ekspozimit P11

P11. Në përgjithësi, a mund të thoni se në shtet po bëhen përpjekje të mjaftueshme për luftë kundër të gjitha formave të diskriminimit?

LEXO VETËM NJË PËRGJIGJE	
Vërtet bëhen përpjekje	1
Bëhen përpjekje deri në një masë	2
Nuk po bëhet asnjë përpjekje e vërtetë	3
Nuk po bëhet asnjë përpjekje	4
Nuk e di (NUK LEXOHEJ)	9

P12. A e dini se cilat janë të drejtat tuaja në rast se jeni viktimë e diskriminimit?

LEXO	
Po	1
Jo	2
Tjetër (shëno) _____	3
Nuk e di (NUK LEXOHEJ)	9

P13. Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose ngacmimit, a do të kërkonte mbrojtje nga institucionet, organizatat përkatëse?

LEXO		
Jo	KALO NË P1_1	1
Po	KALO NË P14	2
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHEJ)	KALO NË P1_1	9

PËRGJIGJEN ATA TË CILËT NË P13 JANË PËRGJIGJUR ME OPSIONIN PËR PËRGJIGJEJE 2

P14. Ku do të drejtoheni për të kërkuar mbrojtje? Ku në vend tjetër? Po në vend tjetër?
MOS I LEXO PËRGJIGJET

	P14,a Që përmendet i pari	P14,b Të tjerë
1 Gjykatë		
2 Polici		
3 Avokati i Popullit		
4 Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi		
5 Avokat		
6 Sindikatë		
7 Organizatë e shoqërisë civile		
8 Tjetër (shënoni)		
99 Nuk e di/Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)		

PYESNI TË GJITHË

P1_1 A keni mik/e ose të njohur/a që janë...?

LE XO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Po	Jo	Nuk e di (NUK LEXOHE)
P1_1_1 Pjesëtarë/e të një komuniteti tjetër etnik	1	2	9
P1_1_2 Romë/e	1	2	9
P1_1_3 Persona me orientim të ndryshëm seksual (mashkull gej ose femër lezbike)	1	2	9
P1_1_4 Persona me aftësi të kufizuara	1	2	9
P1_1_5 Persona të një religjioni ose besimi të ndryshëm nga i yti	1	2	9
P1_1_6 Anëtarë/e të një partie politike me pikëpamjet e të cilëve nuk pajtoheni	1	2	9

P1_2 A mendoni se në vendbanimin tuaj ju i përkisni ndonjëres nga të mëposhtmet? Ju lutemi tregoni arsyet që mendoni se janë të rëndësishme.

LE XO, RROTULLO LEJOHEN MË SHUMË PËRGJIGJE	
P1_2_1 Pakicë etnike	1
P1_2_2 Pakicë për sa i përket përkatësisë fetare	2
P1_2_3 Pakicë seksuale	3
P1_2_4 Pakicë për sa i përket aftësisë së kufizuar	4
P1_2_5 Pakica për sa i përket përkatësisë partiake ose simpatizimit partiak	5
P1_2_6 Asnjë nga të sipërmet	6
P1_2_7 Grupe të tjera minoritare, shkruani _____	7
P1_2_99 Nuk e di (NUK LEXOHE)	99

P15 Në çfarë mase pajtoheni ose nuk pajtoheni me secilën nga deklaratat e mëposhtme? Orët shkollore dhe materiali shkollor duhet të përfshijë informacion mbi diversitetin në lidhje me ...

LEXO NJË PËRGJIGJE NË ÇDO RRESHT	Plotësisht pajtohem	Deri diku pajtohem	Deri diku nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	Nuk e di (NUK LEXOHET)
Q15_1 Religjioni ose besimi	1	2	3	4	9
Q15_2 Origjina etnike ose ngjyra e lëkurës	1	2	3	4	9
Q15_3 Orientimi seksual (të qenit homoseksual, lezbike ose biseksual)	1	2	3	4	9
Q15_4 Të jesh person transgjjinor	1	2	3	4	9
Q15_5 Aftësi të kufizuara	1	2	3	4	9
Q15_6 Kultura dhe historia rome	1	2	3	4	9

P16 A mendoni se dokumentet zyrtare, si pasaportat, letërnjoftimet dhe certifikatat e lindjes, duhet të kenë opsion të tretë, si X ose O (tjetër) përveç burrë (B) dhe grua (G) për ata persona që nuk identifikohen si gra dhe burra?

LEXO	
Po	1
Jo	2
Nuk e di (NUK LEXOHE T)	99

Shtojca 3 Shpërndarja e karakteristikave përkatëse socio-demografike të të anketuarve

	2009	2013	2018	2023
	%	%	%	%
Gjinia				
Burrë	50.3	50.0	49.8	49.2
Grua	49.7	50.0	50.2	50.8
Grupet e moshës				
15-24	20.5		15.7	13.8
25-34	18.9		18.8	15.7
35-44	18.9		17.8	16.7
45-54	16.6		16.6	16.5
55-64	11.7	14.8	15.2	16.6
65+	13.4	12.3	15.9	20.7
Arsimi				
Fillor	35.8	17.7	24.2	36.3
I mesëm	49.7	53.3	49.9	44.1
I lartë	14.5	29.0	26.0	19.6
Përkatësia etnike				
Maqedonas/e	67.0	69.1	63.4	65.5
Shqiptar/e	22.9	24.8	25.9	24.3
Turk/e	2.8	1.4	3.6	1.9
Vllah/vllahe	0.9	0.6	0.1	0.7
Rom/e	3.1	1.1	3.2	4.1
Serb/e	1.8	1.5	1.7	1.1
Tjetër	1.6	1.5	2.1	2.5
Religjion				
I/e krishterë/e	69.1		65.0	67.4
Mysliman/e	29.5		34.2	31.9
Ateist	0.9		0.5	0.7
Tjetër	0.5		0.2	
Statusi i punës				
I/e punësuar me orar të plotë	28.7		40.3	43.6
I/e punësuar me orar të pjesshëm	1.7		2.2	4.1
I/e papunë	28.2		17.9	9.7
Amvis/e	12.3		11.3	10.5
Student/e, nxënës/e	11.5		8.4	7.8
Pensionist/e	16.9		18.6	24.4
Profesioni				
I/e vetëpunësuar, zejtar/e	12.6		19.6	14.3
Udhëheqës/e, drejtor/e	8.1		4.3	6.4
Nëpunës/e me arsim të lartë	19.9		19.4	16.0
Nëpunës/e me arsim të mesëm	12.0		9.4	13.9
Punëtor/e i/e kualifikuar me arsim të mesëm	29.7		26.8	22.8
Punëtor/e	14.9		15.1	19.8
Policia, ushtria	1.8		1.7	1.7
Bujk, fermer (burrë dhe grua)	0.3		3.1	5.1
Tjetër	0.8		0.5	
Vendbanimi				
Rural	42.4	37.9	43.2	37.8
Urban	57.6	62.1	56.8	62.2
Rajoni				
I Vardarit	7.9	7.1	7.4	7.7
Lindor	9.2	9.0	8.7	8.5
Jug-Perëndimor	10.9	10.0	10.8	9.8
Jug - Lindor	8.3	8.9	8.4	8.2
I Pellagonisë	11.6	10.9	11.3	11.7
I Pollogut	14.2	16.0	15.5	13.4
Veri - Lindor	8.4	8.9	8.4	8.3
I Shkupit	29.4	29.1	29.5	32.4

